

BIBLIOTEKA
SHTETIT

OH-32

S. 96.

SIRI SULEJMANI

ZEMRA E SHOKUT

TREGIME




DJH-32

SPG.

SIRI
SULEJMANI

ZEMRA
E
SHOKUT

2948



TREGIME

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ZEMRA E SHOKUT

Kujtim Habili iu fut jetës familjare në moshë disi të vonë. Ai ishte rritur jetim. Hidhërimet e vdekjes së prindërve dhe të një motre i ka lënë në kujtimet e largëta të fëmijërisë. Mendimin për jetën dhe njerëzit e ka formuar nga plot mbresa në shumë kantiere të vendit, ku ka punuar si montator dhe saldator. Në tjetër ambient ishte rritur Behija, e shoqja, megjithëkëtë, rrallë ka ndodhur që në mes tyre të dilte ndonjë re zemërimi. Edhe kjo ka ardhur jo për gjëra me rëndësi, por nga ndonjë vështrim i ndryshëm mbi sendet që i rrethojnë. Për shembull, Behija, si çdo grua, nxitohej e vinte merak për shtëpinë. Donte ta rregullonte atë sa më bukur. Shkonin vizita te njerëzit e njohur, e kur ktheheshin në shtëpinë e tyre, Behija, nuk e përmbante dot shqetësimin që i sillte krahasimi i shtëpisë së tyre të re, të thjeshtë, me ato të mira që kishin parë.

Kujtimi e kuptonte natyrën e gruas. Ajo në shpirtin e saj ruante dhe botën e familjes ku ishte rritur, të qetë e pa lëvizje, pa shqetësime të ndjeshme, të rregullt e disi të mbyllur, prandaj shqetësimin e saj i përgjigjej i qeshur e plot besim: Lerna rehat e dashur nuse, të gjitha të mirat do të

bëhen ngadalë-ngadalë. Në qoftë se do të mjaftonte vetëm dëshira për të arritur qëllimet, do të hiqej nga jeta procesi i rritjes, i pjekjes, do të kalohej nga mbjellja në korrje, po a bëhet dot kjo? Shiko gëzimet që duhet të veshin jetën, e dashur, ato nuk vijnë vetëm nga mobileritë e shtëpisë.

Kënaqësia e Kujtim Habilit ish in njerëzit. Ai donte njerëz, donte shokë në shtëpi, donte zëra e këngë. Jeta e tij prej jetimi ishte veshur nga gëzimet në shoqëri. Aty në shtëpinë e re i futeshin shpesh kujtimet e vendeve, të kantiereve, të shokëve e të njerëzve që kishte njohur gjatë viteve, e papritur shtëpia i dukej e vogël, e mbyllur... Sa herë binte zilja e derës, në fytyrën e tij ndeheshin rrezja e gëzimit. Ngrehu nuse, po na vjen dikush, — thoshte ai i gjallëruar dhe dilte në korridor i pari. Ky qëndrim i bënte në fillim aq përshtypje Behijes, sa që në sytë e prindërve të saj thoshte: Kujtimi im e pret me aq kënaqësi trokitjen e derës, sikur në shtëpi po na prishen tepricat... Me kalimin e kohës Behija po mësohej me natyrën e burrit të dashur.

Pas një viti çifti Habili priste lindjen e fëmijës së parë. Kjo ngjarje, më e njohura në botë, atyre u dukej si diçka e çuditshme dhe krejt e rrallë. Shpeshherë Kujtimi mbështetej në minder dhe shikonte me kënaqësi të shoqen tek thurte një triko, një palë doreza apo një palë çorape të bardha të vockla, për atë që do të vinte në jetë. Dhe mendja merrte vrapin nëpër kujtime të dhimbshme, të largëta, kthehej në rrjedhën e viteve, ndalonte një çast nëpër gëzime të ndeshura gjatë jetës e kthehej prapë në kuzhinën e ngrohtë. Pranë gruas i shfaqej një fëmijë i shëndetshëm që jepte e merrte

për të veshur ato rroba të vockla që po thurte e ëma. «Eh, mor qeratuci i kantiereve, po bëhesh babë, me sa duken punët!» — mendonte me vete. Behija ia kishte kushtuar gjithë kujdesin fëmijës së ardhshme. E shqetësonte vetëm një gjë: Çfarë do të lindte? Eh... sikur ta dinte! Vetëm për t'ia bërë të gjitha gati sipas gjinisë.

Një ditë sapo mbaruan drekën Behija e pyeti të shoqin me pamje të merakosur:

— Kujtim, — të ka zënë syri nëpër dyqane varëse nga ato të bukurat prej plastmasi?

— Oh, ç'hall paska nusja ime! Ka sa të duash edhe këtu te baraka më tej shtëpisë sonë.

— Nga ato të mëdhatë? Ato i di, por unë them për të vogla. Doja një varëse të vogël, të vendosja në dollap rrobat e bebit.

Kujtimi ia dha të qëshurit. Obobo ç'hall paska nusja ime, o shokëni, — tha, po kur pa fytyrën serioze të së shoqes, e mori për qafe dhe i tha:

— Mos u mërzit, e dashur. Kjo çështje do parë. Fundja i shkruajmë një letër ndërmarrjes së plastikës në Durrës. Janë në vete ata, apo jo! Çifti më i gëzuar në botë po lind fëmijë, kurse ata ende nuk i kanë vënë gishtin kokës!

— **Ikë tashti, Kujtim. Ti gjithmonë me të tallur flet,** — i tha e shoqja dhe e shtyu si e zemëruar...

Behija kishte marrë lejen e lindjes e numëronte ditët e ngatërruara për t'u shtruar në maternitet. Kujtimi punonte për ndërtimin e një uzine të re. Brigada e montimit, duhej ta dorëzonte në prag të 1 Majit korpusin kryesor të uzinës. Kështu që i duhej të punonte shpesh edhe jashtë orarit bashkë me shokët e brigadës së tij. Ai punonte

me mendje të tendosur, jo vetëm nga kërkesat e profesionit të tij delikat, por edhe ngaqë herë pas here, në punë e sipër, kujtonte porosinë e së shoqes: «Kujtim, këto ditë mos më lerë vetëm, sidomos në mbrëmje. Kthehu shpejt, të lutem. Kushedi kur më ndodhin shqetësimet».

Më njëzet e gjashtë prill, brigada e montimeve i mbylli punimet kryesore. Kishin mbetur plotësime të vogla. Me këmbënguljen e shokëve Kujtimi u largua nga puna aty nga ora gjashtë e mbrëmjes. Ecte me hapa të shpejtë me mendjen te gruaja e me gëzimin që, brigada e drejtuar prej tij, në 1 Maj do të inauguronte korpusin kryesor të uzinës. «Bëj punën, ngri oxhakë uzinash, pri shirita litarësh e s'ke nevojë të rrahësh gjoksin, oxhakët i shikon dhe qielli», — u thoshte ai shpesh shokëve të tij, kur ndonjëri numëronte veprat në të cilat kishte punuar.

Në rrugën «Konferenca e Pezës» u takua me Lekë Bibën. Kishin një muaj pa u parë. Ata ishin njohur vite më parë në montimin e makinerive në Uzinën Kimike të Laçit. Atje kishin banuar një vit në një dhomë. Kujtimet e vjetra nuk i kishin lënë t'i rrëmbenin vitet. Edhe tashti që punonin në ndërmarrje të ndryshme, ata takoheshin, shkëmbenin biseda e përtërinin kujtimet.

— Qenke dimër fare sonte. Çfarë dreqin ke kështu derëbardhë? — e pyeti Kujtimi shokun e vjetër.

— Sa mirë që të takova, Kujtim... hajde të ulemi diku të marrim nga një gotë, — i tha shoku zymtë.

— Të them të drejtën unë nxitoj një çikë Lekë, poo... ecim e bisedojmë rrugës.

— Jo, po më deshe, të rrimë një copë herë.

— Ç'ke xhanëm, të ka ndodhur gjë? Apo të ka hipur kot ndonjë hije? — e pyeti Kujtimi kureshtar.

— Jo. Kam diçka, — tha Leka dhe e tërhoqi përkrahu.

U futën në një berrari e morën nga një gotë më këmbë.

— Pa më thuaj ç'ke kështu? — e pyeti përsëri Kujtimi i shqetësuar.

Lekë Biba e ktheu gjysmën e gotës pa frymë, e pasi i nguli sytë shokut i tha:

— U ndava me Violetën, u prisha me prindërit e saj.

— E pse kështu, ti më fole aq mirë për atë familje.

— Ashtu është, të mirë janë. Njerëz të ndershëm... atë vajzën kisha nisur ta doja seriozisht... dreqi ta hajë, për pesë pare spec u prish mendimi për të rregulluar jetën. Më në fund do t'ia bëja qejfin dhe nënës... por ja... punë dreqi...

Kujtimi e pa se shoku fliste i nervozuar, bile disi i pirë, prandaj e zuri përkrahu dhe i tha:

— Pa më shpjego pse u prishe me ta, xhanëm?

— Para dhjetë ditësh e premë me prindërit e Violetës fjalën për fejesë. Të nesërmen unë shkova në Mirditë të merrja certifikatën për të ligjësuar fejesën. Mirëpo në certifikatë ishte shënuar kryerja dhe prishja e asaj fejesës së parë. Kështu që unë figuroja i ndarë nga një grua. Kur solla këtu certifikatën, solla dhe prishjen. Familja e vajzës e priti këtë si një gjë të rëndë, si mashtrim. Edhe Violetës iu trondit dashuria dhe respekti. «Nuk të pata ndonjë borxh të ma bëje këtë, tashti që

njerëzit e morën vesh fejesën tonë, bile shumë shogë dhe më kanë uruar,» — më tha me keqardhje ajo. Nuk e merr me mend sesa e urreva veten kur pashë që në sytë e saj u dukën lot. Ç'pyet, or Kujtim. Dje mbrëmë biseda u kthye në një gjyq. Babai dhe xhaxhai i Violetës më thanë: «Po pse, o bir, na e bërë këtë lojë? Ç'faj të kemi? Kjo familje nuk është mësuar me gjëra të tilla. Ne të morëm për djalë të mirë e të deshëm si djalin tonë, tashti na del se paske pasur dy faqe. Pse nuk na i sqarove këto gjëra që në fillim?» Nëna e Violetës fshinte lotët. Violeta rrinte në dhomën e pritjes vetëm. Kurse unë rrija si dru gardhi... E po më ngushtë s'e pata parë veten.

— Ç'më thua, or Lekë! Nuk ua shpjegove ti se ç'fejesë qe ajo?

— U thashë pra, se nuk u kisha treguar, jo për mashtrim, por se ajo ngjarje kishte marrë fund që në atë kohë që u prishën gjithë fejesat e padrejta të kryera në mituri nga prindërit. U thashë se nuk doja që në këtë gëzim, në këtë familje të mirë, t'i kujtoja ato vjetërsira të kanuneve. U thashë se më vjen shumë rëndë për këtë që ndodhi, por se kjo gjë nuk duhet të na prishë. Unë nuk kam qenë i martuar. Ç'keni me letrat e shkruara? Fakti është jeta... E ku di unë se ç'thashë. Isha bërë tym.

— E pastaj, — e pyeti Kujtimi i çuditur me këtë ndodhi të nxituar.

— Pastaj, babai i vajzës më tha: «Ne të kemi dashur. Na vjen shumë rëndë që ndodhi kështu. Ti je fajtor ndaj nesh, nuk u tregove i singërtë. Tashti hajde mbyll fjalët e dynjasë... Vajza jonë nuk ka pse të celebrihet me një ish të martuar.

Prandaj në këtë shtëpi nuk mund të vish më si dhëndër!» Shiko sa mirë më tha! Ai mund t'i thoshte kokës sime: dil përjashta, por u soll me takt. Me ato fjalë më vrau më shumë. Më kot u përpoqa më tej. Nuk kisha më guxim të qëndroja. Dola nga ajo dhomë ku kisha ndjerë gëzim, si njeri i lig. Kur kalova në korridor hodha sytë në dhomën e pritjes dhe pashë Violetën me sy të për-lotur. E pse nuk më ra tavani, dreqi ta hajë!

— Mos e bëj kaq tragjike, ndoshta do të rregullohet puna.

— Ç'do të rregullohet? — pyeti shoku i pakënaqur. — Kjo punë mori fund.

— Nuk di për nder, po më habit, për një gjë kaq të thjeshtë të prishet gjithë ajo punë e mirë. Ti më ke thënë fjalë të mira për njerëzit e Violetës. Këtë pengesë të vogël ata mund ta kalonin me pak logjikë e zemërgjerësi. Nuk ka këtu arsye të fortë për prishje.

— Jo, Kujtim, ata kanë këtu një arsye. Në certifikatë unë figuroj i martuar një herë. Kjo është diçka zyrtare, ku e dinë ata si qëndron e vërteta? Jo, or ti, është jetë kjo, ohu, ka ndodhur që ka fshehur tjetri edhe të kaluarën e tij të keqe dhe është futur në sofër me burra... pa shkak s'janë ata, tjetër gjë se më prishet mua puna, apo duhet të kishin më shumë besim.

— Po mirë ata, po ai dajoja? Më ke thënë se Violeta ka një dajo me detyrë partie?

— Po, instruktor e ka, bash në Komitet.

— Atëherë ç'pret? Nuk i vajte atij? Ti më ke thënë se ai e ka ndihmuar këtë fejesë.

— I kam shkuar sot dy herë e nuk e takova dot. Është i zënë, më thanë. Do t'i kenë treguar

atij dhe nuk ka dashur të më presë.

— Jo, këtë nuk ma merr mendja, — ia preu fjalën Kujtimi.

— Tashti jemi para festës dhe ai mund të jetë i zënë. Shkoi në shtëpi fundja.

— Nuk di si të bëj, dreqi ta hajë... Unë kam shkuar në shtëpinë e tij bashkë me Violetën dhe të atin. Kam shkuar si dhëndër i mirë e tashti të shkoj si gënjeshtar... jo, or ti, e pat kjo punë... Më vjen keq se e kisha nisur me gjithë zemër. Nuk di pse më ishte mbushur mendja se ajo vajzë do të më sillte gëzime në jetë.

— Po vetëm për vetëm me Violetën nuk bisedove?

— Bisedova. Ajo e kupton më mirë se ata, që këtu nuk ka lumë që s'kalohet, por është nën ndikimin e prindërve. Me thënë drejt, ata ka, pastaj edhe zemra i është trembur... diçka dyshon dhe ajo. Këtu, or Kujtim, ka një të keqe tjetër: Ne nuk u njohëm gjatë, nuk iu futëm mirë jetës së njëri-tjetrit. Nxitimi bëri që unë të mos futesha në të kaluarën. Me thënë të drejtën as që më kishte shkuar mendja te certifikata.

— Po sikur t'i vihem unë një herë kësaj pune? — pyeti papritur Kujtimi.

— Ti?! Ata as të njohin, as i njeh.

— Kjo s'ka shumë rëndësi, sepse ma thotë zemra që diçka do të bëjmë, — tha Kujtimi i gjallëruar. Në habinë e nderë te fytyra e shokut, ai dalloj një fije shprese. Kjo i dha guxim më shumë dhe e përsëriti mendimin e tij:

— More diçka do të bëjmë... Duhet të merremi vesh.

— Po si, praktikisht, Kujtim? — pyeti shoku,

i cili kërkonte tani mbështetje. Një gjë ai e dinte mirë: po t'i vihej Kujtim Habili një pune do t'i nxirrte ujët edhe duke e larë me djersën e tij.

— Unë do të takoj instruktorin.

— Sonte? — e pyeti shoku me sy të ndezur.

— Që sonte do ta kërkojmë. Ka telefon në shtëpi?

— Po, ka. Bile ia di dhe numrin përmendësh.

— Atëherë, o burra, — i tha Kujtimi dhe i zgjati banakierit pesë lekë. Leka e kundërshtoi me këmbëngulje, por ai ia preu me të qeshur: — DOLLINË sonte e kam marrë unë, lermë të na shkojnë mbarë punët.

Në postën qendrore Kujtim Habili futi njëzet qindarka në kutinë e aparatit, ngriti receptorin dhe formoi katër numra. Në receptor u dëgjua një zë gruaje. Lekë Bibës nuk iu durua dhe shkeli sustën. Shoku i tij i buzëqeshi dhe u përqëndrua.

E shoqja e instruktorit të Partisë Vasil Panajotit, i tha Kujtimin në telefon, se burri i saj do të kthehej vonë, pasi ishte në një mbledhje në Komitet.

— Është në një mbledhje në rajon, — i tha Kujtimi shokut.

— Ç'do të bëjmë? — pyeti Leka.

— Do të shkoj të pyes në rajon... do ta pres, tashti duhet të dalin. Ti do të vish?

— Jo, Kujtim, unë do të pres në rrugë. Nuk më bën zemra t'i dal përpara, sidomos tashti. Ti e kupton se i kam hedhur tri-katër gota. Bisedo ti një herë. Po të shkojë mirë puna, mua këtu më ke.

— U nisën së bashku trotuarit për në rajon e si u afruan nja dyzet-pesëdhjetë metra Leka u ndal.

— Ju lutem mos është gjë këtu Vasil Panajoti? — pyeti dezurnin e rajonit Kujtim Habili.

— Këtu është, por janë në mbledhje, — iu përgjigj ai.

— A thua do të vonohen?

— Nuk e di, për nder, me sekretarin e parë e kanë. Të kishe ardhur pak më parë, do ta kishe takuar, pasi bënë një pushim të shkurtër.

— Ëhë... do t'u vonokan, — tha si nëpër dhëmbë Kujtimi dhe doli nga oborri i rajonit.

«Kujtim, mos më lerë vetëm këto ditë, të lutem», — i erdhën ndër mend papritur fjalët e gruas. «Sot do të kthehesh shpejt, besoj» — i pat thënë ajo në mëngjes, kur ai e mbështolli në gjoks përpara se të dilte nga shtëpia. Akrepat e orës elektrike pranë kinemasë «Rinia» shënuan orën tetë e njëzet. Një parandjenjë e keqe ia ngacmoi shpirtin Kujtim Habilit. Mos i ka ndodhur gjë Behijes... mos e kanë shtrënguar dhimbjet? Një skenë e ligë: gra, fëmijë, komshinj, gruaja në asfiksi, iu fanit në mendje, por ai i hodhi tej mendimet e këqija. Iu afrua shokut të mërzhitur dhe i dha zemër: «Do ta presim».

Akrepat e orës elektrike e kaluan nëntën. Nga dera e komitetit të rajonit nuk po dukej njeri. Natë. Nga jugu frynte një erë e ftohtë. Lart mbi ndërtesat e kryeqytetit rrokulliseshin re të murme të lagëta. Akrepi i vogël i orës elektrike po i afrohej dhjetës. Ata të rajonit vazhdonin mbledhjen. «Kushedi ç'mbledhje kanë... punë plot... viti shtatëdhjetë e pesë», — mendoi me vete Kujtim Habili.

Kujtimi i tregoi shokut hallin që kishte në shtëpi.

— Je në vete ti? — ia priti shoku i shqetë.

suar. — Ke gruan në këtë gjëndje dhe rri këtu? Turp, për nder! E pse nuk më the që në fillim? Eja të ikim, kurrë mos u bëftë kjo punë!

— Jo! Do të presim deri në orën dhjetë.

— Asnjë minutë, — tha shoku dhe e tërhoqi përkrahu.

— Mos u ngut, Lekë, ja dhe një çerek ore është. Lërmë se po futem dhe një herë në rajon.

Dezhurni i tundi kokën duke dashur t'i thoshte: «më kot pret, kushedi kur dalin ata». Ai i mërzitur, doli nga rajoni. E përsëri në mendje i erdhën porosinë e gruas: «Mos më lerë vetëm. Kujtim».

— Eja të ikim! Ata do të vonohen me sa duket, — i tha Leka.

— Si t'ia bëjmë more, e marrtë e mira! — tha si të fliste me vete Kujtimi. Shoku i futi krahun e pasi bënë një copë rrugë në heshtje, i tha:

— Kur merr puna për keq nuk kthehet nga e mira, or ti...

— Jo, or jo. Do të bëhet e mira se s'bën, — ia preu fjalën Kujtimi. — Nesër do të takohemi bashkë që në mëngjes dhe...

— Unë duhet të nisem qvsh sonte natën për në Elbasan. Më duhet të shpie në fabrikë të çimentos një gjenerator. Në të vërtetë duhej ta kisha çuar që sot.

— E kur do të kthehesh?

— Nesër vonë, ose pasnesër në mëngjes.

— Atëherë dëgjo këtu si do ta bëjmë, — tha Kujtim Habili e pasi u mendua një çast e pyeti.

— E ka afër shtëpinë që këtu, ky Vasili?

— Posi, në pazar të ri, në rrugën «Qemal Stafa».

— Nxito të më tregosh shtëpinë e tij. Nesër do ta kërkoj në telefon, ose do t'i shkoj në shtëpi.

Këto fjalë Kujtimi i tha me aq bindje, sikur të ishte fjala për një mik të njohur. Leka ndali hapat dhe po e shikonte sikur të dyshonte në fjalët e shokut.

— Po më çudit, Kujtim. Nuk e kuptoj këtë siguri që ndien ti... atë nuk e njeh fare dhe...

— E ç'ka të çuditshme këtu? Ai është komunist, b'ile, kuadër. Unë do t'ia shtroj çështjen duke e parë me syrin e kohës. Ai nuk duhet të lejojë që njerëzit të ndahen për hir të një zakoni të keq, i cili u hodh poshtë. Ai këtë nuk duhet ta lejojë, si propagandist në radhë të parë.

— Ku di unë ç'të them, or ti, — i tha Leka duke mbledhur supet.

Në rrugën «Qemal Stafa» përballë një ndërtese trikatëshe ku banonte familja Panajoti të dy shokët u ndanë.

Kujtimi po ecte me hapa të nxituar. Shpirtin ia mbërtheu përsëri shqetësimi. Kur doli përballë pallatit të tij, hodhi sytë në dritaret e kuzhinës. Në shtëpi nuk kishte dritë. Një valë e ftohtë ia përshkoi gjithë trupin. Në gjoks ndjeu një ndrydhje të rëndë. I ngjiti shkallët deri në katin e katërt. Më kot i ra ziles. Nga brenda asnjë zë. Shqetësimi iu shtua. Trokiti në portën e fqinjit.

«Mos është këtu, apo mos ka shkuar te prindërit! Po përse? Ajo 'në këtë orë nuk del!» — mendoi. Trokiti përsëri më fort, por nuk u përgjigj njeri. Zbriti shkallët me të shpejtë, e pasi kaloi dy rrugicat paralele u gjend, brenda dhjetë minutave, në shtëpinë e vjehrrit të tij. Portën ia hapi e vjehrra.

— Ku ishe, mor djalë, kaq vonë ti? — e pyeti ajo me një ton ku ndihej pakënaqësia, por sapo vuri

re shqetësimin e tij u pendua për pyetjen e papritur e të nxituar.

— Ç'ka ngjarë, ku është Behija?

— Asgjë s'ka ngjarë! Behija është në maternitet, — i tha ajo e qetë.

— Si?... — Kush e shpuri?!

— E kishin zënë dhimbje të forta në orën tetë e gjysmë. Kishte thirrur fqinjën. Ajo e shkreta me gjithë të shoqin kishin kërkuar nëpërmjet telefonit të një familjeje aty pranë një taksi. Pasi e hipën në taksi, kaluan këtej dhe morën me vete dhe Arifin.

— U kthye Arifi?

— Po, në kuzhinë është me gjithë djalin.

— Si e la Behijen?

— Mirë, thotë. Kur u nis mezi fliste, e shkreta. Thuaj shyqyr që u ndodhën ata fqinjët. Sa njerëz të mirë... Tashti hiç mos ki merak, ka kujdesin e mjekëve atje.

I vjehri dhe i kunati e pritën në kuzhinë me ngrohtësi. Ata u përgatitën të largonin çdo shenjë pakënaqësie, qëkurse dëgjuan në oborr bisedën e Kujtimit me të vjehrrën.

— Si u ngrysët? — tha Kujtimi dhe i dha dorën të vjehrrit.

— Mirë, or bir, ti si u ngryse?... Paski pasur shumë punë sot?

— Po... jemi në përfundim të objektit dhe u vonova ca, si dreqin ndodhi sot kjo... si ishte Behija?

— E po... kështu vijnë këto punë... mos ki merak... ajo është mirë. Pse je shqetësuar kaq ti, mor bir? Ç'të tha ajo..., që i bën tragjike gjërat? — tha Arifi për të shoqen.

— Qyqja! Ç'ke ti mor burrë, asgjë s'i thashë unë.

— Jo, nuk më tha gjë ajo, po më vjen inat... ku qëlloi sot që unë u vonova!..

— Pa hajde ulu, qetësohu! Hidhna nga një gotë, grua, një çikë djathë, një sallatë... Gëzuar Kujtim, ishallah një djalë... ç't'u dojë zemra juve, por mua kështu ma do, — i tha i vjehrrin dhe ngriti gotën me buzë në gaz. Kujtim Habili e lexonte në sytë e njerëzve të gruas shqetësimin e tyre. Ishte viti i katërt që ai ishte lidhur me ta. Kishte gjetur në gjirin e tyre atë ngrohtësi që nuk kishte pasur fatin ta gjente te prindërit e tij. Ishte futur plotësisht në jetën, në mendimet, në karakterin e tyre, prandaj e pyeti të vjehrrin:

— Është mirë Behija, apo diç më fshihni mua?

— Jo, për fjalë të nderit, nuk ka gjë, por ja... u shqetësuam një çikë se i erdhi si e papritur. Kur e shpëmë nuk qe mirë, por menjëherë mjekët i dhanë ndihmën e parë dhe u përmirësua. Kështu na tha një mami, e cila na solli teshat e saj.

— Nesër në mëngjes unë do të shkoj deri në uzinë. Do të shkoj që herët të njoftoj shokët e brigadës dhe do të kthehem shpejt, — tha Kujtimi.

— Po mirë, mor bir. Ne do t'i shkojmë që në orën shtatë në maternitet... ndoshta kur të kthehesh ti do ta gjesh gëzimin përpara, — i tha vjehrrin dhe ngriti gotën.

Të nesërmen në orën gjashtë e gjysmë, Kujtimi mori në telefon maternitetin nga dezurni i ndërmarrjes. Ndërsa po priste tërë kureshtje në receptor të telefonit, pranë veshit i erdhi një zë gruaje:

— Alo?

- Urdhëroni.
- Për Behije Habilin pyetët?
- Po, shoqe.
- Mirë është!

Kjo përgjigje Kujtimit iu duk shumë e shkur-
tër, e ftohtë, si e pajetë, prandaj e pyeti sërish:
— Ju lutem më shpjegoni diçka... ajo ka ar-
dhur mbrëmë shumë e tronditur, nuk...


— Mos kini merak, shok. Ashtu vijnë në fillim
këtu, por lehtësohen menjëherë. Nuk ka lindur
akoma, por mirë është, — vazhdoi zëri. Kujtimi
lëshoi receptorin dhe doli nga zyra e dezurnit.

Në orën shtatë i erdhën shokët e brigadës.
Kur u tregoi për gruan, ata i shtrënguan dorën
duke e uruar dikush për një djalë, një tjetër për
vajzë, e ndonjëri: pse jo të dy njëherësh. Ngroh-
tësia e shokëve ia shpërndau Kujtimit shqetësimin.
Shokët e brigadës ngulën këmbë që ai të shkonte
të interesohej për të shoqen, por Kujtimit i erdhi
rëndë: «Jo, jo. Do të punojmë nja dy orë bashkë
sa të mbyllim dhe kondensatorët. Erdhi 1 Maji
dhe duhet të bëjmë një provë para inaugurimit»,
— u tha shokëve dhe iu vunë punës.

Në orën dhjetë Kujtim Habili i zbriti autobu-
sit në qendër të qytetit dhe mori poshtë bulevardit
të gjerë me hapa të nxituar. Përpara maternitetit
ishin grumbulluar shumë njerëz. Secili mbante në
dorë një rrjetë a një pako me ushqime. Kujtimi
u fut midis njerëzve dhe iu afrua sportelit.

— Shoqe, më falni një minutë ju lutem, — i
tha një gruaje të shëndetshme, e cila ishte për-
kulur mbi një tryezë e diçka po shënonte mbi një
fletë modelari.

- Urdhëroni, shok



— Desha të pyes për një Behije Habili... është shtruar mbrëmë dhe nuk di si do të jetë.

— Në ç'orë ka ardhur?

— Më duket se aty nga ora nëntë.

Gruaja e shëndetshme, e veshur në të bardha, kërkoi dikë në telefon dhe pasi mori përgjigjen këneu fytyrën nga Kujtimi dhe e pyeti:

— Çfarë e keni Behijen ju?

— Grua, — u përgjigj gati me gjysmë zëri Kujtimi.

— Keni fëmijë të tjerë?

— Jo! Pse, si është puna?

— Epo... të rroni vetë... si t'ju them, ju jeni të rinj... fëmija ka vdekur... Djalë ishte... vdiq në lindje e sipër ose pak pas lindjes.

Kujtim Habili mbështeti bërrylin te sporteli. Në atë çast iu duk sikur miliona miza iu futën në gjak dhe morën vrapin e tërbuar nëpër gjithë qënien e tij. Shtrëngoi nofullat për të mos e dhënë veten përpara gruas me të bardha. «S'duhet ligështuar burri për një foshnjë që nuk e pa botën», — mendoi dhe pyeti gruan në sportel:

— E ëma si është, mos ka ndonjë rrezik dhe ajo?

— Jo! Ajo është mirë, por... shkruajini një copë letër, i jepni pak kurajë. Ne gratë jemi më të ndjeshme. Nuk duhet të mërziteni! Tashti s'apo doli një grua, e cila ka hall më të madh se ju, është i treti fëmijë që i vdes në bark, pasi mbush tetë muajt... shkruajini gruas dy fjalë të ngrohta, do t'ia shpie unë.

— Ju faleminderit për kurajën... po me fëmijën ç'do të bëhet?... Nuk kam pasur rastin... nuk di si...

— Ja, prisni një minutë, do t'ju jap certifikatën për të bërë formalitetet e varrimit.

— Ku është fëmija?

— E kanë çuar në autopsi.

— Po pse në autopsi?

— Po... janë rregulla... mjekët kërkojnë të dinë se përse vdiq... duhet shkak... duhet luftuar vdekja për të tjerët. Nesër do ta varrosni. Është rregull, pas njëzet e katër orësh.

Ndërsa Kujtim Habili shkruante dy radhë optimiste për të shoqen, nga lart dëgjoi një zë gruaje.

Ngriti kokën dhe shikimi i ndeshi në një fytyrë të panjohur, të qeshur e të shëndetshme.

— Hë, Drita? Ç'kemi, si është djali, — i thirri gruas që ishte zgjatur lart në dritare një burrë i cili qëndronte pak prapa Kujtim Habilit. Në dorë mbante një qeskë najloni me portokalle.

— Është shumë mirë, Gimo, buçko fare, s'e ke idenë sa i shkathët është. E di sa të ngjan? — i thoshte gruaja të shoqit që nga dritarja.

Kujtim Habili uli kokën mbi letër dhe shkroi: «E dashur Behije. Mos u mërzit. Në jetë ka njerëz që gëzojnë shumë. Ka dhe të tjerë që hidhërohen. Mendo Vangjon e shkretë, që e ka vajzën dymbëdhjetë vjeçe të paralizuar për jetë nga mesi e poshtë... Ruaj shëndetin dhe më shkruaj ç'të nevojitet. Ne do të kemi fëmijë patjetër! Mbahu e fortë!»

Në lëvizje për të kryer formalitetet e varrimit mendimet i përziheshin, e mundonin. Për një çast e ndjeu veten të ndrydhur, fatkeq. Pas disa vjetësh të qeta u bë shkak vdekja e foshnjës së tij, për t'u futur në kujtimet e hidhura të fëmijërisë.

— Çfarë moshe është fëmija? — e pyeti punonjësi i zyrës së varrimeve.

— Foshnjë, — iu përgjigj Kujtimi.

— Arkivolët i kemi të gatshme. Do të blini dhe një copë kambrik të bardhë... qefin, — fliste punonjësi i varrimeve duke plotësuar një modelar.

Në atë zyrë të ftohtë, me pesë a gjashtë karrige, ku rrinin njerëz të zymtë, të menduar, të përloitur, të cilët porositnin arkivolë, Kujtim Habilit i vërshuan kujtime të hidhura:

«Një vargan i gjatë grash të veshura me të zeza zbrisnin faqes së një kodre dhe futeshin me ulërima në shtëpinë e tij, në fshat. Ishte vdekja e babait. Kujtimi, dhjetëvjeçar, shikonte me habi e keqardhje varganin e grave, që sapo ngjiste shkallët mbushte shtëpinë me zëra, me vajtime të thurura, me ligje..»

«Mos e lësho veten, bija e nënës... mjaft qave... kështu e kishte shkruar zoti: Të të rrojë djali... mjaft fashti, të bijtë e vdekjes jemi të gjithë». Këto fjalë që dikur ia pat thënë s'ëmës një plakë e moçme. i erdhën Kujtim Habilit nga honi i viteve, aty në zyrën e varrimeve. Iu duk sikur bota e madhe, e tërë jeta e bukur, u mbyll në atë dhomë të zymtë.

— Na duhet një autobus të shoqërojmë të vdekurin, — tha njëri.

— Prisni shok, me radhë, — tha nëpunësi gjakftohtë.

Kujtim Habili. i mori nga dora lehtëvarrimin dhe doli nga ajo dhomë me nxitim, sikur druhej se mos e mbyllnin aty për fare. Sapo doli në trotuar, i hodhi shtë në mbi morinë e njerëzve. që lëviznin tërë gjallëri dhe u përzie me gjithë shpirt me jetën që ziente. Pa prituri në mendie i erdhi futyra e menduar e Lekës, e shokut të tij të vjetër: «Eh more

Lekë... për ty nuk bëra asgjë sot... Ti do të kthehesh sonte dhe unë do të të jap lajme të hidhura... Ti do ta ndiesh veten fajtor që më vonove mbrëmë!...»

«Jo, ore, ç'faj pate ti!?» Nëpër kësi mendimesh kujtoi premtimin që i kishte dhënë shokut, e përsëri u fut në bisedë me veten: — E pse të mos i shkoj tashti në shtëpi atij instruktorit? Deri nesër në mëngjes s'kam asnjë punë. Të shkoj në shtëpi do të më ndrydhë vetmia... Edhe te vjehri do të gjej fytyra të menduara, që do të m'i ngulin sytë me keqardhje... Jo! Jo!... Merru më mirë me një punë të gëzuar... të gjallët duan gëzim... ndryshe vdekja do të na ndrydhte gjithë jetën.

Në këto mendime mori autobusin dhe zbriti në Rrugën e Dibrës, në stacionin e parë. U kthye në të majtë, doli në rrugën «Qemal Stafa» dhe ngjiti shkallët e pallatit 53/4. Në një copë metalike në formë trapezoidi, të mbërthyer në derë, lexoi: Familja Vasil Panajoti. U mendua një çast. Aty përpara asaj porte të paniohur, iu duk vetja si një nieri që vepron në gjumë. Ngriti dorën dhe i ra ziles.

Në pak sekonda u hap dera. Përpara Kujtim Habilit doli një grua rreth të tridhjetave, me një fytyrë të qeshur rrumbullake.

Më falni, shoku Vasil është këtu?

- Jo.
- Sa keq... thë gati si me vete Kujtimi.
- Pse, ç'kishit me të?... Ndonjë hall urgjent?
- Po, ju kam marrë edhe dje në telefon. Më duhej ta takoja patjetër.
- Poo... Urdhëroni brenda. Ma thoni mua ha-

llin në qoftë se s'ka ndonjë të keqe, — i tha ajo ngaqë në fytyrën e Kujtimit lexoi shqetësim.

— Jo, nuk ka të keqe. Bile ju mund të më ndihmoni. Me sa di unë, jeni në dijëni të çështjes. — Kujtim Habili u fut në kuzhinë. Sa u ul në një divan, shikimi i mbeti përballë në një kornizë metalike të hollë ku ishte vendosur një fotografi plot gëzim e jetë. Ishte çifti Panajoti me të dy fëmijët. — Ju, besoj se e njihni Lekën, — e vazhdoi bisedën Kujtimi, në kohën që e zonja e shtëpisë i vuri përpara një gotë pije në një tabaka të punuar me pirografi.

— Lekë Bibën? — pyeti ajo.

— Po.

— E njoh, posi!

• — Për çështjen e tij kam ardhur. Ai më ka folur me respekt të veçantë... për ju dhe për shokun Vasil. Leka kishte vendosur të fejohej me një vajzë me të cilën ju keni të bëni.

— Po, po, me Violetën.

— Mirëpo dje pasdite ata janë prishur... janë prishur mendoj, për një gjë të vogël... pa arsye.

— Po, po... sot në mëngjes më thanë dhe mua. Erdhi nëna e vajzës dhe kërkoi Vasilin, por ai kishte ikur që herët, pasi do të shkonin jashtë Tiranës në kremtimin e përvjetorit të një heroi.

— Më falni poo, desha të më flisni si vëllait tuaj. Ka logjikë kjo punë? Për një mosmarrëveshje kaq të vogël të prishet dashuria e njerëzve?!

— Nuk di si t'ju them!... Ata e donin shumë Lekën, e kishin me shumë zemër këtë krushqi. Tashti janë hidhëruar pa masë e janë alarmuar. Ai, babai i vajzës është ca patriarkal dhe i rrëmbyer, por... edhe Leka ka gabim. Përse nuk e sqaroi këtë

çështje qysh në fillim. Ata e kanë hallin më shumë se do të dalë fjala që vajza e tyre u fejuar me një të martuar dhe hajde mbylli gojët. Sidoqoftë, unë, më të ardhur Vasil, do t'ia them çështjen. Atë e dëgjojnë shumë prindërit e vajzës.

— Atëherë, ju lutem shumë, bisedojeni çështjen me shokun Vasil, sapo të vijë. Ai është kuadër partie, nuk duhet të lejojë, që për një konflikt i cili në bazë nuk ka asgjë të keqe, të prishet lumturia e dy njerëzve. Ç'ka këtu? Leka ka qenë i fejuar që fëmijë. Kjo fejesë u prish dhjetë vjet më parë, kur koha i flaku tej zakonet e mykura. Leka ka punuar larg shtëpisë, të fejuarën as që e ka njohur, as që e ka dashur, prandaj dhe e la. Pra, realisht, ajo ka mbetur grua në letër, në shkresat e gjendjes civile. Në jetë s'ka ekzistuar. Ku është këtu e keqja?

— Ashtu është, keni të drejtë... nuk i qëndron logjikës, por ju thashë, ai, babai i vajzës... Megjithatë unë kam shumë besim se çdo gjë do të rregullohet. Vasil nuk do ta lërë çështjen kështu.

Ndërkohë Kujtimi u ngrit dhe në korridor i tha dhe njëherë së shoqes së Vasil Panajotit:

— Ju lutem shumë. Po jua besoj juve këtë punë. Unë nuk e kam timin në gjak Lekën, e kam vetëm shok, por më vjen keq se është njeri i mirë... më vjen keq për vajzën... ata duhen. Po jua besoj juve këtë gjë si motrës sime, pasi unë nuk kam kohë, këto ditë... Nesër më duhet të varros një djalë.

— Si? Ç'djalë? — tha gruaja e shtangur dhe e prerë në fytyrë.

— Eh... Kisha gruan shtatzënë dhe fëmija vdiq në lindje e sipër, apo sapo lindi.

— Keni fëmijë tjetër?

— Jo.

— Oh... të rroni vetë... të rinj jeni... Na falni... ju në këtë hall dhe vini të na mësoni të zgjidhim një konflikt të thjeshtë... Na falni.

— Ju lutem... nuk keni asnjë faj ju në këtë mes. Lutjuni burrit ta zgjidhë këtë çështje. Kjo do të më gëzonte shumë. Kjo do t'i gëzonte të gjithë. E, po të gëzojnë njerëzit e gjallë, harrohen dhimbjet e atyre që ikin, — tha Kujtim Habili dhe hapi derën.

— Mos kini asnjë merak. Kjo punë do të zgjidhet se s'bën, — i tha ajo duke e përcjellë deri në krye të shkallëve.

Kujtimi zbriste shkallët me shpirt të gjallëruar, me një gëzim në zemër, kurse gruaja e Vasil Panajotit e ndoqi me një shikim plot habi e dashuri derisa humbi në kthesën e shkallës së katit të dytë.

Zinxhiri i jetës së familjes Mero ishte formuar me hallka gëzimesh. Jeta kishte rrjedhur për ta e qetë, pa hidhërime. Vdekja e djalit të vajzës kishte qenë për ta hidhërimi i parë. Kjo vdekje e një foshnje i preku shumë të dy pleqtë e qetë. Kështu që, kur Kujtim Habili u kthye në mbrëmje në shtëpinë e tyre, ata me zor i mbajtën lotët.

— E po... kështu e paska kjo jetë, biri im... Të rroni ju, se të rinj jeni, — i tha Arif Meroja dhëndërit, duke e kthyer kokën më një anë, për të mos e dhënë veten në sy të tij.

Në shtëpinë e Merajve erdhën njerëz për ngushëllim. Ishin gra fqinjë, apo farefis i tyre. Biseda e grave vesh më vesh e shqetësonte atë natë Kujtim Habilin, por edhe të shkante në shtëpinë

e tij, të rrinte në vetmi, i dukej e padurueshme. Gjallërinë në shtëpi e solli Temoja, një dajoja i tij. Temoja ishte një plak rreth të shtatëdhjetë e pesave, i gjatë, i hequr, i dobët, tepër i dobët, por çuditërisht i gjallë e tërë humor. Jeta e tij e gjatë, në shumë vende të botës, me shumë mbresa, e kishte bërë atë që ta shikonte me gjakftohtësi hidhërimin dhe me entuziazëm të përmbajtur gëzimin.

— Burrë, biri i dajos, bota kanë kaluar nëpër hidhërime deri në brez, e prapë kanë ecur më këmbë me fillin e jetës në dorë, — i tha Temo Shira të nipit.. — Më shikon mua? Katër më kanë vdekur, po ja ku i kam gjashtë të tjerë. Ju shëndoshë, pa fëmijë... Ja, bast vë unë me ç'të doni, në qoftë se pas një viti nuk mblidhemi këtu me dolli për një djalë.

— Jo, dajo, — i tha me buzë në gaz Kujtimi, — nuk më lë lehtë kurajua, por më vjen keq për Behijen. Vuajti aq shumë e shkreta dhe i vajti dëm. Kam më tepër merak se ajo nuk ka aq kurajë sa ta harrojë shpejt këtë humbje e të shikojë shëndetin e saj.

— Hiç mos e vrit mendjen, ajo është në mes nesh, të gjithë do t'i japim nga një grusht kurajë. Hajde. të rroni vetë, bir! — vazhdoi ai dhe ngriti një gotë të vogël me raki, që ia kishin vënë përpara.

Aty nga ora njëmbëdhjetë e natës, Kujtim Habili shkoi në shtëpinë e tij (banonte nja treqindkatërqind metra më tej shtëpisë së vjehrrit). Kur hapi portën, në korridor, gjeti një copë letër. E mori me kureshtje dhe e shpalosi.

«I dashur Kujtim,

Erdha dy herë, po s'të gjeta. E mora vesh fatkeqësinë që të ndodhi. Sa keq më vjen! Ndoshta dhe unë u bëra shkak e të vonova rrugëve. Mos u mërzit Kujtim, jeta i ka këto. Shyqyr që të shpëtoi gruaja. Çështja ime ka marrë për mirë. Ndërhyrja jote veçanërisht në ato rrethana i ka prekur të gjithë. Vasili kishte shkuar te prindërit e Violetës, sapo kishte ardhur në shtëpi. Kur mësoi çështjen tënde, i ati i Violetës kishte thënë: «Pa ta shohim më thellë punën, një njeri që ka shokë të tillë, s'mund të jetë mashtrues». Nesër në mëngjes do të të vij në shtëpi.

Leka».

Gjatë gjithë ditës Kujtim Habili e kishte ndrydhur shpirtin, e kishte mbajtur veten përpara sportelit të maternitetit kur i thanë se djali kishte vdekur, edhe përpara vjehrrit të përlotur, kurse aty në shtëpinë e tij të heshtur, nuk i mbajti dot lotët...

ATJE KU BINDJA HODHI RRËNJË

Atë natë Xhemal Sula u kthye i menduar në shtëpi. Sa herë që ai rrinte i zymtë, as gruaja e as djemtë nuk e ngacmonin për të gjetur arsyet. Dy djem kishte Xhemali. Njëri i kishte zënë të njëzetat, kurse tjetri kishte ardhur dy vjet pas të vëllait. Nëpër hallet e jetës, që në të ri, Xhemali herë si bujk në të tjerë, e herë si bari pat bërë një farë prokopie dhe rronte në punën e tij. Tri-dhjetë dhi, një pendë që dhe një mushkë kishte Xhemal Sula në kohën që nis udhë tregimi ynë. Në fshatin Murriz atë e mbanin për njeri të ndershëm e disi të mbyllur në botën e tij. Ethet e luftës ishin përhapur tanimë edhe në këtë fshat malor. Këtej buronte mërzitja e Xhemal Sulës atë natë. Kur e shoqja po i shtronte në konakun e gjumit, ai, i ulur mbi një senduk, i tha:

— Sot më kërkuan Bekimin, o grua.

— Për ku? — e pyeti e shoqja dhe shtangu me velenxë në dorë.

— Për luftë.

— Korba, kush ta kërkoi?

— Zenel agai. Kanë filluar të formojnë çetën e «Ballit» dhe duan djem.

— E ç'i the ti? — pyeti e shoqja e trembur.

Xhemal Sula shfryu plot duf dhe tha si nëpër dhëmbë:

— Ç'të thosha, moj grua... po përzihen punët keq... mënjanë këta, në anën tjetër komunistët, në tjetrën italianët e pastaj kushedi ç'dreqin do të dalë... të gjithë djem për dyfek duan... Isha si desh zoti... hoqa kaq vjet vuajtje e mezi u ngula në punën time. Mbyll vathën në darkë e më gëzon zemra që ato pak dhi janë dhitë e mia, puna ime... djemtë e mi... ee... ja tashti na del lufta të na i djegë të gjitha.

Gruaja hoqi në zemër dhe e pyeti prapë e merakosur:

— Po ç'i the Zenel agait?

— Jo, — i thashë. — Nuk ta jap dot djalin. Tashti që u ngula dhe unë në punën time, t'i vë kazmën? Kështu i thashë, por ai e shpuri fjalën te ndihmat që më ka dhënë, te borxhi kur ngritëm këtë copë konak. Më zuri ngushtë meluni, por unë i thashë se djali është rritur tashti e nuk më dëgjon mua. «Lëre këtë muhabet, Xhemal Sula, — më tha, — ty ta dëgjojnë fjalën dhe burra në fshat, e jo djemtë e tu, po thuajmë, do të më ndihmohet dhe ti sot, si të ndihmova unë dje?».

— Nuk e di, Zenel aga... ta shohim këtë punë, ia ktheva sa për ta prerë atë llaf.

— Zot na ruaj... Ç'na duhet ne «Balli» e bishti, o burrë. Dy djem kemi si dy dritat e syve... jepi borxhin Zenelit dhe mos e mbaj me shpresa.

— E ku të gjej dhjetë napolona flori, moj?

— Shit dhitë... sa të bëjnë, dhjetë a pesëmbëdhjetë kokë... aman hiqna nga këmba Zenel aganë. Nuk i kemi rritur djemtë të na shkojnë për dhjamë geni.

— Mirë, mirë, ikë tashti e shtroju djemve dhe shiko mos e hap gojën për këto që të thashë. — i tha së shoqes. Ajo doli nga konaku, kurse ai u shtri mbi shtrojën e leshtë pa u zhveshur dhe ra prapë në mendime.

Ky shqetësim, që u fut atë natë në shtëpi të Xhemal Sulës, kishte hyrë si krimbi në dru, në të gjitha ato familje të fshatit ku kishte djem të rritur. Një pjesë e mirë e fshatit kishin anuar nga partizanët, kurse pjesa tjetër anonte nga «balli». Propaganda e «Ballit» ishte këmbëngulëse dhe komprometuese. Atje ku nuk zinte vend fjala e agait dhe e pasuesve të tij, zinte vend borxhi i ri ose presioni i një borxhi të vjetër që Zenel agai e kishte përdorur si gozhda e Nastradinit... «Balli» kishte parë dhe bukë. Partizanët kishin zemër dhe drejtësi. Këto të dy pesha fshatarët i vinin në kandar, por drejtpeshimi u ngatërrohej ngaqë e nesërmja nuk dihej. E vërteta të cilën e mbronin komunistët dukej, por ata që ishin me të vërtetën ishin të varfër, pa influencë. Kur ndonjë fshatar mbronte idetë e komunistëve, njerëzit e Zenel agait e kundërshtonin:

«Ç'do bëje ti sikur agai të të priste ujët e vaditjes, që e ka në meranë e tij? Ja kështu janë dhe komunistët... janë ngritur ca spurdhjakë që dhe prindërit e tyre nuk kanë qenë të zotët të ngopnin barkun me bukë dhe kërkojnë të ngrenë qeveri». Ky arsytim i vinte në mendime fshatarët e thjeshtë, të paditur e të vuajtur.

Alema, e shoqja e Xhemalit, për herë të parë gjatë jetës bashkëshortore, nuk ia mbajti fjalën burrit. Ai e porositi të mos e shqepete gojën për ato që i tha, por zemra e nënës nuk e përtypi dot

atë porosi. Ajo i tregoi, të nesërmen, të birit për bisedën e të shoqit me aganë. Bekim Sula e mblo-dhi zemrën e trembur të nënës!

— Mos u tremb, nëno. Unë nuk jam më i vo-gël. Di ta ndaj vetë egjrën nga gruri. Roje për Zenel aganë nuk shkoj unë edhe sikur babai të dojë... E ç'të mira kemi parë nga agai ne?

— Po ja, a të keqen... kur bëmë konakun i ka dhënë tyt eti ca parà borxh dhe...

— Dhe na i kërkon tashti njëqind fish! Prandaj ia ka dhënë, se mos i ka ardhur keq!

— Ku ta di unë, a të keqen, poo... shiko mos i thuaj gjë tyt eti se do të më bëjë qepaze.

Pas një jave Xhemal Sula bëri gati dhjetë napolona flori dhe ia shpuri agait te hija e një fiku të madh, ku ai luante bixhoz me miqtë e trimat e tij.

— Kush të nxitoi kaq, more Xhemal, unë nuk t'i kam kërkuar. Nuk jam në hall unë për dhjetë napolona të krimbura, — tha agai me mospërfillje.

— Epo, borxhi është si qerja në kokë, aga. E kam pasur merak dhe thashë ta hiqja këtë hall. Të faleminderit.

— Ashtu? — e pyeti agai duke e parë me bisht të syrit dhe kaloi prapë në kërkesën që kishte bërë një javë më parë.

— Këto mbaji, more Xhemal, kur të kesh me thes, m'i jep me trastë, po atë fjalën që të thashë në mulli, si do ta lëmë? Do të ma japësh Bekimin?

— Nuk ta jap dot, aga... unë nuk do të ngatër-rohem në punët e luftës. Do të shikoj punën time.

— Jo more, pse do të rrish këmbëkryq ti, kur të futen pipinot në shtëpinë tënde?

Xhemal Sula nuk e duroi atë pyetje dhe iu përgjigj hapur:

— Te unë nuk ka ardhur ndonjë italian, o Zenel aga, s'kanë ndonjë punë me mua. Në konakun tënd kanë ardhur oficerët italianë, që ditën e parë që u dukën në Murriz. Zotrote je kreu i krahinës, unë jam një copë bari dhish, që shikoj hallet e mia.

— Te unë kanë ardhur për bisedime, pasi kanë marrë vesh se ne do t'u dalim përpara, — tha me inat Zenel agai.

— Ku e di unë pse vijnë aga! Ç'më duhet mua... unë shikoj punën time. Të faleminderit për paratë, aga, — tha Xhemal Sula dhe pasi ia la përpara u largua duke përshëndetur sipas zakonit, me dorë në gjoks.

— E shikoni kopukun? Tashti që hodhi hallin nuk i duhet më agai. Nuk do ta hedhë me ne djalin, prandaj i solli dhe paratë. Hëm, e di unë si e duan këta, po dale-dale, — u tha Zenel agai atyre që rrinin pranë tij.

Xhemal Sula po ruante dhinë në një kodrinë të mbuluar me shkurre. Atje e gjeti komandanti i çetës partizane «Vetëtima». Xhemali e njihte komandantin Xhelo Bega. Kishte pasur rastin të njohet e të fjalosej me të. Xhelo Bega ishte një fshatar i thjeshtë nga një fshat fqinjë me Murrizin, por emri i tij ishte bërë i njohur në krahinë, pasi katër-pesë vjet më parë ishte dënuar me burg të rëndë nga ligjet e mbretit, sepse kishte qëlluar dhe plagosur një toger të xhandarmërisë mu në mes të pazarit. Me ardhjen e Italisë fashiste Xheloja u lirua nga burgu me ndihmën e disa komunistëve, të cilët punonin në fshehtësi të madhe. Ai sapo

doli u hodh me lëvizjen komuniste dhe pas dy a tre aksioneve të guximshme kundër fashistëve, u hodh në ilegalitet. Pesë vjet burg ishin bërë për Xhelo Begën një shkollë e madhe. Pasi ndezi një cigare me Xhemal Sulën ai u hodh në bisedën për të cilën kishte ardhur:

— Ti ke qenë gjithnjë njeri i ndershëm, ke jetuar me djersën tënde, ke dashur lirinë dhe punën e ndaj erdha të bisedoj hapët për një punë. Kam ardhur në emër të çetës «Vetëtima».

Xhemalit i dogji menjëherë zemra për djemtë. Për të larguar atë merak, mendoi për ndonjë ndihmë materiale, për të cilën do të kishin nevojë partizanët.

— Epo, thujma ç'hall të paska sjellë deri këtu, o Xhelo Bega.

— Kam ardhur të të kërkoj djalin e madh... Ceta jonë do njerëz që të luftojnë për liri, të shporrin italianët dhe bejlerët.

Pas një heshtjeje të gjatë Xhemal Sula iu përgjigj:

— Këtu më zure ngushtë, o Xhelo... djemtë i kam rritur me ibrete, nuk dua të më venë dëm... Ka një javë që ma kërkoi edhe Zenel agai për «Ballin» dhe ia preva shkurt...

— Pse me Zenel aganë në një tavë më vë mua, more Xhemal? Dera e Zenel agait e ka rrjepur miletin brez pas brezi, kurse unë jam si ti, njeri i vuajtur.

— Nuk ta pata aty llafin, more Xhelo, poo...

— Sido që ta kesh fialën, atë që ka rrojtur me djersë e nder mos e përzie me atë që ka qenë gjithë jetën shushunjë.

— More nuk më thua, ç'farë keni ndër mend

të bëni ju komunistët? - pyeti papritur Xhemal Sula.

— Ne do të hedhim fashistët në det dhe bejlerëve e tregtarëve që shfrytëzojnë popullin t'u vëmë fre.

— Ore, ta thotë mendja se do t'i arrini dot këto?

— Pse të duken të pamundura, nuk më thua?

— Po ja, more vëlla, ata kanë pasuri, kanë parà e koçekët i kanë plot me bereqet. Çdo qeveri me ta ka qenë, janë lidhur me njëri-tjetrin. Zenel agait nuk ia bëjnë fjalën dy, e jo më t'i marrin çiflikun.

— Hëm... kështu na është mbushur mendja ne, o Xhemal Sula, se kemi qenë e jemi pa mend, pa sy në ballë. Na duket sikur agai është dërguar nga zoti, e nuk jemi kthyer ta provojmë se edhe aganë e ha plumbi që ç'ke me të.

Xhemal Sula mendohej thellë e më thellë.

— Nuk e di, more Xhelo, ç'të të them... zamet të madh do të keni për të arritur atje ku mendoni.

— Po pse ti këtë grusht mall që ke, pa zamet e ke vënë?

— Jo, pooo...

— C'thua për djalin?

— Nuk di ç'të them.

— Burri e thotë një fjalë.

— Pa u menduar?

— Jo, por të mendohet mirë e në kohën që duhet, se pa u menduar, njeriu nuk shkon as në dasmë. Kjo është luftë që do të bëhet nga dita në ditë më e ashpër. Liria nuk fitohet pa gjak. Dikush do të vritet, mund të vriten shumë. Mund të çellojë që plumbi të më marrë mua, apo djalin tënd, po, po... kjo duhet thënë që në fillim.

— Po mirë, more Xhelo, ç'ne me lazëm? Unë jetoj në punën time. Dua të martoj djemtë dhe të gëzoj pesë ditë në këtë dreq dynja. Nuk ngatërroj as ballizma as fashizma, edhe ata s'kanë pse të më bien në qafë mua.

Kjo logjikë e ngjeshur me interesin brenda mureve të shtëpisë e nervozoi Xhelo Begën. Ndonëse ai ishte vetë fshatar, bile më fukarà se Xhemal Sula, Partia atij ia kishte shkryfur mirë mendimet për luftën, për jetën dhe njerëzit, prandaj iu përgjigj Xhemalit me gjakftohtësi:

— Fashistët dhe agallarët do të vijnë te ti se s'bën. Ata duan të rrojnë këmbë mbi këmbë, siç janë mësuar. Kush do t'i mbajë? Unë, ti, i gjithë mileti që vuan. Kush e ka mbajtur për vite me radhë Zenel aganë që harbon mbi kalin e kuq? Pastaj ja nuk ardhka fashizmi në konakun tënd, do ta lesh ti të përmjerë mbi tokën e atdheut tënd?

— Mos e lësho fjalën nxituar, o Xhelo, — ia preu Xhemali i prekur në sedër. — Kur ka qenë fjala për mbrojtjen e vendit dhe unë goç kam bërë bashkë me shokët.

— Nuk thashë jo. Por tashti është koha më e vështirë për Shqipërinë. Armiqtë duhen shporrur dhe këtë do ta bëjmë ne.

— Nuk e di, more vëlla, ç'të të them... me të parë e me të bërë.

— Si të duash, o Xhemal, po sa më shpejt ta shikosh udhën e drejtë aq më mirë do të jetë. — i tha Xhelo Bega dhe pasi i shtrëngoi dorën, humbi tej nëpër shkurre.

Pas disa ditësh dy mercenarë të Zenel agait erdhën dhe i kërkuan Xhemal Sulës një dhi dhe

dy kuleçë bukë. Xhemali nuk deshi t'ua jepte, por ata ia morën me zor, me urdhër të komandantit të tyre. «Ju që shullëheni në diell do të na ushqeni ne që do të luftojmë façizmin», — i tha Xhemal Sulës njëri nga mercenarët. Në kashtën e kasolles së dhive ai kishte një dyfek të fshehur, por këmbët nuk i bënë për atje. Nuk e rrëmbeu dyfekun për të mbrojtur djersën e tij. E pushtoi një ndjenjë përçmimi ndaj vetes, tek shikonte veten duarlidhur dhe dy mercenarët e Zenel agait, të cilët u larguan duke tërhequr dhinë e tij për briri.

Në mend i vërshuan fjalët e komandantit partizan dhe padashur pyeti veten: «Sikur t'ia kisha dhënë njërin djalë! Ndryshe si mund t'i shporrim këta zagarë?»

Kjo pyetje e futi në mendime që po e tërhiqnin fort pas udhës së Xhelo Begës.

Një lajm që u përhap atë mbrëmje në fshat ia ndrydhi përsëri shpirtin Xhemal Sulës:

— More, dëgjove gjë t'i ç'kishte ngjarë në fshatin Mëris? — e pyeti Xhemalin atë ditë një fqinji i tij.

— Jo! Pse ç'ka bërë vaki?

— Ishin vrarë dy djem. Dy vëllezër. U qëlluan flakë më flakë. Njëri ishte me «Ballin», tjetri me komunistët.

— Luaj, more, vendit, — tha Xhemal Sula i zbehur në fytyrë.

— Për qelamin kadim të thashë, — e siguroi tjetri.

Kjo ndodhi iu ngulit në shpirt Xhemal Sulës si një shuk i ngrirë gjaku që e mundonte

vazhdimisht. Në mbrëmje ua ngulte shikimin dy djemve dhe humbiste në mendime të frikshme. I hidhte tej me inat mendimet, po ato nuk i shqiteshin dhe ai shikonte ngultas. Eh, sa dëshirë kishte në atë çast të dinte se ç'bëhej në shpirtin e dy djemve të tij! Herë pas here harronte kafshatat e bukës në sofër.

Dhe tërë atë natë nuk bëri gjumë të qetë Xhemal Sula. Në mëngjes nxori dhitë në kodrat e fshatit; shpirtin ia ndrydhnin mendime të përziera:

«Hej, subuhan allah — vëllai vëllanë?! Ç'është kështu!... Kjo është shenjë e keqe... Po ai derënxirë pse i ndau të dy djemtë? Të paktën të ishin të dy në një anë... Apo ka dashur ta kishte një dorë në mjaltë e tjetrën në sheqer? Apo ata melunë kanë ikur nga konaku pa e pyetur tanë?! Eh, more mavri, ç'të është ferrosur dera! Po djemtë e mi ç'mendojnë? Ç'thonë darkave kokë më kokë? Po sikur të më gjejë edhe mua ajo gjëmë.

«Hë? Do të më ndihmosh sot, mua që të ndihmova dje?» — i erdhën në mendje fjalët e Zenel agait dhe tha me zë:

— Jo, jo, kurrë, nuk do t'i lë të më venë djemtë për dhjamë qeni.

Në mbrëmje, pasi futën dhitë në kasolle, Bekimi, e ndali të atin të shtrunga e vathit dhe i shfaqti dëshirën për të dalë në mal me partizanët. Xhemali shtangu një çast. Mendoi t'i fliste të birit për vuajtjet e tij. Ç'kishte hequr në jetë, si i kishte rritur, si... por i ra shkurt, i trembur nga mendimet e liga që i ishin derdhur në kokë nga vrasja e dy vëllezërve në fshatin Mëris:

— Jo! Nuk do të dalësh nga shtëpia... do të rrini këtu, me mua... Po më ikët me kokën tuaj, do të

djeg konakun, do të vras veten. Ja këtë do të bëj.

Rrëmbimi dhe tronditja e të atit e lanë Bekim Sulën si të ngrirë pranë shtrungës së dhive. Nëpër natë i kumbuan përsëri në vesh fjalët e të atit «Ja kështu... kështu do të bëj».

Flakët e luftës po ndizeshin çdo ditë e më shumë. Përhapeshin kudo në qytete e fshatra. Në fshatin Murriz qarkullonin fjalë nga më të ndryshmet për luftën. Flitej se Italisë fashiste po i rrëzohej muri dhe në ndihmë të saj në Shqipëri do të vinin, ose ishin futur gjermanët.

Lajmet për fitoret e partizanëve përhapeshin, ndiznin guximin dhe u hapnin sytë fshatarëve. Mercenarët e «Ballit» që vinin rrotull në fshatin Murriz përpiqeshin t'i përgënjeshtonin ato fitore. Herë pas here nga fshati Murriz iknin djemtë natën e dilnin në mal. Xhelo Bega futej në fshat natën dhe bënte mbledhje me ata njerëz të thjeshtë që akoma nuk po dinin nga të merrnin udhën. Xhemal Sulën e ndrydhte frika për të dy djemtë, po megjithatë i dëgjonte me vëmendje dhe filloi t'i aprovonte fjalët e komandantit të çetës.

Një mëngjes herët, pa zbardhur mirë, në krye të fshatit krisi pushka. Në fillim një pushkë, e pastaj krakërima e automatikëve. Partizanët e çetës «Vetëtima» sulmuan forcat e Zenel agait. Pas nja dy orë luftime, ballistët e lanë fshatin. Pas shumë vjetësh Zenel agai doli nga fshati Murriz, jo me kalë për të harbuar, por më këmbë, bile me vrap, i përzënë nga barinj e bujq të thjeshtë, që në kapele mbanin të qëndisur një yll të kuq. Ikja e agait dhe e trimave, të tij me të katra (siç thoshnin fshatarët që e panë vetë me sy) ishte ngjarja më e çuditshme e njëkohësisht më qesha-

rakja e atij mëngjesi plot diell. Një grup partizanësh, rreth nja njëzet vetë, u ulën nën hijen e një molle të madhe, afër shtëpisë së një fshatari. Molla ishte ngarkuar atë vit. Kokrrat e shëndetshme lëshonin reflekse të kuqërremta nën diellin e shtatorit.

Partizanët gjatë sulmit ishin ndarë në dy grupe. Grupin që u ul nën hijen e mollës e kishte udhëhequr komisari i çetës «Vetëtima», kurse grupi tjetër, i cili pat ndjekur deri përtej fshatit Zenel aganë, drejtohej nga komandanti Xhelo Bega. Komisari thirri Xhemal Sulën me katër a pesë fshatarë, që kishin ardhur të parët për t'u përshëndetur me partizanët dhe u tha:

— Partizanët janë të uritur. Kanë dy ditë pa bukë. Kanë bërë shumë udhë dhe me nxitim për ta goditur Zenel aganë përpara se t'i vinin ndihma. Tashti duhet të hanë diçka dhe të pushojnë pak, pasi prapë do të nisemi për udhë. Prandaj, lajmëroni dhe fshatarë të tjerë e na përgatisni diçka për të ngrënë. Ç'të keni, ç't'ju ndodhet. Bukë, qepë, gjizë... ç't'ju ndodhet.

Xhemal Sula ua kishte qepur sytë partizanëve dhe po i shikonte me habi, sikur ata të kishin rënë aty në Murriz nën hijen e mollës, nga një planet tjetër. Ata dukeshin të lodhur, të dobët, të pjekur nga dielli. Buza u ishte tharë nga të pangrënë. Dikush kishte lidhur në dorë një shami të gjakosur. Njërit i kishte dalë bërryli nga xhaketa e grisur. Një tjetri i kishte hapur gojën opinga dhe gishtërinjtë dukeshin si një krehër fishekësh të ndryshkur. Mollët e pjekura, të kuqe, plot lëng, qëndronin mbi kokat e tyre. Ata qëndronin poshtë tyre të qetë.

«Çudi! Sa uri do të ketë i shkreti, — tha me vete Xhemal Sula, kur pa njërin që ngriti sytë në degën e mollës dhe kapërdui pështymën duke bashkuar nofullat me njëra-tjetrën. — Po ngreu, o burrë, e merre një kokërr mollë... Çudi! Janë të uritur dhe rrinë si të ngrirë... pse nuk hanë mollë, kush do t'ua mbajë dorën?! Tashti është në duart e tyre i gjithë fshati... çudi!

Pas dy orësh fshati përgatiti një drekë, që partizanët e uritur e quajtën «gosti mbreti». Pranë mollës u kthye edhe grupi tjetër partizan në krye të të cilit ishte Xhelo Bega. Komandanti përshëndeti me grusht dhe kur pa Xhemal Sulën tek u hidhte partizanëve dhallë me një gjym të bardhë, iu hodh në qafë.

— Ç'i thua kësaj pune, more Xhemal Sula? Zenel agai paskësh pasur vrap lepuri qerratai. Nuk pati kohë as t'i linte shëndetin fshatit.

— Epo, ç'nuk ndodhka në këtë dynja, o sho-ku Xhelo, — tha si nëpër dhëmbë Xhemali. Dhe sytë i hodhi te dy djemtë e tij, që u shërbenin plot dëshirë partizanëve dhe diç i luteshin komisarit.

Kur partizanët po gatiteshin për udhë, komisa-ri i çetës i mbështeti shuplakën në sup Xhemal Sulës dhe pasi i shkeli syrin Bekimit i tha:

— Këtu u njoha edhe me dy djemtë e tu, xha Xhemal. Flakë dyfeku i paske për ideal. Të tillë djem i duhen sot Shqipërisë. Këta do ta shporrin armikun e huaj nga atdheu dhe bejlerëve do t'ua futin të dyja këmbët në një opingë. Por ama, duhet të bashkohemi, sa më shumë... Nuk më thua a do ta lësh djalin e madh, Bekimin, të futet në radhët tona?

Komandant Xhelo Bega ia qepi sytë Xhemalit dhe priste në mëdyshje.

— Merreni, ju qoftë hallall, — tha prerë Xhemal Sula.

— «Urre», — thirrën me një zë partizanët. Komandanti ngriti dorën dhe ra menjëherë heshtja.

— More Xhemal, — tha Xhelo Bega, — po si kështu more?! Unë të jam lutur një ditë të tërë të më jepje njërin djalë. Bashkë edhe njiheshim, kurse komisarin sot po e shikon për herë të parë! Dheee...

— Nuk ia dhashë vetëm komisarit, o Xhelo Bega, po ia dhashë asaj, — tha Xhemal Sula dhe tregoi me dorë. Njerëzit kthyen kokat dhe nuk po kuptonin për kë ishte fjala. — Ia dhashë mollës, — vazhdoi ai. — partizanët kanë katër orë që po rrinë poshtë saj. Ishin të uritur sa s'bëhej dhe asnjëri nuk ngriti dorën të këpuste një kokërr. Zenel agai ma mori dhinë me dyfek... Ju, ju, luftoni për ne, për fukaranë, por të më falni or shokë, se kjo koka ime... Nejsë. hallall, ju qofshin të dy djemtë e mi. Dhe po s'më dëgjuan mua, harram e paçin qumështin e nënës dhe mundimet e mia.

Xhelo Bega e përqafoi fort Xhemalin dhe i tha:

— Jo! Me ne do të vijë vetëm i madhi. Dhe kur vuri re pakënaqësinë në fytyrën e djalit të vogël të Xhemal Sulës shtoi:

— I vogli të rrijë me ju. bile edhe neve na duhet shumë këtu. Do të ketë plot punë në fshatin e çliruar...

Partizanët u nisën në rresht. Në radhët e tyre përveç Bekim Sulës, u futën edhe katër djem e dy vajza nga fshati. Pas një copë here ata kaluan tej në Qafën e Dushkut. duke lënë prapa melodinë e një kënge që bënte fjalë për bashkim, melodi që këndohet edhe sot në fshatin Murriz.

B E X H E T I

Isha ulur në verandën e hotel «Turizmit» dhe po sodisja detin. Dritat e qytetit derdheshin në det e krijonin aty ylberë të rrallë. Një dritë prozhektori çante nëpër ujë një rrugë të zjarrtë dhe humbiste tutje drejt errësirës së Korfuzit... Prisja që kamerieri të më sillte darkën. Nga mendimet më nxorën dy duar, që u zgjatën mbi tryezë nga pas shpinës time dhe lanë dy gota verë. Kthehem dhe ndesh në shikimin e qeshur e të malluar të një shoku të vjetër. U përqafuam me mall.

— Vetëm je?

— Vetëm. Po ti?

— Vetëm. Kam ardhur me shërbim, kam dy ditë.

— Ç'rastësi. Unë erdha sot. Ke zënë hotel këtu?

— Posi! Në katin e shtatë.

— Sa mirë, qenkemi bashkë sonte. Po ku je more që humbëm kaq vjet?!

Pyetjet ngatërroheshin me njëra-tjetrën e ne shikonim shoku-shokun në sy, në fytyrë, në flokë, në veshje. Kërkonim portretin e vjetër në ndryshimin që kishin shkaktuar katërmbëdhjetë vjet ndarje. Bexheti më kujton një vend, një episod,

një shaka nga kujtimet e vjetra. Unë e ndjek me vëmendje e me zili për kujtesën e tij. Ndodh ngandongjëherë që vrulli i permallshëm i derdh nxituar fjalët dhe shkaktonte shkëputje të bisedës. Bexheti u mbështet mirë në karrige dhe e lëshoi shikimin mbi detin e gjerë, që përziante mijëra drita të qytetit të derdhura në të. Unë u futa në kujtimet e viteve të shkuara. Katërmbëdhjetë vjet më parë, unë dhe Bexheti punonim me ekskavatorë në fushat e Vurgut. Bexheti ishte gazi dhe kripa e muhabetit në shoqëri. Rrallë ndodhte që vetullat e tij t'i shikoje të ngrysura. Ne, shokët e tij, i kishim ngjitur epitetin «Thumbi» për arsye se sa herë ose kudo që shihte diçka të shtrembër, nuk i durohej pa e goditur, apo pa e thumbuar hapur. Kur ne i flisnim për këtë gjë, ai na thoshte: «Një çikë i mërzitshëm është njeriu me thumb, bile ndodh, që i hap edhe telashe vetes, por a nuk do të mbeteshin shumë gjëra zbërthyer në këtë botë pa thumbin». Në mes të dymbëdhjetë buldozeristëve dhe ekskavatoristëve, Bexheti kishte më tepër cilësi të mira, megjithëse nuk ishte ai më i madhi në moshë. Ai ishte i zoti i punës, i zanatit, i këngës, i zakonit e i valles. Bexheti aq sa punën, donte dhe librin. Kjo nuk para na pëlqente fort në të tjerëve. Jo vetëm ngaqë lexonim më pak, e disa fare pak, por ngaqë libri na e rrëmbente Bexhetin në ndonjë hije peme në fushë, apo e mbyllte në dhomën e tij. Kështu ne na mungonte shoku i mprehtë e gazmor. Ndonjëherë shkëputej nga leximi dhe vinte në dhomën tonë. Aty kërciste dominoja deri natën vonë. Ai na shikonte një copë herë si me kaqardhje dhe na thoshte: «Ç'bëni mo-

re lumëmëdhenj? Latë nam! Po, luan njeriu orë të tëra me domino? Eh, që s'ka një gjyq jete të jepnim llogari sa herë që tallemi me orët e saj të shtrenjta.»

Ne qeshnim. E rrëmbenim për dore dhe e ulnim në tryezë. Ai luante nja dy lojë. Thumbonte ata që nxeheshin dhe pastaj i fuste dominotë në kuti. Niste e na tregonte diçka nga një libër që kishte lexuar. Tregonte bukur, sikur të kishte jetuar vetë me ata njerëz e në ato vise. Unë shpeshherë mendoja se Bexheti tregimet e librave i ndryshonte sipas mënyrës së tij dhe me një qëllim të caktuar.

Bexheti ishte nga një fshat i Kurveleshit. Ishite rritur pa baba. Sipas tregimeve të tij, atë dhe një vëlla i kishte rritur e ëma me mundime. Jeta prej jetimi e kishte bërë të ndjeshëm e të dashur për njerëzit. Ishite e vështirë që ai të thoshte për shokun fjalën e fundit. Aty përpara tij në verandën e Turizmit, më vërshuan kujtime nga ato tre vjet, që jetuam e punuam bashkë në fushat e Vurgut.

Një herë, një traktorist i mori një shoku një palë pinca të reja. Pasi mbaroi punë me to nuk ia ktheu, por i tha se pincat i kishin humbur. Pas nja dy javësh, i zoti i pincave shkoi te traktori i tij për të marrë një çelës. Sytë i shkuan në kasetën e veglave dhe njohu pincat e tij.

Kv veprim na revoltoi të gjithëve. Ne jetonim në një kantier të vogël. Ishim një brigadë. Dymbëdhjetë ekskavatoristë dhe buldozeristë. Hanim në një mensë. Në fillim, ndoniherë edhe në një piate, dy e nga dy, sa u kompletua mensa. Fllim në tri dhoma, katër nga katër. Në mes nesh

nuk kishte ndarje. Ne ishim shkrirë në një familje të madhe. Po, ishim më tepër se një familje. Në familje ka dhe grindje, ka dhe zili e ndarje interesash. Në dashurinë për shokun ne kishim përzier edhe mallin për familjet tona. Ne jetonim larg familjeve, përballë kënetës që duhej tharë.

Shpesh ndodhte që, duke kaluar nëpër ujë, nga ekskavatori i vendosur mbi trarë e deri te mensa, kërcinjtë na mbusheshin me shushunja. Herë pas here ne i shkulnim njëri-tjetrit shushunjat nga pulpët e na vinte pa masë keq, kur në pulpën e shokut rridhte një curril i hollë gjaku. Kështu ishte. Këneta, pellgu i malarjes, duhej tharë, e për t'u tharë ajo donte djersë e dashuri, donte dhe gjak. Këto vështirësi ishin një tjetër saldim i dashurisë sonë. Njerëzit në vështirësi, në det, thellë në galeri, në ajër, në kufi duhen më shumë se sa kur rrinë mbështetur në divanin e ngrohtë duke kërkuar «të madhen» në jetë. Ishte pra kjo arsyeja që veprimi i shokut tonë, i buldozeristit Zyber na revoltoi dhe mblodhëm brigadën. Brigadierit e hapi mbledhjen, duke vërtitur në dorë një palë pinca. Pasi tregoi çështien e grindies në mes të dy traktoristëve, tha: «Kësaj, shokë, i thonë viedhje. Viedhësi, thotë një fjalë, është mik i armikut».

Zyberi u nxi në fytvrë, por nuk pranoi. Fiala i kishte shkarë, kishte thënë se ato pinca kishin qenë të tiiat, kurse ato të shokut i kishin humbur. Fakti që ai nuk pranonte haptas i zemëroi shokët.

— Pincat unë i njoh. Këto janë të miat. — tha Destani më inat dhe keqardhie. E vërteta dukej hapur, por Zyberin nuk e linte sedra e sëmurë të pranonte.

Kjo bëri që mendimet të përziheshin ashpër:

— Zyberit të mos i flasim dy muaj rresht.

— Të mos i jepet asnjë ndihmë.

— Ta lëmë me një vërejtje këtë herë.

— T'i hiqet traktori për tre muaj, e të punojë në fushë si punëtor.

— T'i falet me autokritikë.

— Të paguajë pesëfishin e pincave!...

Aty nga fundi e mori fjalën Bexheti. Shokët ia ngulën sytë dhe prisnin, kureshtarë se çdo të thoshte ai. Kur mungonte brigadieri e zëvendësonte Bexheti. Bexheti na bënte për vete me thellësinë e mendimit, me dashamirësinë dhe drejtësinë e prerë. Ishte kjo arsyeja që fjala e tij dëgjohej e zinte vend.

— Nuk është mirë, o shokë, që Zyberit të mos i flasim, të mos e ndihmojmë, t'i heqim traktorin apo ta falim. Në raste të tilla shoqëria duhet të bëhet kovaç për shokun që gaboi. Ta përpunojë shokun, si përpunon kovaci copën e hekurit. Ndrvshë ku është vlera jonë? Por edhe ta falësh, ç'bisht do t'i vësh punës? Nuk e di një dialë niëzet e tre-katër vjeç, se kv është nië veprim i ulët? Aq më keq ndaj shokut me të cilin kalon çdo ditë, çdo orë në punë e në halle!?

Të gjithë ne dëgionim në heshtie. Unë vrisja mendjen se ku do dilte «thumbi» që as dënon, as fal. Bexheti nas nië heshtieie të shkurtër tha:

— Si shokë iu lutem, të ma lini mua këtë nunë. Do ta shikoimë nië herë më me durim. Pse të nxitohemi, mbase ka këtu ndonië ngatërresë.

Brigadieri e shikoi ngultas Bexhetin, pastaj na i hodhi sytë neve.

— E në, ashtu doftë, o Bexhet, — tha njëri. Dakord... na të shohim...

— Ndoshta s'ka faj ai, — tha një tjetër.

— Po mirë more, si të doni ju... Nga ju varet. — tha brigadieri. Bexheti ia mori pincat brigadierit dhe ajo mbledhje u mbyll.

Në barrakën tonë të madhe, përveç mensës dhe dhomave të gjumit, ishte dhe një dhomë që qëndronte e veçuar, këndi i kuq i thoshim. Në dimër e quanim më tepër «dhoma e zjarrit», pasi në mes të saj ishte vendosur në vend të sobës një fuçi njëqind litrash. Rreth sobës kishte stola të gjatë, kurse pas tyre ishin katër-pesë tryeza ku ne luanim shah, domino, lexonim diçka, apo shkruanim ndonjë letër. Në qoshe të dhomës ishte një dollap i vogël me njëzet a tridhjetë libra e mbi dollap një radio e vogël «Orion».

Në mbrëmje, kur unë dhe Zyberi u futëm në «dhomën e zjarrit», shokët ishin ulur dhe po luanin nëpër tryeza. Sytë më shkuan përballë, mbi tabelën e kuqe, ku vendoseshin rezultatet e punës dhe ndonjë lajmërim. Në qoshe të tabelës, në një gozhdë, ishin varur pincat...

Bexheti foli që tej sobës:

— Hajdeni, hajdeni! ju të dy na duheshit, që t'ia pleksnim një katërsheje. Kam vënë bast me Leonidhën, e do t'ia marr dy gota birra, ose do t'i jap një shishe verë.

Shkuam pranë tyre. Zyberi dukej tepër i shqetësuar. Atij i hidhnin shikime vjedhurazi. Luan-te me shumë zor. I ngulte sytë mbi gurët e domi-nove, sikur të mos i kishte parë kurrë. Ngandoniherë hidhte një shikim të shpejtë te pincat e varura dhe shtrëngonte nofullat. Lojën e tretë nuk e luajti. U ngrit me pretekstin se i vinte gju-

më. Ndaj të tjerëve hiqej sikur nuk i kishte parë pincat e varura në tabelë.

— Ku të paska shkuar mendja, o të marrtë e mira. Nuk të themi më kot «thumb»? — i tha Leonidha, Bexheti.

— Shëët... mos u merrni me fjalë. Mos i thoni asgjë. Bëni dhe ju sikur nuk i shikoni, — tha Bexheti.

— Ai i pa që te dera, — thashë unë.

— E di, e pashë po lëreni të qetë. I jam lutur sot të më tregonte të vërtetën, por nuk pranoi, megjithëse e vërteta duket sheshit. Pa lëreni një herë të shohim ç'do të bëjë?!

— Hej, drej o punë, — tha Spiroja i menduar.

— A t'i flak fare ato drej pinca? — tha Destani.

— Jo! Nuk u ka ardhur koha të flaken, — ia preu Bexheti.

— Më erdhi keq për drejin, nuk e patë si u prish në fytyrë?

— S'ka gjë, kjo i bën mirë, ta shikojë të keqen më thellë e të gjejë rrugën për ta hedhur tej, — tha Bexheti.

Të nesërmen mbrëma, Zyberi nuk erdhi në dhomën e zjarrit. Edhe ditën në punë dukej i zhytur në mendime. Pa dyshim që tek ai po zhvillohej një luftë e brendshme. Pas dy ditësh, ai u fut në dhomën e zjarrit. Sytë ua nguli pincave të varura në tabelë. Ne e ndalëm këngën labçe. Bexheti i thirri i qeshur:

— Eja Zyber, eja më qafsh, t'ia marrësh një herë se na mërzi Leonidha me këtë zë si teneqe e çjerrë. Zyberi u afrua si i hutuar. Ndaloi pranë nesh dhe i tha:

— Me të vërtetë dëshironi të këndoj me ju?
Fytyra e tij të kujtonte atë të një fëmije, i cili kur ndien zemërgjerësinë e prindit pranë fajit të tij, me zor e mban të qarët.

— Pse nuk dashkemi me gjithë zemër? Ç'na ke bërë ti, nuk je shoku ynë i përditshëm i gëzimit dhe i halleve? — i tha Bexheti.

— Jam, po... në më doni hiqini andej ato të mallkuara... dreqi ta hajë atë sahat që më prishi, — tha Zyberi gati me zë të dridhur.

Në çast Destani u ngrit dhe shkuli pincat nga tabela.

— Na marrshin të keqen e shokut, — tha ai e u ul pranë Zyberit.

Bexheti ia mori një kënge të krijuar aty për aty:

*Qasu shokë të këndojmë,
Se një ditë mund të shkojmë,
Kushedi ku do punojmë,
Njëri-tjetrin të kujtojmë.*

Ja, kjo këngë e thjeshtë më vjen tashti në tryezë e më duket sikur mbush me gëzim gjithë atmosferën. Në mënyrë të vetvetishme i shtrëngoju krahun shokut dhe i them: — Eh, more Bexho!

— Hë? Deri ku ishe kështu? — më tha Bexheti që më kishte hetuar të humbur në mendime.

— U futa në vite. Kujtova brigadën tonë të Vurgut, — i thashë.

— Brigada e Vurgut! Ç'shoqëri të bukur që kishim. More, i ke takuar ndonjëherë me ata shokë, apo jo? — më pyeti.

— Me disa prej tyre, — i thashë.
— Unë i kam takuar gati të gjithë. Rrallë, por i kam parë. Të kujtohet Zyberi?

— Si jo!

— Mbahet mirë, megjithëse është thinjur fare. Ka punuar rëndë, qerratai! Tashti ka shkuar vullnetarisht e punon me buldozer në hekurudhën Përrenjës-Guri i Kuq.

Një kamerier i gjatë, i heshtur, disi i vrenjtur e i përtuar solli darkën.

— Jemi në rregull? — pyeti serioz kamerieri, pasi radhiti në tryezë katër pjata.

— Shumë në rregull. Vetëm kisha një vërejtje të vogël, që desha t'ua thosha që në drekë, — i tha Bexheti me buzë në gaz.

— Urdhëro, folë!

— Nuk do t'ju vijë keq?

— Po qe e drejtë, aspak!

— Sikur të ishit pakëz më i qeshur do të qe më mirë, më duket mua.

Kamarieri shtangu një hop, pastaj tha me buzë në gaz:

— Keni të drejtë, po... natyrë njeriu.

— Ashtu është, — ia ktheu Bexheti, — por puna juaj si kamerier, kërkon një natyrë sa më të qeshur, pasi na gjallëron oreksin ne klientëve, e sidomos të ardhurve, duke bërë ta ndejnë veten si në shtëpinë e tyre.

Kamarieri i gjatë qeshi me gjithë zemër e duke i rrahur supin Bexhetit, tha:

— Të lumtë! Këtë nuk ma kishte thënë njeri megjithëse kam dhjetë vjet që shërbej. Për nder ma morët me hak një gotë verë.

— Vasilika, — i thirri ai një kamarierëje të re, — sill dy gota verë, të lutem!

Bexheti kundërshtoi, por kamarieri nguli këmbë:

— Mos ma prish qejfin tashti... Vërejtja që më bëre, meriton më shumë, — tha ai dhe u largua i shkathët nëpër tryezat që ndrisnin nga pastërtia.

— More Bexho! Nuk paske hequr dorë nga thumbat ende, — i thashë shokut të vjetër.

— Përkundrazi... e pse të heq dorë nga një qëllim i mirë? Thumbat e mi kanë mbetur ashtu siç thoshte Zyberi: «thumba të bardhë». Të kujtohet historia e Zyberit me pincën? Nu ka gjë më të mirë për njerëzit, sesa të thënit hapur, në vend e në kohë, të mendimit që kanë. Pa ç'ka, le t'i vijë hidhur atij tjetrit, përkohësisht. Më vonë do ta kuptojë sesa i drejtë ka qenë qëllimi yt... Fjala e hapët është pjellë zemre, që nuk e prish kurrë njeriun. Ajo e fshehta është e ligë, si krimbi në drurin e njomë.

— Ashtu është! Ke shumë të drejtë, — i thashë. Ai ngriti gotën, më uroi të mirat dhe e ktheu përgjysmë.

— Po pa më thuaj, o Bexho, ç'ke bërë në këto vite që s'jemi parë? — e pyeta.

— Ç'kam bërë, the? Kam zhvendosur qindra, mijëra metra kub dhe, zhavorr e rërë me ekskavator. Kam nxjerrë nja gjashtë a shtatë ekskavatoristë të rinj. Kam hapur mijëra metra kanale kulluese. Kaq për shoqërinë! Kurse për vete: Kam marrë shtëpi të re. Kam marrë një grua që e dua shumë... e pra e, mos qesh hiç. Ja, unë që më thoshje dikur se kisha rënë në dashuri me librat, e

nuk do të martohesha kurrë. Kam bërë tre fëmijë, dy djem e një vajzë. Kam marrë tre urdhra pune. Kam mbaruar natën shkollën teknike. Me punë, tashti, jam kontrollor teknik i makinerive të rënda. Epo, njeriu duhet të dalë përballë shoqërisë, more vëlla, ndryshe po u zvarrise si parazit në jetë, as varri s'të qas, — tha dhe pasi më shtrëngoi krahun shtoi: — Dalim tashti të bëjmë një shëtitje të shkurtër buzës së detit, e po e pamë të udhës t'ia marrim një kënge si dikur, le të na mbajë deti iso po deshi...

NYJA E NDËRGJEGJES

Fatri Duka rrinte në zyrën e tij me bërryla të mbështetur në tryezë. Nga mendimet e shkëputi zilja e telefonit. Komiteti i Partisë i hoqi vërejtjen për vonesën e një liste emërore të pesë inxhinierëve, të cilët ishin planifikuar për të kaluar në veprat e mëdha industriale të Elbasanit, të Fierzës dhe të Ballshit.

— Keni të drejtë, shoku sekretar... kemi ngurruar ca për të vënë gishtin pa prishur punë, — iu përgjigj Fatriu i menduar.

— Veproni me drejtësi, që gishtat të ngrihen vetë. Ju duhet të keni parasysh edhe vullnetin e njerëzve, — i tha sekretari i Komitetit. Fatriu mbylli telefonin dhe u zhyt përsëri në mendime.

Fatri Duka është tashti plot pesëdhjetë vjeç. Me çështjen e socializmit ai ishte lidhur që gjashtëmbëdhjetë vjeç. Në këtë moshë ai kishte dalë në mal, në luftë. Në dorën e majtë i ka mbetur një gjurmë lufte. Ia ka shkukur nga vendi gishtin e vogël një copë predhe.

Pas Çlirimit, u bë kuadër i shkolluar. Gjatë tridhjetë vjetëve ka punuar në disa qytete. Kudo është përpjekur për të qenë kuadër e njeri i mirë. Është munduar me shpirt për të ecur në mes të nje-

rëzve, siç thotë populli, me faqe të bardhë. Pesë vjet më parë nga koha që nis fill tregimi: atë e patën zgjedhur sekretar të Byrosë së Partisë në një nga ndërmarjet më të mëdha të kryeqytetit.

Me thjeshtësinë e tij, me këmbënguljen në zgjidhjen e çështjeve që i dilnin përpara, me natyrën e tij të futur, nëpër gëzime e halle, kishte bërë vend të nderuar midis njerëzve.

Dikush kishte thënë se sekretar Fatriu është aq i ndjeshëm e zemërbutë, sa që disa përfitojnë nga kjo dhe i bëjnë bisht punës. Këto fjalë i kishin shkuar në vesh atij dhe shpesh e merrte veten në nvetje.

Për t'iu përgjigjur orientimit të Partisë ishin bërë dy mbledhje me debate. Çështja nuk kishte gjetur zgjidhje të saktë.

Nga dymbëdhjetë specialistë të lartë që kishte ndërmarria, duhej të caktoheshin pesë vetë. Ata do të largoheshin për një kohë të pacaktuar: ndoshta dhe përgjithmonë. Kjo varej nga roli, nga puna dhe nga kërkesat që do të nxirrte koha në vprat e reja. Pra duhej të largoheshin nga ambienti i krijuar në punë, në jetën shoqërore e familjare, për të nisur një udhë të re.

«Kjo nuk është shëtitje qejfi, por një lloj sakrifice që kërkon koha, që kërkon ecja përpara e jetës në Atdhe, në cdo skaj. Të mendosh se kjo punë bëhet me një shkresë, me një urdhër të byrosë dhe të drejtorisë, do të thotë të mos e njohësh jetën dhe njerëzit. Jo! Zotimi duhet të dalë nga shpirti i njerëzve. Dhe kjo varet nga formimi politik i secilit... ee... në qoftë se formimi është i dobët, këtu e ke fajin ti, ore Fatri Duka, që bashkë me komunistët, nuk ke punuar si duhet».

Në këto mendime ra sekretari përsëri, sapo uli receptorin e telefonit.

«Ju e dini, shoku Fatri, se unë kam nënën të paralizuar. Vetë jam i sëmurë nga koliti kronik. Shtatë vjet punë i kam bërë nëpër ekipe të largëta... tetë vjet kam këtu», i erdhën ndër mend fjalët e një inxhinieri, i cili i kishte ardhur në zyrë dy orë më parë. Sekretari ia pat dëgjuar me interesim hallin dhe ai kishte dalë i çelur nga zyra. Ndërkaq Fatri Duka kishte nisur grindjen me atë këshilltarin e çuditshëm, të padukshëm: «Të erdhi mirë që inxhinieri u largua i qeshur, i kënaqur e të falenderoi? Hëm..... po secili mund të ketë një hall... Dikush ka pleqtë, njëri ka gruan të sëmurë... një tjetër fëmijët. E ku i dilet kështu? Po dje në luftë, o Fatri, pyeti njeri për hallin e tij, kur doli thirrja e hallit të madh të Atdheut?! Po plakesh. o Fatri... me sa duket, të duhet edhe ty një lëvizje, pa ç'ka në ke bredhur goxha», — i tha vetes i menduar.

Bisedën me veten ia ndërpreu trokitja e derës. Në zyrën e tij u fut inxhinieri Theodhori Leka.

— Ju uroj shëndet, shoku Fatri!

— Shëndet të kësh. urdhëro! — iu përgjigj sekretari i ngritur në këmbë. — Ç'kemi inxhinier? — e pyeti ai pasi bashkëfolësi u ul.

Pas një hezitimi të shkurtër inxhinieri i tha:

— Për një hall kam ardhur, shoku Fatri.

— Pa më thuaj, ç'hall paske?

— Poo... mua më kanë caktuar të shkoj në

Fierzë.

— Pastaj?

— Unë e kam të vështirë të shkoj, shoku Fatri!

— E pse kështu?... Me sa di unë ti nuk ke dhe

ndonjë ngarkesë... Vetë i dytë me gruan je.

— Poo... aty e kam hallin, shoku sekretar... Unë s'kam fëmijë. Ne kemi gjashtë vjet martesë,... nuk lindim fëmijë....

Inxhinieri sa vinte e bëhej prush në fytyrë, por kishte vendosur ta çonte deri në fund kërkesën e tij.

— Atë gëzim që kanë të tjerët në familje, ne nuk e kemi, nuk do ta kemi kurrë ndoshta. Gruaja prej kohe vazhdon kurat në maternitet, dhe qëllon që rri me muaj shtrirë në kujdesje pranë prindërve.

Fatri Duka shikonte i menduar herë fytyrën e skuqur të inxhinierit, herë duart e tij që i fërkonte vetvetiu me njëra-tjetrën. Padashur i mbetën sytë në gropën e gishtit që i kishte shkukur predha e luftës. Lufta i zbriti në zyrë dhe i solli kujtime të largëta: Një grua e veshur në të zeza dha kujtën me ulërimë në krye të fshatit dhe zbriti në shtëpinë e tij. Mero Duka, i ati, kishte mbetur në luftën e Gjormit. Pak kohë më vonë ai në krye të shkallareve po ndahej me nënën dhe motrën dhjetë vjeçe. «Ikë, të keqen dada... hallall gjinë e mos e shkel gjakun e tyt eti», — i pat thënë ajo, e kishte puthur fort dhe ai pat marrë malin.

«Po ç'kërkoni këtu, o mendime?» — gati foli me zë, pastaj iu kujtua inxhinieri që priste përballë tij. «Çudi, si është njeriu! Edhe ky sipas mënyrës së tij ka një hall. Këtë gjë, që dikujt do t'i dukej e thjeshtë, ky e quan hall të madh!»

— Po mirë, more Theodhori... nuk them se s'ke arsye fare, po a është ky hall më i madh se thirrja që na shtron koha për forcimin e mëmëdheut?

— Jo, shoku sekretar... këtë nuk e them unë...

po ja ka të tjerë që i kanë kushtet më të mira.
Ja për shembull...

— Aa... jo. Leri të tjerët. Secili duhet ta peshojë veten përpara detyrës. Me duart dhe mendjen tonë do ta forcojmë mëmëdheun kudo, jo vetëm në qytet, por ku lind nevoja. Në qoftë se këtë edhe ti e kupton në shpirt, atëhere hallin tënd nuk duhet ta vësh mbi këtë detyrë, apo jo inxhinier?

— Jo, shoku Fatri... unë nuk mund ta vë interesin tim mbi atë detyrë jo, por thashë që ta shikonit një herë çështjen time brenda mundësive... Në qoftë se do të më vini përballë asaj alternative, unë mund t'ju them se edhe familjen e dua ngaqë dua më përpara Atdheun.

— Ashtu, të lumtë goja! — tha i gëzuar Fatriu, jo aq për fjalët që tha inxhinieri, por për atë që kishte lexuar brenda tij. Inxhinieri doli i qetë. Sekretari mbeti përsëri vetëm në mendimet e tij. Nga receptori i bardhë i telefonit iu duk sikur përsëri doli zëri i sekretarit të Komitetit të Partisë.

«Ngathtësia në zbatimin e orientimeve është më tepër se gabim».

— «Ke të drejtë, more shoku sekretar! — mërmeriti sikur përballë tij të kishte bashkëfolësin. — Po cilin të ndajmë ne tashti nga të dymbëdhjetë specialistët, të cilët kanë gati të njëjtat rrethana? Ee... secili i ka bërë katër-pesë vjet punë nëpër kantiere apo ekipe të largëta!»

Atë mbrëmje dhe darkën e hëngri disi i menduar Fatri Duka. Kur kaloi në dhomën e gjumit dhe u shtri në krevat hapi bisedën e ditës me të shoqen. I tha edhe për vërejtjen që i pat bërë sekretari i komitetit në telefon.

— Vetë e ke fajin, Fatri... e bëtë tërkuzë atë punë! Të kishit mbledhur byronë dhe ta kishit vendosur me kohë.

— Aa... jo moj grua joo... nuk fole si komuniste këtë radhë... s'na the gjë. Mblidhuni dhe jepni urdhër, thua ti! Çështja është që urdhri të bëhet në mënyrë logjike, që të shkojë ai tjetri e të punojë atje në veprën e largët me gjithë shpirt, e jo ta mbajë mendjen prapa, duke analizuar se cili u mbajt me hatër... Nga dymbëdhjetë vetë duhet të dalin pesë. Të gjithë janë të martuar dhe... natyrisht, secili mund të ketë një arsye apo një hall.

— Epo... caktoni më të rinjtë, atëherë... me radhë çdo gjë fundja, — i tha e shoqja me gjallëri, si të kishte gjetur një zgjidhje të sigurt.

— Ashtu? Epo mirë. Djali ynë është nga më të rinjtë.

— Qyqja.

— Aa... na dalka qyqja tashti!... Jo po grifsha.

— Epo. dale, o burrë... ai i bëri pesë vjet në rrethin e Pogradecit, pasi mbaroi Universitetin... Tashti nusja është në muajt e fundit të lindjes. Duhet...

— Të tjerët kanë punuar edhe më shumë, — e ndërpreu ai të shoqen.

Në dhomën gjysmë të ndriçuar nga abazhuri ra heshtja. Fatri Duka zgjati dorën dhe shkeli sustën e abazhurit. Në errësi të burrë e grua mendonin secili më vetë.

Nyja e bisedës ishte mpleksur keq. Në korridor u dëgjuan hapat e djalit dhe të nuses që u kthyen nga teatri.

— Erdhën, — tha ajo!

— Erdhën, — tha dhe ai.

Ranë përsëri në heshtje. Ishte një heshtje disi ndrydhëse. Të dy donin ta prishnin atë heshtje, po nuk dinin se si. Nga ta fillonin bisedën? Ajo u kishte ngecur në një vend delikat. Ndërgjegjja kishte hasur në nyjen pisk. Zgjidhja e asaj nyjeje kërkonte duart e komunistit të vërtetë. Fatri Duka në mënyrë të vetvetishme e futi mollzën e gishtit të madh në gropën e gishtit që i kishte shkukur nga vendi predha e luftës. Eh... sa e lehtë i ishte dukur atëherë ajo plagë, kur komisari thërriste «Përpara, shokëni, mbi ta»! Ee... ja tashti pranë gruas, shoqes së mirë të jetës, në krevatin e rehatshëm nuk po dinte nga të qëllonte që të vriste heshtjen.

Tre vjet më parë djali i tyre ishte kthyer në Tiranë. Komiteti e kishte caktuar në sektorin e parë, me gjithë kundërshtimin e Fatri Dukës për të mos qenë në një ndërmarrje me të birin.

Lëvizjet në kuzhinë e në dhomën tjetër u fashitën. Ashtu, secili në mendimet e tij, i zuri gjumi.

Të nesërmen u mbledh Byroja e Partisë së ndërmarrjes.

— Hë mor shokë! Ç'kemi nga organizatat-bazë?
— pyeti Fatriu dhe shikimin e hodhi te zëvendësi i tij.

Ai nxori përpara bllokun dhe lexoi pesë emra. Tre prej tyre kishin dalë vullnetarisht, kurse dy ishin caktuar nga organizatat përkatëse.

Fatri Duka e mori listën në dorë dhe pasi e shikoi një copë herë të gjatë tha:

— Mendoj që Skënder Binokun ta heqim dhe në vend të tij të vemë Gao Lekën nga sektori i tretë. Skënderi është i sëmurë vetë dhe nënën gjithashtu e ka të sëmurë rëndë.

— Është e vërtetë, shoku Fatri, po ai kërkoi vetë, e ngriti dorën i pari në organizatë, — tha sekretari i tij.

— Shumë mirë ka bërë. Ai shembullin e ka dhënë, por ama ne duhet t'i shikojmë me gjakftohtësi rrethanat.

— E drejtë... ashtu është, shoku Fatri! — miratuan disa zëra.

— Mendoj, gjithashtu, — vazhdoi sekretari me sytë mbi listën emërore, — që inxhinier Theodhoriu të hiqet dhe në vend të tij të caktohet Iliri. Këtë herë heshtja ra e thellë. Shikimet u hodhën mbi sekretarin e Byrosë.

— Cilin Ilir? — pyeti dikush.

— Ilir Dukën, tim bir, — tha sekretari.

— Unë nuk jam dakord shokë! — u hodh sekretari i organizatës-bazë të sektorit të parë. Iliri ka punuar pesë vjet në një rreth të largët. Gjatë tre vjetëve këtu, ka punuar shumë mirë. Pastaj duhen parë dhe anë të tjera... Me sa di unë, të shoqen e ka në muajt e lindjes dhe...

— Mos e shpjerë më tej, shoku Ramadan. Arsye të vogla, — ia preu Fatriu fjalën.

— Unë nuk shoh këtu ndonjë arsye, shoku Fatri, që të ndërrohet inxhinier Theodhoriu. Ai nuk ka shumë preokupacione... Nuk ka as fëmijë.

— Pikërisht ngaqë s'ka fëmijë... ngaqë nuk lindin fëmijë dhe e shoqja ka nevojë për kura të një specialiteti të veçantë e përkujdesje, kurse im bir së shpejti bëhet baba.

— Iliri u ngrit i pari në mbledhje të organizatës, shoku Fatri dhe doli vullnetar, por shokët diskutuan arsyet që thashë dhe e hoqën nga lista,

— tha sekretari i organizatës bazë të sektorit të parë.

— Dhe kjo e zgjidhi çështjen? Jo! Ne duhet t'i peshojmë njerëzit mirë, me partishmëri. Të mos lëmë asnjë skutë ku të zërë vend e të bëjë moçal hatëri, se pastaj angazhimet do të na kthehen në fjalë boshe që sjellin dëme të mëdha. Kështu, or shokë... Po nuk e zgjidhe nyjen në shpirtin tënd, nuk futesh dot te tjetri. Lista do të niset sot në Komitet bashkë me karakteristikat përkatëse... Kalojmë tashti në çështjen tjetër.

NË MES NJERËZVE TË PUNËS

Re të dendura, të murme, e kishin mbuluar tejmbanë kupën e qiellit, ishin ulur mbi kokat e kodrave dhe derdhnin një shi të ngadalshëm të imët, i cili dukej sikur nuk do të mbaronte kurrë. Shoferi kishte përqëndruar vëmendjen në rrugën e lagur e plot kthesa. Në të rrallë thoshte, pa u kthyer nga unë, diçka për rrugën, për njerëzit, për kohën. Cigaren e mbante në qoshe të buzëve sa digjej deri në filtër. Lart në karrocerinë e «Skodës» ishte ekskavatori im «karkalec» siç e patën emëruar punëtorët qysh ditët e para. Bashkë me ekskavatorin po shkoja nga kryeqyteti në një kantier të largët. Do të punoja atje për një kohë të pacaktuar, ndoshta dy a tre vjet sa të mbaronte ndërtimi i rrugëve në atë zonë. Mendimet më përziheshin; kthehesha në kujtimet e lëna prapa, ose parafytyroja kantierin e panjohur. Gjatë katër vjetëve, që kur kisha filluar zanatin, pata punuar në qytet. Pra, ky udhëtim ishte për mua inaugurimi i shtegtimeve nëpër kantiere. Po a do të gjeja shokë të moshës, të zanatit, — mendoja vazhdimisht. Nga këto mendime më nxori shoferi:

— Ja dhe kantieri ku do të punosh, — tha ai pasi flaku nga dritarja bishtin e cigares dhe më

tregoi me gisht një grumbull barakash, që mezi dukeshin përtej nëpër mjegull. Përpara barakave të kantierit hasëm në një çezmë të nxjerrë në mur. Në faqen e murit ishte shkruar: «Kantieri Rrugat-Ura, 1963». Gjurma e parë e njerëzve të kantierëve, mendova.

Roja e kantierit na shpuri te vendi i shkarkimit të makinerive. Pasi shkarkuam ekskavatorin, shoferi më uroi punë të mbarë dhe iku. Kur makina humbi tej në kthesë, një ndjenjë vetmie e mërzitjeje më ndrydhi shpirtin. Ndërkohë roja kishte thirrur magazinierin, i cili më solli teshat dhe më caktoi dhomën e fjetjes.

— Këtu fle brigada e minatorëve, — më tha ai, pasi u futëm në një dhomë të madhe me mure populiti.

— Nuk paska ndonjë vend në dhomën e motoristëve? — e pyeta i pakënaqur.

— Jo! Tashti për tashti s'kemi. Më vonë po të na lirohet ndonjë, e shikojmë atë punë. Por mos ki gajle, se këtu, do ta kalosh më mirë. Aheng me çifteli për natë ke, besa! — tha magazinieri dhe doli. Me sa dukej ai ma hodhi një thumb meqë vija nga kryeqyteti. Në mes të dhomës ishte një fuçi dyqindlitërshe, të cilën minatorët e kishin shndërruar në sobë. Në murin përballë hyrjes ishte një fotografi e shokut Enver, poshtë saj, një flamur i kuq me thekë të verdhë mëndafshi. Në të ishte shkruar «Brigadës më të mirë». Mbi kokën e krevatit pranë meje ishte varur një çifteli e punuar me shije. Pranë saj ishte mbërthyer me gozhdë një fletë nderi. Më tej ishin ngjitur në mur pamje të bukura dhe ndonjë fotografi vajze, patjetër të prera nga revistat. Aty nga ora

shtatë erdhën minatorët, duke biseduar me zë të lartë.

— Më duket se u nxituam sonte, or Sadri, na rrëmbeu entuziazmi.

— Jo, or ti, se nuk jemi nxituar aspak. Nesër do t'ia gjejmë fillin punës.

— Filli duhej gjetur përpara se të jepnim fjalën përpara njëqind burrave.

— Mos u ngut, or ti... E mira do të bëhet, — u përgjigj ai që quhej Sadri.

I pari në barakë u fut një burrë me trup mesatar, me shpatulla të gjera e me një kasketë në kokë.

— Heu, na paska ardhë një mik, or burra, — tha ai i qeshur dhe erdhë pranë krevatit tim. — Mirë se na ke ardhë, or shok!

— Mirë se ju gjeta, — i thashë dhe i shtrëngova dorën.

— Mos ke ardhë gjë me ekskavator?

— Po.

— Po ku je, more vëlla, se të prisim si ujin e pakët. Edhe sonte u ngrit në mbledhje mekanizimi i punës, — tha një tjetër.

— Epo tashti më dërguan! — thashë.

Ardhja ime dukej që i gëzoi të dhjetë minatorët që banonin në atë dhomë. Pasi më pyetën për ekskavatorin, për gjendjen dhe forcën e tij u shpërndanë nëpër krevate. Nja katër vetë u ulën në stolet rreth sobës së madhe. Ai që flinte pranë meje hoqi çifetlinë nga gozhdra dhe ia nisi një kënge trimash. Një tjetër, më tej, nisi të grinte duhan. Burri që më takoi i pari dhe që e quanin Sadri ishte ulur pranë sobës dhe nisi të shfletonte një bllok. Zëri i atij që këndonte më solli në barakën prej pupuliti mendime epike. M'u duk për një çast, sikur rreth meje ishin

ulur një grup trimash, të cilët sapo ishin kthyer nga një betejë.

— Të lumtë goja!... Të lumtë goja, o Bardhok! — i thanë dy-tre vetë atij që këndoi. Pas këngës baraka ra në heshtje. Dëgjohej vetëm zhurma e lehtë e atij që grinte duhan...

— Si do t'ia bëjmë nesër shkëmbit, or Sadri? — pyeti Bardhoku pasi e la çiftelinë mënjanë.

— Vështirë e kemi, or ti, por fjalën duhet ta bëjmë punë, — u përgjigj Sadriu.

— Besa, deri më sot nuk e ke hedhur kot fjalën, po këtë herë më duket se u nxitove, — i tha një tjetër Sadriut, i cili me sa dukej ishte brigadieri i tyre.

— Pse u nxitova? Kaq e pamundur ju duket? — pyeti ai duke i parë me radhë shokët. Kjo bisedë i mblodhi gati të gjithë rreth sobës. Edhe ai që grinte duhan e la thikën për një çast.

— Zor se bëhen dy të mira bashkë, o brigadier, — tha një mesoburrë. — Rrëzimi i shkëmbit do të paktën një kuintal dinamit. Ti u zotove për kursimin e dinamitit. Rruga duhet hapur brenda tri ditëve, ndryshe detyra e kantierit për festën e 1 Majit mbetet pa u kryer.

— Jo! Detyra do të realizohet dhe ne do të kursejmë të paktën një gjysmë kuintali dinamit. Shkëmbin nuk do ta minojmë nga poshtë, pasi ashtu do të duheshin dy kuintalë dinamit dhe pa le a rrëzohet.

— E si mund të bëhet ndryshë? — pyeti Bardhoku.

— Unë do t'i hipi shkëmbit sipër dhe do ta minojmë nga lart, — tha brigadieri.

— T'i hipësh sipër?! Jo, or ti!... Atje veç zogjtë hipin, — tha njëri.

— Do t'i gjejmë anën. Nesër do të marrim dyzet

metra litar me vete dhe... diçka do të bëjmë, — tha Sadriu i sigurt.

Biseda e tyre nisi të vërtitej nëpër halle të brigadës, të kantierit. Dilte më larg në familjet e tyre, në punët e atdheut, bile edhe të botës së madhe dhe kthehej përsëri tek ai shkëmbi që u paskësh zënë udhën. Unë ndieja pranë sigurisë së brigadierit Sadriu, lëkundjen e mosbesimit e disa prej shokëve të tij.

Të nesërmen e ngjita eskavatorin në ballë të rrugës dhe nisa të grumbulloja çakëllin e nxjerrë nga gërmimet dhe thërmimi i gurëve.

Minatorët u mblodhën përposh një shkëmbi, i cili ngrihej nja njëzet metra përpjetë, në ballë të rrugës. Kur shkova pranë tyre, ata po diskutonin me zjarr. Ishte çasti kur brigadier Sadriu duhej të vinte në jetë zotimin që kishte marrë në mbledhje. Ai mori litarin e gjatë, i lidhi në njerën anë një gur me verigë dhe iu ngjiti një lisi, i cili ndodhej përbri shkëmbit që kishte zënë udhën. Pasi u ngjiti deri lart në një degë që shtrihej në drejtim të majës së shkëmbit nisi të vërtiste me gjithë forcën e dorës gurin e lidhur në anën e litarit. Veprimi i tij atje në majën e lisit të kujtonte atë peshkatarin që vërtiti plumbçin për të hedhur grepin tutje në ujë. Pas një çasti ai e vërviti litarin mbi qafën e shkëmbit. Litari u var nga ana tjetër e gurit. Sadriu zbriti nga lisi dhe pasi i përdrodhi të dyja anët e litarit peshoi në to. Pjesa e parë e punës u krye, por kishte mbetur tani më e vështira. Kush do të ngjitej deri atje lart faqes së mprehtë të shkëmbit, duke u zvarritur nëpër litar? Ajo ngjitje do të ishte e vështirë edhe për një alpinist të stërvitur mirë.

U mblodhëm të gjithë pranë litarit. Sadriu na

shikoi të gjithëve me radhë, si për të na parë zemrat. Pështyu duart, hoqi këpucët, përfshiu litarin dhe tha:

— Hajde, na vafhtë mbarë, o shokë!

— Më lër ta provoj unë, Sadri... jam më i lehtë, më i ri, — tha një djalë rreth të njëzet e katër vje-tëve.

— Jo jo... mos kini merak. Kam pesëmbëdhjetë vjet unë me gurët, ua kam mësuar huqet, — tha me buzë në gaz Sadriu dhe nisi ngjitjen nëpër litar. Të nëntë minatorët u mblodhën grumbull poshtë tij. Ai pasi ishte ngjitur nja dhjetë metra përpjetë u lodh, ndaloi. Mbështeti me mundim majat e këmbëve në barkun thikë të shkëmbit dhe tendosi krahët. Lart mbi kokën e tij lëvizte si me përtim drejt veriut një shtëllungë reje e bardhë.

— Përdridhe përfund këmbëve litarin, Sadri, — i thanë shokët që poshtë dhe u shtrënguan më shumë pranë njëri-tjetrit. Shoku i tyre atje lart shtrëngoi litarin në mes të shalëve, mblodhi forcat dhe i dha trupit përpjetë. Pasi u ngjit dhe tri a katër metra, mbështeti majën e gishtërinjve në një kërcëp, por ai u shkëput dhe Sadriu rrëshqiti rënduar poshtë li-tarit.

— Mbahu! — bërtita unë padashur.

— Mbahu Sadri, se na ke këtu poshtë — i thanë shokët.

Në sytë e tyre, në lëvizjet, në pozicionin që ki-shin marrë dukej se ata kishin vendosur ta prisnin në duar shokun e tyre, në qoftë se do të shkëputej që lart. Por a mund të bëhej pa dëme ajo sakrificë?!..

Sadriu tendosi të gjitha forcat dhe nisi përsëri ngjitjen përpjetë. Atje, në gjoksin e grivër të shkëm-bit, të kujtonte një shpend madhështor, që sepse nuk hapte krahët të fluturonte dhe po bënte prova të

mundueshme për t'u ngjitur. Ne shpëtuam nga ankthi kur ai zgjati njërën dorë dhe e zuri shkëmbin për «briri». U tërhoq dhe pak nëpër litar dhe pasi mbërtheu edhe dorën tjetër iu hodh shkëmbit mbi kokë. Ne që poshtë i dërguam britje të gëzuara, kurse ai na përshëndeti me dorë. Pasi i dërguam pistoletin nëpërmjet litarit ai nisi të qëndiste shkëmbin me mina. Pas tri a katër orësh ai i mbushi vrimat me dinamit, ndezi fitilat dhe zbriti poshtë duke rrëshqitur pas litarit. Ne iu hodhëm në qafë me britma e urime, kurse ai fare i qetë e pa asnjë shenjë krenarie për atë punë aq të vështirë që kreu, na tha me dashamirësi:

— O burrani, të futemi në strehim, se na zunë minat këtu!

U futëm të gjithë poshtë strehimit prej betoni dhe prisnim të pëlciste mina e parë, duke numëruar sekondat. Unë shikoja vjedhurazi Sadriun, i cili qëndronte në mes shokëve të tij i qetë e aq i thjeshtë. Më kot kërkoi në sytë e tij të mëdhenj e plot dashamirësi ndonjë rreze krenarie. Fundja, atij krenaria i takonte. Pak më parë ai vuri veten në rrezik, jo vetëm për punën, por si komunist e brigadier, të bënte vepër fjalën që pat dhënë përpara njëqind shokëve.

Por dhjetë minuta rresht gjëmoi mali i thatë që ngrihej përballë strehimit tonë. Ne dolëm nga strehimi: gjysma e shkëmbit gjigant ishte dërrmuar e shtrirë për tokë. Në fytyrat e minatorëve dhe të brigadierit të tyre lodronte një gëzim i rrallë. Sadriu pa orën dhe tha:

— Ata të shkollës le të ikin, se vajti vonë.

— Cilët janë këta të shkollës? — pyeta Bardhokun.

— Janë tre vetë që vazhdojnë tetëvjeçaren në një

fshat këtu afër. U është vënë Sadriu, o ta mbarojnë, o s'ka.

— Po ai vetë e ka mbaruar? — e pyeta. Bardhoku vuri buzën në gaz si me habi dhe më tha.

— Besoj se e pe sot. Ai është nga ata komunistë që kur thonë «hop» hidhen vetë të parët e të tërheqin prapa. Vite më parë ka ardhur në këtë ndërmarrrje nga fshati, me katër klasë. Mirëpo iu vu shkollës dhe e mbaroi nëpër kantiere të ndryshme. Është lezet të shikosh dëftesat e tij. Një e ka marrë në Fushë-Arrëz, një në Klos një tjetër në një shkollë tetëvjeçare diku në Sarandë...

Ata të shkollës ikën. Shokët e tyre ia nisën punës. Në rrëzën e shkëmbit të cunguar nisi përsëri gërgëllima e pistoletave me ajër. Sadriu mori një kuti kapsollash dhe po përgatiste fitilat e dinamitit. Përtej nga udha nacionale u dëgjua një bori e fortë makine. Ajo më shkëputi një çast nga bota e minatorëve, e cila më pat përpirë gjatë gjithë ditës duke menduar sesa pa kuptuar po kalonte dita e parë në këtë kantier të ri.

PLAKU QË MBLIDHTE GURË

Ekipi ynë atë pranverë nisi marshrutën e parë. Makina shkante deri në fshatin Thanas. Kurse ne na duhej të ngjiteshim lart, në qafën e malit. Kryesia e këshillit popullor të fshatit na erdhi menjëherë në ndihmë me kuaj e me çdo gjë tjetër që na u desh. Ngarkuam plaçkat në tri mushka dhe pas një udhëtimi të gjatë nëpër gurë, shkurre e pisha të larta, dolëm në qafën e Kërçepit, siç i thoshin vendësit. Majat e maleve përreth ishin të mbuluara me borë. Shkëlqimi i borës nën rrezet e diellit të prillit të verbonte. Lulet e para kishin nisur të hapnin e të lëshonin aromat e tyre të mrekullueshme në pllajën e gjerë, që shtrihej në qafën e Kërçepit. Pak prapa qafës ne ngritëm çadrat tona. Ç'bukuri shihje që andej! Në të dyja anët e çadrave tona ngriheshin majat e maleve me borë, kurse përpara hapej një luginë e gjerë dhe e thellë. Në fundin e saj shtrihej një fshat i vogël me shtëpi të mbledhura pranë. Më tej fshatit shtrihej fusha e ndarë në parcela, e pas saj ngriheshin përsëri kodra e male, që humbisnin në horizontin e mjegulluar të pranverës.

Ne ishim katër gjeologë të rinj. Gjatë muajve të pranverës dhe të verës ne do të shëtisnim kryq e tërthor këtyre maleve, kodrave, luginave, brigjeve e

rrëpirave. Vlerën e dijeve tona të marra në shkollë do ta maste fundi i marshrutës sonë të parë. «Ç'përfundime do të nxjerrim? Ç'shtresa?.. A do të kemi fatin të zbulojmë qoftë dhe një mineral për nevojën e atdheut?...» Këto pyetje që kishin udhëtuar bashkë me ne, gjatë gjithë rrugës, aty në qafë të Kërçepit u bënë më këmbëngulëse e më shqetësuese. Detyra e gjeologut është e bukur, e nderuar, por edhe e vështirë e me përgjegjësi. Jeta e gjeologut mbushet plot mbresa, vështirësi e gëzime të papritura. Gëzimi i tij në çastin që zbulon një mineral mund të krahasohet me atë të prindit, kur i lind fëmija e parë...

Ditën e parë ne u morëm me ngritjen e bazës së ekipit. Të nesërmen u ndamë në dy grupe dhe nisëm marshrutën. Unë dhe Skënderi u ngjitëm përpjetë malit dhe dolëm te brezi i borës. Prej andej nisëm zbritjen tërthor faqes së malit. Provonim me çekanët tanë gjeologjikë çdo gur që na tërhiqte vëmendjen, e thërmonim dhe e shikonim pastaj me lentën zmadhuese. Ecnim e shikonim me vëmendje çdo ngjyrë e çdo shtresë, që pasqyrohej në një greminë a në ndonjë shembje toke... Pasuritë minerale toka i fsheh thellë në gjirin e saj, por ndodh shpesh që ajo i pasqyron gjurmët e tyre në sipërfaqe, ashtu siç pasqyrohet shpesh në pamjen e jashtme të njeriut, bota e tij e brendshme.

Diku Skënderi gjeti një gur të murmë, i cili nën rrezet e diellit lëshonte xixëllime. U ulëm pranë njëri-tjetrit dhe të pushtuar nga një emocion i fuqishëm që e provojnë vetëm gjeologët, nisëm të vrojtonim me kujdes gurin e panjohur.

— Duhet të jetë me përbërje boksite, — tha Skënderi.

— Kurse mua, më lë përshtypjen e hekurit, — thashë unë.

E futëm gurin në çantën e shpinës, piketuum vendin dhe vazhduam kërkimin. Orët kalonin pa u vënë re. Kureshtja profesionale na rrëmbente kohën dhe lodhjen. Drekën e hëngrëm në rrëzën e një shkëmbi, i cili ngrihej madhështor mbi ne. Herë pas here ne ia qepnim sytë barkut të tij gri dhe futeshim në diskutime... Kur dielli zbriti në perëndim, ne u ngjitëm pranë çadrave tona. Me dy shokët tanë, Hilmiun dhe Luanin, u takuam me një mall të çuditshëm, sikur të kishim shëtitur gjithë botën e kusshedi ç'kuriozitate kishim për t'i thënë njëri-tjetrit...

Kështu me kërkime, kureshtje e diskutime, kaluan pesë ditët e para. Të gjashtën ditë unë e Skënderi u larguam shumë nga çadrat. Kaluam përtej malit dhe zbritëm një shullë, në fund të të cilit gjendej një fshat i shpërndarë. Në mes të shkurreve takuam një bari me tufën e tij të dhive. Bariu ishte një djalë rreth të katërmbëdhjetave. Ishte djalë i shëndetshëm me trup të hedhur. Flokët e tij të qethur me gërshërë ia bënin pak komike fytyrën. Së pari ne i mësuam emrin. E quanin Mark. Në fillim Marku u tregua i druajtur, i turpshëm, megjithëqë çantat tona, çekanët e lentën e dorës i shikonte me kërshtëri. Kur i treguam profesionin dhe qëllimin tonë ai u gjallërua papritur dhe vetvetiu futi dorën në çantën e tij të bukës. Që andej nxoni diçka të mbështjellë me një copë gazetë.

— Ç'ke aty? — e pyeti Skënderi.

— Kam një gur... ndoshta si ata që kërkoni ju, — tha ai me gjysmë zëri dhe hapi letrën. Unë e mora gurin nga dora e tij dhe ngrita lentën mbi të. Guri ishte i rëndë. Karakteristikë e mjaft gurëve mineralë.

— Ku e gjete këtë? — e pyeta djaloshin, i cili shikonte tashti me sy të ndezur e kureshtarë?

— Ja... atje lart, në shpinë të asaj kodre, — tha ai duke treguar me gisht.

— E përse e ke marrë këtë gur? — e pyeti me habi Skënderi.

— Ne kemi shumë gurë të tillë... kemi lloj-lloj ngjyrash.

— Ku i keni?

— Atje... në fshat në shtëpinë e gjologjanit.

— Ç'është ky gjologjan? — pyeta i habitur Markun e vogël.

— Është një plak... Nikolla e quajnë... ai na ka mësuar ne të mbledhim gurë... ai ka shumë vjet që mbledh gurë të tillë, prandaj fshati e ka quajtur gjologjan.

— A është tashti në fshat ky gjologjani? — e pyeta plot kureshtje.

— Jo! Sot ka shkue në Thanas... pa le vjen vonë në mbrëmje.

— Atë duhet ta takojmë patjetër, — tha Skënderi.

— A na e jep ne këtë gur? — i thashë Markut.

Ai mbeti një çast ngushtë, u mendua dhe tha:

— Unë do t'ia çoj xhaj gjologjanit... ju kërkoni atij, a thatë se do ta takoni vetë?

Dukej hapur se ai nuk kishte dëshirë të na e bënte atë dhuratë pa pyetur plakun e fshatit, që i kishin vënë këtë emër të çuditshëm, prandaj i thashë:

— Mirë Mark kështu e lëmë. Atij xhaj gjologjanit, do t'i thuash se kanë ardhur një grup gjeologësh. Çadrat i kemi ngritur në Qafë Kërçep. Nesër është e diel dhe do të merremi me ca punime në bazë, kur-

se të hënën do të vijmë në fshatin tuaj. Do të vijmë të takohemi me xhaj Nikollën e të shikojmë dhe gurët e tij. I thuaj po munda të na presë në fshat.

— Mos kini keq... fjalët tuaja ia çoj unë një më një gjologjanit, — tha djaloshi dhe u nda nga ne i gëzuar.

Të nesërmen, ndërsa dielli po dilte përballë mallit Kronjar, drejt çadrave tona po vinin tre të panjohur. Pasi u afruan, unë dhe Skënderi njohëm Markun, djaloshin që patëm takuar një ditë më parë. Bashkë me të ishte një moshatar i tij dhe një malësor me trup të gjatë e shpatulla të gjera. Në sup mbante një trastë mushamaje të përdorur shumë.

Sapo iu afruan çadrës, malësori na foli me dashamirësi:

— Mirë se na erdhët or çuna kësaj ane.

Ndërsa ne po shtrëngonim duart me të, Marku na prezantoi:

— Ky është xhaj gjologjani që ju thashë dje.

Shtruam një mushama dhe u ulëm të gjithë. Pranë plakut rrinin dy fëmijët, Marku dhe Hila, nxënëse të klasës së pestë. Plaku u ul këmbëkryq. Përpara gjunjëve la çantën e mbushur me gurë.

— Ju lumtë or çuna, që keni ardhë... poo... a keni gjet gja mademe? — pyeti plaku.

— Shenja të mira ka xhaj Nikollë, megjithë që është akoma shpejt të flasim. Ne do ta kontrollojmë mirë këtë krahinë deri nga fillimi i vjeshtës, — i tha Skënderi.

— Ashtu?... Mirë fort... po të ngulni këmbë do të gjeni patjetër, por duhet me kërkue me këmbëngulje gjithandej, — tha ai dhe zgjidhi çantën e tij e shtroi përpara nesh një tok gurësh, sikur të ishin mollë e të na thoshte: «bujrëm të hamë me këto që

kemi». — Këta gurë kanë shumë vjet në arkën time, — vazhdoi plaku duke i përkëdhelur me ato duar të ashpra, të regjura nga gjashtëdhjetë e ca vjetët.

Pasioni i madh i atij fshatari pa shkollë për gurët mineralë na habiti dhe nuk na u prit të shuanim kureshtjen.

— Këta gurë më kanë bërë për vete qysh në moshën njëzet vjeç, — nisi të na tregonte xhaxha Nikolla. — Shkoja me dhi, bridhja nëpër përrenj e luginë, malit e buzës së Drinit. Më kishte rënë në sy se toka nuk ishte kudo njësoj. Diku kishte ngjyrë të kuqe, diku të zezë, diku të verdhë. Edhe gurët ishin me ngjyra të ndryshme. Kjo gjë më nguliti në tru pyetjen: «Pse toka nuk është kudo njësoj?» Çudia m'u shtua më shumë kur vura re se edhe gurë të njëjtë nga madhësia, nuk peshonin njësoj në dorë, or ti! «Ç'është kjo kështu, o Nikollë?!» — thosha me vete. Kështu nisa të mblidhja gurë e t'i vija në një arkë në katuan e shtëpisë. I mbajta të fshehur... i kisha sekretin tim, gja.... por plaku m'i pa një ditë dhe më bërtiti:

«Ç'i ke këta gurë, or budall; hudhi ore poshtë, se po bahesh ma zi se Zef Culli».

Zef Culli ishte një i marrë nga fshati fqinjë, që ngrihej me natë, mblidhte gurë të bardhë në lumë dhe ngjitej e i fshihte diku në pyll. E kur dilte nga pylli i shikonte njerëzit me frikë se mos i zbulonin sekretin e tij... or ti! Mos po bahem sak budall si Zefi dhe unë? — pyesja herë-herë vedin me frikë. Por, nga gurët nuk hiqja dot dorë. I fsheha në një vend tjetër dhe herë pas here mblidhja të tjerë... Pasha besën! Më dukej sikur kisha një pasuri timen. Për dreq, puna e gurëve të mi i ra në vesh edhe priftit

të katundit dhe ai më quajti budall në mes të miletit. Frika e budallallëkut nuk më ndahej. Në atë kohë në katundin tonë zbriti një i huaj... Ingliz ishte. Smith e quanin. Fjala u hap gjithandej se ai ishte «gjolog që kërkonte gurë mademi». Unë u gëzova shumë në fillim... Më doli dhe frika se mos bëhesha sak budall si Zefi. Baba nuk do të më quante më budallë. Mirëpo më vonë, m'u ndez inati dhe nisa ta urreja inglizin qamet... Ai po mblidhte gurët e mi. Një ditë ai më takoi dhe më foli me terxhumen:

— A ke gjetur nga këta gurë ndokund kësaj ane? Në dorë mbante një gur që ndriste nga dielli.

— Jo, — i thashë. Ai më shikoi drejt në sy dhe më tha me të butë.

— Më kanë thënë se ti mbledh dhe ruan gurë të tillë. Po të m'i japësh mua dhe të më tregosh vendet ku i ke gjetur, unë do të të paguaj mirë, e me pare në dorë.

— I thuaj se unë jam bari e nuk shes këtu gurët e tokës sime, — i thashë me inat terxhumenit. Inglizi më shikoi i çuditur e u largua i zemëruar... Kështu, or çuna,, inglizi, pasi brodhi në shumë anë, iku se po vinte lufta. Ditën që iku, derdhi në mës të fshatit një trastë me gurë dhe tha në gjuhën tonë:

«Këtu nuk ka mademe... kot puna... munduar kot unë».

Gurët që derdhi nuk ishin sojet, nga ata që zgjidhja unë. Fjalët e tij m'u dukën dhelparake. Një fshatar më tha: «E shef, or Nikoll, që je mundue më kot, si ai budalli». Në katund u hapën fjalë se inglizi kishte lanë nëpër male ca shenja të fshehta. Unë nuk hoqa dorë nga gurët që qitnin shkëndija në diell. Katundarët filluen të më shihnin me tjetër sy. Dikush në fshat më quejti gjolog si inglizi e qysh atë-

herë gjithë fshati më thërret gjologjan. Me thanë drejt, ai inglizi, më shtyu më shumë të mendoja se këta gurë qenkeshin një punë e madhe. Pas Çlirimit pata dëgjue fjalë se qeveria jonë do të kërkojë gjithandej mademe. Kjo më gëzoi dhe nisa të shtyja edhe të tjerët të mblidhnin gurë soje, kështu i quanin në fshat. Një ndihmë të madhe më kanë dhanë nxansit e shkollës. Kam tash një grup çunash që mbledhin gurë e gëzojnë bashkë me mua. Ja këta të dy, Marku dhe Hila, kanë gjetur mjaft gurë... po do t'ju njoftoj edhe me të tjerë, – përfundoi plaku duke u përkëdhelur kokat me dashamirësi dy ndihmësve të tij të vegjël.

Ne filluam të shikonim plot kureshtje gurët e «gjeologut» plak.

Ju mund të keni shumë të tillë po si i bëhet për të gjetur vendet se ku i keni marrë? – e pyeti plakun Luani.

– Mos kini keq... unë mbaj mend edhe ditën, e jo vendin. Këtë anë unë e njoftoj me pëllambë, or ti: – tha plaku i sigurt.

Plaku Nikollë u bë miku ynë i ngushtë. Shpesh ai i ngjitej me ne bokërrimës së malit, vendosnim një shenjë e diskutonim për një gur. Ne e quanim «gjeolog asistent» e ai kënaqej shumë. Kurse nxënësve, që ai i mbante gjithnjë afër dhe bashkëfshatarëve të tij u pëlqente ta thërrisnin në emrin që i kishin vënë: «gjologjan».

Gurët e plakut, të mbledhur prej vitesh, ne i dërguam në laborator. Studimi i tyre ngjalli interes të madh. Nga qendra në ekipin tonë erdhi një gjeolog me përvojë për të ndjekur nga afër kërkimet që kishim filluar dhe për t'u njohur me të dhënat e plakut Nikollë.

«Lidhuni sa më ngushtë me banorët. Ndizni te secili dëshirën e kërkimit. Populli është vrojtues i përpiktë e i përjetshëm i fenomeneve të tokës dhe hapësirës. Keni dëgjuar se sa bukur e parashikojnë barinjtë kohën duke parë ngjyrat e mbrëmjes, hënën ose yjtë? Shikojeni ç'pasion ka pasur plaku Nikollë e me sa saktësi i ka zgjedhur gurët? Shumica e tyre nga analizat dolën me vlerë. Atë dëshirë që ka ndezur plaku te nxënësit, ju duhet ta nxitni më shumë, sidomos te barinjtë», — na tha në marshrutën e përbashkët gjeologu me përvojë, ose profesori, siç i thërrisnim ne.

Pas tre muajsh ne piketuam zonën minerale për kërkime të thella. Në shkollën e fshatit u bë një ceremoni e gëzuar. Përpara fshatarëve dhe nxënësve të shkollës plakut Nikollë iu dha titulli «gjeolog popullor».

Ajo fytyrë e regjur nga vitet, në atë çast gëzimi i ngjante fytyrës së gëzuar të një fëmije.

Kur sekretari i Partisë së rrethit i vari në gjoksin e gjerë medaljen dhe ne nga ana e ekipit i dhëmë një çantë, një çekan të ri gjeologu dhe një lentë zmádhuese, xha Nikolla tha i pushtuar nga një mallëngjim i thellë:

— Heu! Ç'bani kështu, or çuna, po më bani me të vërtet dhe mue gjeolog?! Për besë sytë dhe kambët pas gurëve do t'i la.

Përreth plakut ndrisnin nga gëzimi sytë e nxënësve, ndihmësve të tij dhe sytë e bashkëfshatarëve, që me mençurinë e tyre të thjeshtë e patën quajtur prej kohësh «gjologjan» Nikollën që mblidhte gurë mademi.

PA NDALOJE KËTË MUZIKË!

Në zyrën e drejtorit të kantierit gjeta tetë malësorë. Ishin veshur me rroba të bardha të leshta me gajtane të zez. Ishin të tetë të shëndetshëm, të rritur në klimë të mirë. Njëri prej tyre rrinte më afër drejtorit dhe fliste me të më lirshëm e si në konfidencë. Ai ishte më i gjati e më i zhdërvjellti nga të tetë. Kishte një fytyrë të gjerë, me nofulla të dala, mustaqe bojëgruri të prera hollë cep më cep të buzëve, vetulla të trasha, sy të grivër me një shikim të mprehtë. Herë pas here merrte fjalën dhe fliste në emër të shtatë shokëve. Me sa dukej, atë e kishin lënë për të parë.

— Ja na erdhi dhe tekniku, — tha drejtori, sapo u futa unë. Ai malësori i gjatë më mbuloi me një shikim të shpejtë nga këmbët deri në kokë, si për të më vlerësuar nëse e meritoja detyrën që përmendi drejtori, apo jo. Unë i zgjata dorën, ai u ngrit përgjysmë dhe dora ime e zakonshme humbi në një pëllëmbë të madhe, të fortë, me gishtërinj të gjatë e të ashpër.

— Njaqjeta, or shoq, — më tha duke më shikuar në bebe të syrit. Pasi i takova të gjithë, u ula.

— Këta shokët na kanë ardhur për ndihmë nga Veriu, tashti në dimër kur kooperativa i ka lënë si

forca të lira pune dhe ja, sapo u çova fjalë na erdhën. Ky është Xhep Kabili, bari e bujk, por kur e do puna edhe minator i zoti... jemi njohur bashkë që në Rrugën e Dritës, — më tha drejtori për atë burrin e gjatë i cili sa duhej t'i kishte lënë apo zënë të dyzetat. Këtë brigadë trimash, — vazhdoi ai i qeshur, — do ta kesh ti në sektorin tënd. Nesër duhet të fillojmë punën te Shkëmbi i Frashërit. Xhepi është dhe zjarrmëtar, do ta kesh ndihmësin tënd në çdo rast. Tashti do të shkosh bashkë me këta t'i rregullosh për të fjetur.

— Po mujtët me na vu në një barake të tanëve drejtor, — tha Xhepi.

— Po, po, në një dhomë vendosi!.. Kështu, or Xhep, për çdo gjë tashti e tutje do të keni të bëni me këtë shokun, — i tha drejtori.

— Po, shoku drejtor... mirë fort!

— Hajde me krahë të fortë, të na nderoni malësinë.

— As mos e ki atë merak, or shoku Tahir, — tha Xhepi dhe u ngrit në këmbë. Menjëherë pas tij u ngritën dhe shtatë shokët.

Kur dëlëm përjashta dhe u futëm nëpër grumbullin e barakave të kantierit, Xhepi i gjatë më hodhi dorën në sup dhe më tha:

— Besoj se do merrena vesh bashkë.

— Po u bë puna mirë e në kohë, ne do të jemi shokë e miq.

— Sa për ç'at hall, hiç mos u tremb, or ti. I shef këta?! Diva janë për punë, pasha diellin.

Betimi i tij për diellin më bëri përshtypje, jo ngaqë nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë, por nga mënyra sesi e theksoi.

— E përdorni shumë asaj ane këtë betim? — e pyeta.

— Jo fort, por mua më pëlqen shumë. Më duket si betim serioz. Po të fikej dielli, a thue s'do fike-shim krejt? — më pyeti dhe ndali në vend sikur nga ajo bisedë të varej fati i diellit apo i tokës.

— Po besa ashtu është, — i thashë dhe e zura përkrahu. Pasi u rregulluan në fjetore, Rexhepi tërhoqi edhe mjetet e punës për të shtatë shokët e tij.

Natën u hap koha. Mëngjesi u gdhi shumë i ftohtë. Malësorët ishin ngritur që në orën pesë dhe ishin ngjitur në frontin e punës, te Shkëmbi i Frashërit. Në barakë kishin lënë një shok, i cili kur të hapej mensa do t'u çonte shokëve ushqimin. Nga mensa te Shkëmbi i Frashërit mbante gati një gjysmë ore në këmbë. Kështu që, kur shoku i tyre çoi tenxheren me groshë në frontin e punës, gjella kishte zënë përsipër një cipë akulli.

— Heu, paska ngrirë, or ti, — tha Xhepi duke e dërrmuar cipën e akullit me lugë.

— Pse u ngritët kaq shpejt?... Kishit kohë sa të hapej mensa dhe ta hanit gjellën të nxehtë, — u thashë, por njëri prej tyre ma priti:

— Aa... nuk na pritet ashtu ne... Jemi mësuar me ia pre bishtin gjumit që herët, puna duhet fillue bashkë me ditën, or teknik.

Ata e ndanë gjellën në katër tasa alumini dhe nisën të hanin dy e nga dy. Unë, i ulur në një gur, po shikoja projektin e objektit që po ndërtonim. Herë pas here u hidhja shikimin malësorëve, të cilët hanin me aq oreks groshën e akullit. I pari u ngrit nga buka Rexhepi, rrëmbeu me duart e fuqishme pistoletën dhe u tha shokëve:

— Më shpejt, burra, sot duhet të qëndisim me mina këtë shkëmb dhe ta shtrijmë për tokë.

Pasi i dhashë detyrat e ditës Xhepit, u largova për në zonën tjetër të punimeve.

Pa kaluar muaji i parë, brigada e malësorëve tërhoqi vëmendjen e gjithë kantierit. Udhëheqja e kantierit u dha flamurin e garave të shpallura në mes të brigadave. Ata morën zotime të reja, ngritën normën e minatorëve. Nëpër kantier u ndezën diskutimet; brigadat e tjera të zëna ngushtë po mblidhnin forcat. Bisedat për malësorët shkonin gojë më gojë. Njerëzit flisnin shumë mirë për ta, por kishte dhe disa që thoshnin: «ata vetëm groshë e dinamit duan, kush merret me ta». Dikush i quajti ata «pellazgë». Ky emër doli nga kantieri, shkoi në ndërmarrje e më tej akoma, në qytetin e vogël, i cili ndodhej nja dy orë larg kantierit tonë. Në fillim malësorët e morën shumë tërs këtë emër dhe u desh ndërhyrja e drejtorit, për të mos plasur ndonjë sherr. Ata i kishte quajtur «pellazgë» një shofer, i cili nuk kishte pasur në zemër asnjë qëllim të keq. Për të treguar forcën e tetë malësorëve, ai i kishte krahasuar ata me batorët e dëgjuar të fisit të vjetër. Nëpër kantiere, ku vështirësitë mbulohen me shaka e me një humor karakteristik, aq duhet, sa të dalë një fjalë për t'u rrokullisur gojë më gojë e për t'u përjetësuar pa qëllim, pa dëme, për shaka, për të qeshur.

Në kantierin tonë në thellësi të Jugut, deri atëherë, nga Veriu ishte vetëm drejtori. Ai ua dinte malësorëve huqet dhe zakonet më mirë se kushdo tjetër në kantier. Kështu që ai, nuk e pati fort të vështirë për t'i bindur malësorët se, ai shoferi, ishte djallë i mirë, nuk kishte pasur asnjë qëllim të keq dhe se pellazgët patën qenë goxha burra, një fis i mirë

e i fortë. Me kalimin e kohës, kjo shaka u bë e zakonshme. Kur ndonjëri thoshte: «Largohuni se erdhën pellazgët», malësorët qeshnin e hidhnin ndonjë romuz sipas mënyrës së tyre.

Gjatë katër muajve flamuri i garave mbeti në brigadën e malësorëve. Një ditë në një mbledhje u ndezën gjakrat. Dikush tha se flamuri u jepet me hatër malësorëve. Këto fjalë bënë që tre-katër malësorë, të brofin në këmbë të nervozuar. Brigadieri i tyre Xhep Kabilj i uli shokët dhe duke mbajtur vetë gjakftohtësinë tha:

— Nuk asht burrni me iu hjedh tjetrit sipër për fjalën që thotë. Atij duhet me ia mbushë mendjen me punë. Unë mendoj që komisioni i garave për këtë muaj, të zgjidhet nga brigadat që kanë humbur flamurin, e në atë komision të jetë edhe ky shoku. Unë, në emër të shokëve të mi them se ai flamur që kemi ngulë ne në Shkëmbin e Frashërit do shumë djersë e burrni të zbresë andej... Këtu fjalën brigadierit malësor ia ndërpre në duartrokkitjet. Pas pak ai vazhdoi: — Prandaj udhëheqja e kantierit mund të gjejë një flamur tjetër, pasi atë ne mund t'ia çojmë kooperativës sonë që na dërgoi për ndihmë.

Muajt e ftohtë të dimrit kaluan. Flamuri në Shkëmbin e Frashërit nuk luajti vendit. Unë isha lidhur ngushtë me brigadën e malësorëve. Prilli atë vit e nisi me diell të fortë. Një pasdite unë mbërrita bashkë me tetë malësorët në qytetin e vogël. Duke ecur ashtu krahu njëri-tjetrit gati e shumë bulevardin e ngushtë. Njerëzit hidhnin shikime kureshtare mbi malësorët të veshur me atë kostumin e tyre karakteristik. Unë për t'u bërë qejfin i futa në lulishten e vogël, por të bukur të Turizmit. Bashkuam dy tryeza dhe u ulëm poshtë degëve të një plepi lotues, afër

tendës së orkestrës. Kishim vendosur atë mbrëmje të pinim, ta festonim, se pas disa ditësh unë do ndahe-sha nga miqtë e mi të mirë. Ata do të shkonin përsë-ri në Veri, ku i prisnin punët e kooperativës së tyre. Kamerieri, i cili më njihte, më shkeli që tej syrin.

Dielli humbi prapa malit Xhuvar dhe mbi qytetin e vogël, të pastër e të qetë, po binte mbrëmja. Tryezat në lulishten e vogël po mbusheshin me çifte. Malësorët hidhnin sa andej këtej shikime të qeta, me një kureshtje të përmbajtur. Qëndrimi i tyre më bëri përshtypje. Ata ishin të pabredhur në qytete, të pashëtatur me përjashtim të Xhepit i cili kishte punuar në Rrugën e Dritës...! Për ta ishte hera e parë që uleshin në lulishten e një Turizmi, pra duhej të ishin tepër kureshtarë, pasi kureshtja, habia janë pasqyra të mosnjohjes, por malësorët tanë kanë sedër. Dhe ata miqtë e mi nuk i linte sedra malësore të tregonin habi për variacionet e luleve, për mënyrën e veshjes së njerëzve, për dritat që reflektoheshin, për trupën e orkestrës të veshur bukur e për llojet e veglave muzikore plot shkëlqim. Përpjekja e tyre për t'u treguar aty, si në shtëpi të tyre, më ngjalli një ndjenjë gëzimi. Qytetarët nëpër tryeza hidhnin mbi ta shikime kureshtare.

Ishte gjë e bukur të shikoje nga afër përpjekjet e atyre njerëzve të çiltër, për të ruajtur normat e sjelljes në Turizëm. Megjithatë, të folurit me zë të lartë, nuk e frenonin dot. Në pistën e rrumbullakët në mes të lulishtes, çiftet vërtiteshin plot hijeshi. E nisnin me tingujt e një tangoje të lehtë dhe pastaj kalonin në kërcime më të nxituara. Në fytyrat e malësorëve dukej sikur lodronin hijedritat.

Me sa dukej, atyre, nuk u pëlqente kërcimi i pambaruar i atyre çifteve bark për bark, atje në pis-

tën e rrumbullakët. Vëmendjen e tyre e tërhoqën katër vetë që u futën në lulishte dhe u drejtuan në tryezat e rezervuara. Ishin dy burra bjondë, me flokë gjysmë të rënë, një me fytyrë pikalloshe, tjetri mban-te në dorë një aparat fotografik. Në mes tyre ishin dy gra të gjata si gjirafa, me fustane të shkurtëra lart gjunjëve, me fytyra të mufatura si të lodhura. Sandalet me taka të larta tape, i nxirrnin më në pah këmbët e tyre të holla. Fytyrat e malësorëve u rru-dhosën. Ata nisën të lëviznin në karnige sikur në tryezën tonë të ishte ulur një njeri i padurueshëm.

Rexhepi shtrembëroi fytyrën si të kishte përty-pur diçka të hidhur dhe më tha me habi:

— Po këta ç'janë, or teknik, a thue kanë luejt mendsh, a?

— Janë të huaj, turistë! — thashë unë duke i shi-kuar me gjakftohtësi malësorët.

Pas një copë here njëri nga çiftet e huaj doli në pistë. Ata nisën të kërcenin me vrull pa e respektu-ar ritmin e orkestrës. Unë, me lutje të Xhepit, shko-va dhe i kërkova orkestrës të mirrte një valle për malësorët.

— Na falni, or shok, po këtu është Turizëm — ... s'mund të plotësojmë porositë e veçanta, — tha për-gjegjësi.

— S'ka ndonjë gjë mo, punë e madhe, — i tha përgjegjësit fizarmonicisti, duke marrë aprovimin e shokëve të tjerë të orkestrës.

— Jo, ore shokëni, mos na ngatërroni tashti, — nguli këmbë përgjegjësi.

Muzika vazhdonte. Disa çifte dolën nga pista pa ndalur orkestra. Unë u ktheva te malësorët. Xhepi u revoltua nga fjalët e përgjegjësit të orkestrës dhe u ngrit në këmbë. Përshkoi me tre hapa të mëdhenj

distancën nga tryeza jonë dhe ashtu i gjatë si div, u fut nën çadrën plot ngjyra të orkestrës, Mbi të ulëshuan shikime kureshtare. Xhepi i mbështeti dorën e rëndë mbi sup përgjegjësit të orkestrës dhe i tha me të butë:

— Ndale, të lutem, ç'te muzikë.

Xhazbandisti ndaloi i pari, pastaj fizarmonika, saksi... Çiftet ndaluan, duke hequr këmbët zvarrë, ashtu siç ndal duke kërcitur një makinë, që në ecje pëson një difekt... Në fytyrën e çiftit të huaj ishte nderë një pamje frike e hutimi, ndërsa malësori, qëndronte më këmbë para përgjegjësit të orkestrës veshur me kostum të zi si një shpend gjigant i bardhë. Ata, të huajt, prisnin ndoshta ndonjë skenë të vendeve të tyre, një krim a një rrëmbim me dhunë.

— «Assassino», — mërmëriti e trembur dama e huaj.

Në heshtjen e thellë u dëgjua zëri kumbues i Xhepit:

— Pa merrjani, or çuna, ç'asaj valle të Kukësit!

— Dam-da-da, dam-da-da, dam-dam, — gjëmoi i pari xhazbandisti. Menjëherë veglat e tjera u shkri-në në valle. Rexhepi i gjatë u hodh si div në pistë. Çifti i huaj u tërhoq i trembur në tryezën e tij.

Me një shenjë të Rexhepit të shtatë malësorët u gjendën pranë tij. Ai u tha: «Kujdes burra» dhe mbërthyen krahët. Pasi kapën ritmin, nisën vallen. «Më shpejt» — i tha Xhepi orkestrës. Ritmi u rrit. Gjëmimi i orkestrës përplasej në ndërtesën pranë hotelit e ngjitej në qiell. Malësorët hidheshin si diva tërë gaz e krenari. Xhepi ulej gati në gjunjë, vërtitej, hidhej përpjetë e kërcente përpara, thuajse donte ta kthente atë valle në potpuri. Çiftet qytetare rrethuan pistën. Të huajt mbetën prapa tyre si të mekur. Në

vargun e gjallë të malësorëve me rroba të leshta, të bardha, u futën qytetarë. Vallja u ndez më shumë. Ai burri i huaj që ishte trembur në fillim nga malësori, u ngjiti mbi një karrige dhe po fotografonte pistën. Duartrokitjet ritmike mblodhën rreth Turizmit njerëzit që shëtisnin bulevardit në mbrëmjen e qetë.

FUNDI I DURIMIT

Golupet¹⁾ e ulëta të murme, të mbuluara me kashhtë e të ndërtuara me shufra druri të lyera me baltë, shtriheshin në rrëzën e një kodre të pyllëzuar. Në majë të kodrës ngrihej shtëpia e bardhë me dy kate, krejt e rrethuar nga pemët. Në golupet e ulëta të fshatit Vërriaj vërtitej tymi, linte në çati, në mure gjurmën e zezë dhe dilte nga mundte, kurse mbi shtëpinë e Hysen agait tymonte një oxhak i lartë e gjithë zbukurime. Ky ishte rregulli: oxhak mbante vetëm agai, bujqit e tij nuk e kishin këtë të drejtë. Hysen agai ishte tip nervoz, plot huqe e teka të pafrenuara. Ai kishte tre fëmijë: dy vajza dhe një djallë. Vajzat banonin në qytet e rrallë, në muajt e verës, dukeshin në fshat. Kurse djalin, agai e mbante pranë vetes nën kujdesin e një shërbyeseje të re e të shkathët. Donte ta mësonte me huqet e tij. I duhej që çifliku i tij të kishte edhe paskëtaj një dorë të fortë.

Disa vjet më parë nga koha që nis fill ky rrëfim, në fshatin Vërriaj ishte hapur një shkollë. Ishin ato vite kur revolta dhe pakënaqësia e njerëzve në-

1) Golupe – lloj kasolleje.

për qytete futej shtigjeve dhe nëpër fshatra e u jepte zemër të shtypurve për të kërkuar drejtësi.

«Bejlerët na mbajnë në padije... u duhet vetëm një xhami... nuk duan shkolla në çifliqet e tyre, se mos u hapen sytë bujqve», — flisnin njerëzit.

Hysen agai në këtë rast u tregua i zgjuar. Përkrahu hapjen e shkollës, bile ndihmoi me material për ndërtimin e saj.

Atje në fshat vazhdonte shkollën edhe i biri.

«Nuk i ka lënë gjë mangut të atit, sikur e ka nxjerrë nga hundët, sherrxhi e tekanjos. Shikon të atin zot mbi fshat dhe vetë hiqet si zot në shkollë, bile dhe mësuesi i ruhet», — thoshnin fshatarët. Djali mbartte në natyrën e tij psikologjinë e të atit, i cili ishte pasanik, pa horizont, me arsim fare të kufizuar. Atij i duhej vetëm firma e tij e atë e dinte mirë. «Pasuria të bën të mençur, të bën trim dhe zot të të tjerëve», — u thoshte ai miqve të tij në qytet kur i flisnin për shkollimin e djalit. Kështu që i biri shkonte keq në mësim. Kishte kaluar klasat si bir agai, e jo me aftësi. Mësuesi i kishte caktuar si kujdestar, për ta ndihmuar nxënësin më të mirë të klasave më të larta, Ali Velon, për të cilin do të bëjë fjalë tregimi ynë. Ky veprim në dukje i thjeshtë e thelloi urrejtjen në mes të birit të bujkut dhe agait të vogël. Një ditë, përpara se të fillonte mësimi, djali i agait u grind me Aliun dhe e qëlloi me pëllëmbë përpara shokëve. I biri i bujkut nuk e duroi dot turpin, urrejtja për aganë e vogël shpërtheu e nuk e la të mendonte se ç'mund të ndodhte më pas, dhe ia ktheu goditjen të birit të agait.

Kaq desh agai i fshatit dhe Ali Veloja u përjash-tua nga shkolla. Kështu nxënësi gjashtëmbëdhjetë-vjeçar Ali Velo filloi punë në stallën e lopëve të agait,

e cila shtrihej afër shtëpisë së tij të varfër. Ai nisi të njihte mbi trupin e tij vuajtjet e prindërve dhe të bashkëfshatarëve. Padrejtësitë e jetës e forcuan dhe po e piquin para kohe.

Babai i Aliut, Zyber Veloja, punonte herë me qe në arë, herë në qerre. Xha Zyberi dhe shumë bashkëfshatarë të tij shkonin keq me aganë e fshatit. Tashiti që i përjashtuan dhe djalin nga shkolla, xha Zyberit iu dyfishua urrejtja kundër tij. Babë e bir kishin nisur ta kuptonin njëri-tjetrin. E kuptonin shqetësimin e shoku-shokut ashtu në heshtje, pasi xha Zyberi kurrë nuk ishte hapur me të birin.

Një natë, në shtëpi të Zyber Velos erdhi një kushëriri i tij, që punonte në qytet. Dhomën ku rrinte xha Zyberi me kushëririn nga qyteti e ndante nga dhoma ku flinte Aliu me të ëmën, një mur i thurur me thupra, e i lye me baltë. Kështu që Aliu filloi të dëgjonte copa nga biseda që bënte i ati me xhaxhanë.

— Dëgjo, Zyber, — thoshte kushëriri i ardhur nga qyteti, — Hysen agait do t'i vijë fundi. Komunistët po u hapin sytë njerëzve. Pushtimi i italianëve po i ndez zjarret. Patriotët e vërtetë i kanë vënë gishtin kokës. Agallarët që i kanë pirë gjakun milletit janë futur në prehër të armikut. Punët po marrin zjarr e në krye janë komunistët. Sonte nuk kam ardhur vetëm për të nderuar e biseduar si herët e tjera... dua që të më ndihmosh.

— Përse e ke fjalën, Xhelo? Ç'farë ndihme do nga unë?

— Në qytet jemi një grup i tërë shokësh që, në një mënyrë a në tjetrën, mbledhim armë për luftën...

— Po unë, ku t'i gjej armët në fshat? Në gjithë fshatin vetëm koburja dhe çiftja e Hysen agait janë.

— Jo, nuk e kam fjalën aty... Nga ti nuk duam

armë. Nga ti duam që të na i fshehësh diku armët që do të sjellim nga qyteti.

Pas këtyre fjalëve kishte rënë heshtja në mes të dy burrave. Xha Zyberi fërkonte mjekrën dhe mendohej. Mendohej për djalin dhe për gruan. Atij ia donte zemra që të mblidheshin armë, bile kishte dëshirë të madhe që të kishte vetë një copë kobure. Ta mbante diku të fshehur e një ditë ta shkreppte mbi kokën e Hysen agait.

Nga dhoma tjetër Aliu priste me veshët pipëz. Në dhomë dëgjohej vetëm frymëmarrja e së ëmës që flinte. Ishte afër mesit të natës. Ai dëgjonte i ngjitur pranë murit. I dukej sikur do t'i pushonte zemra nga çasti në çast duke pritur se ç'përgjigje do t'i jepte i ati xhaxhait.

Xha Zyberi, pasi u mendua një copë herë të gjatë, i tha të kushëririt:

— E ke peshuar mirë këtë punë, Xhelo?... Ke menduar se mund të na zbulojnë dhe pastaj gruan e djalin e vetëm do të m'i djegin në këtë koliben me kashtë?

— E kam peshuar... ne do të punojmë me mend në kokë. Do të punojmë natën, që të mos na diktojnë... Se mos do të sjellim topa, derëbardhë? Fjala është për ndonjë pushkë, kobure dhe ndonjë bombë, gjëra që mbahen dhe në gji... Pastaj të flasim si burrat: kur të ndizet lufta, edhe do të vritemi, edhe shtëpi do të digjen, lufta nuk është dasmë, o kushëri... po shikojmë e bëjmë deri atëherë... mos e shpjer mendjen për keq. Përtej në pyllin tonë mund të fshehësh dhe kaun e jo më një dyfek...

Pas një heshtjeje të gjatë Aliu dëgjoi përsëri zërin e të atit:

— Po mirë, o Xhelo. Të bëhet si të bëhet, armët

do t'i fsheh unë në ndonjë shpellë a në zgarbullin e ndonjë lisi, por ama duhet menduar mirë sesi do ta fillojmë punën.

Pas këtyre fjalëve xha Zyberi dhe i kushëriri ishin ngritur dhe kishin dalë nga shtëpia. Aliun e digjte kureshtja se ku kishte shkuar i ati me xhaxhanë. Gjumi e mundi vonë, pas mesit të natës. Kur u ngrit në mëngjes, i ati po lidhte qetë e agait në qerre, kurse xhaxhai kishte ikur në qytet. Ditët kalonin për Aliun plot kureshtje dhe lodhje nga puna e rëndë.

Eh, sa dëshirë kishte ai të bisedonte me babanë, ta pyeste, të kërkonte shpjegim për bisedën e asaj nate! Sa dëshirë kishte të dinte se ku i fshihte armët babai! Shpeshherë ia ngulte sytë të atit me shpresë se mos ai ia kuptonte dëshirën e i tregonte sekretin e madh të armëve. Ngandonjëherë Aliu shikonte në ëndërr sikur ishte nëpër pyll, gjente armët te një shpellë, merrte atje një kobure dhe i zinte pusi Muhametit, të birit të Hysen agait.

Kështu, plot kureshtje, kaluan rreth gjashtë muaj. Aliu po u afrohej të shtatëmbëdhjetave. Në shtëpinë e tyre vinte herë pas here xhaxhai nga qyteti me dy-tre shokë të tij. Vinin nga pylli. Vinin natën, e natën iknin përsëri. Nëpër fshat u përhapën fjalë, se në male kishin dalë shumë firarë, që do të luftonin kundër italianëve e kundër agallarëve që qenë bërë vegla qorre të pushtuesve. Hysen agai i shqetësuar shkonte e vinte në qytet. Qehajai i tij i bënte veshët katër nëpër fshat se mos dëgjonte ndonjë fjalë kundër të zotit. Edhe një mbërmje tjetër kishte ardhur përsëri xhaxhai dhe i kishte thënë Zyberit se dita e luftës po afrohej. Do të krijohesh një çetë partizane dhe armët do t'u shpërndareshin atyre.

Pas dy-tre ditësh Hysen agai e nisi Aliun për në qytet.

Pasi dy fshatarë ngarkuan një mushkë me dru të thata, agai i tha:

— Dëgjo këtu Ali, do t'i shpiesh drutë në shtëpinë time, në qytet. Këtë shportë me fiq do t'ia shpiesh zonjës... ki kujdes se mos fusësh dorën në to...

Pasi e vendosën dhe shportën e re me katër-pesë kile fiq të freskët mbi samarin e mushkës, në mes të druve, agai, që rrinte më këmbë duke goditur çizmet e gjata me një thupër, — i tha Aliut dhe një herë:

— Ki kujdes se mos të bien drutë udhës... mos hash fiqtë. Shportën merre prapë me vete kur të kthehesh, dëgjove?

— Si urdhëron, aga, — iu përgjigj Aliu, ndërsa shpirtin ia ndrydhte ndjenja e urrejtjes për të.

Agai, përveç shtëpisë në fshat, kishte dhe në qytet një palë shtëpi të bukura, të rrethuara me një mur të lartë. Atje banonte më tepër e shoqja e Hysen agait, zonja Qamile, siç e thërrisnin.

Aliu u nis për në qytet duke tërhequr mushkën nga kapistalli. Në të hyrë të qytetit, fare pranë tij kaloi me shpejtësi e zhurmë një makinë me xhandarë. Mushka u tremb nga makina dhe u hodh përpjetë. Drutë u kthyen nga njëra anë. Shporta me fiq u përplas dhe ca kokrra u derdhën dhe u dërrmuan në shesh, në pluhur. Aliu u hidhërua shumë, ngaqë zonja do të mendonte se fiqtë i kishte ngrënë ai. Pasi rrëgulloi me mundim barrën e druve vazhdoi udhën.

Kur u fut në oborrin e shtëpisë së agait, shërbëtorja lajmëroi zonjën Qamile. Ajo zbriti shkallët rëndë-rëndë dhe e pyeti:

— Hë, ç'lajme ke sjellë nga fshati, piciruk?

— Agai më tha se mund të vijë nesër... më dha këtë shportë me fiq... më tha që shportën ta marr prapë me vete, se i duhet.

Zonja mori shportën me fiq të freskët dhe u fut në shtëpi. Pas një copë here doli e egërsuar:

— Pse i ke ngrënë fiqtë ti pizeveng? — i bërtiti Aliut.

— Nuk i kam ngrënë, zonjë. Në rrugë... — nisi ai të shpjegohej; por ajo, ia preu fjalën, e shau përsëri dhe e pështyti në fytyrë. Aliut iu duk sikur në fytyrë i ra diçka tepër e ndyrë. Fshiu fytyrën e pa u përmbajtur u mat t'i hidhej zonjës në fyt, mirëpo në çast shërbëtorja, një grua e thyer në moshë, e zuri për krahu dhe e hoqi prapa me keqardhje.

— Si? Guxon dhe të më afroresh, ti, leckaman?! Pa shiko këtu sa kokrra fiq kanë qenë? — tha duke hapur përpara tij një copë letër. Hysen agai i kishte shkruar së shoqes se sa kokrra fiq «të këputura me dorën e tij» po i dërgonte. Letrën e kishte vënë në fund të shportës. Ky veprim e revoltoi më shumë Aliun dhe nuk e përmbajti dot veten, por tha përpara zonjës Qamile:

— Maskarai, dhe kokrrat e fiqve i paska numëruar?!

— Si the, ti zagat, si? Shporru nga oborri i shtëpisë pa ta ndreq unë te agai, — iu hakërrua zonja Qamile, ia përplasi shportën përpara këmbëve dhe ngjiti shkallët duke tundur trupin e shkurtër e të bëshëm.

Aliu doli nga oborri i agait i pikëlluar dhe me një urrejtje të patreguar në shpirt. Sa dëshirë kishte që në atë çast ta shembte atë shtëpi të mallkuar. Në mendje i mbeti fytyra prej bishe e zonjës dhe shikimi keqardhës i shërbëtores. Aliu shkoi te xhaxhai

dhe ia tregoi këtë ndodhi me lot në sy.

— S'ka gjë, bir se do të vijë shpejt dita që të ta paguajë zonja atë pështymë, — i tha ai.

— Kur do të vijë ajo ditë, xha Xhelo? — e pyeti Aliu me kureshtje.

— Do të vijë së shpejti.

— Unë nuk do ta pres atë ditë.

— Po ç'do të bësh?

— Asaj zonjës do t'i vras të birin në fshat... do t'i vras atë që u bë shkak e më lanë pa shkollë.

— Jo, or bir, nuk është aq kollaj ajo punë? Po të vrasësh ti atë, të varin ty me gjithë ç'ke mu në mes të fshatit. Jo, jo, nuk ka ardhur koha për këto punë. Harroje atë që të ndodhi me zonjën. Kur të vijë dita, të thotë xhaxhai ty se ç'të bësh.

— Më thuaj që tashti, xhaxha... unë nuk jam i vogël... unë jam shtatëmbëdhjetë vjeç tashti... bota mbajnë familjen në këtë moshë... ruajnë njëqind de-le... — po i thoshte Aliu me një frymë duke shpresuar se xhaxhai do ti tregonte për ato punët e luftës që bisedonte me të atin në fshat, por ai ia preu shkurt:

— Mos u nxito! Rri i qetë! Rritu akoma se do të të vijë radha... Eee... këto mendime ruaji mirë, se po i shkuan në vesh Hysen agait, të mbylli në ahur të kuajve.

— Pse më quani kaq të vogël, xhaxha?... Unë nuk jam aq budalla sa të mos e di se për këto gjëra Hysen agai të lidh duart.

— Mirë, mirë, i di ti, po dhe s'i di aq mirë, — i tha me të mirë xhaxhai.

— Unë desha të të thoshja xhaxha se...

— Çfarë do të më thoshe?

— Po ja... unë... unë ju kam dëgjuar ty dhe babanë... kur flisnit...

— Si?... Na ke dëgjuar?... E çfarë?

— Kur flisnit për partizanët, për aganë?

— Kur kështu? Ku?

— Në shtëpinë tonë.

— Pse, përgjoke pas derës ti?

— Jo... unë nuk dëgjoja me dashje... u ndodha zgjuar dhe zëri vinte nga muri me thupra.

— I ke thënë njeriu për ato që ke dëgjuar? — e pyeti me shqetësim xhaxhai.

— Pse thua kështu, xhaxha, unë nuk jam femijë tashti!

— Po më, ç'ke dëgjuar?

— Edhe për armët... ato armë që ka fshehur babai.

— I di ku janë fshehur? — pyeti xhaxhai edhe më i shqetësuar.

— Jo, nuk i di.

Pasi u mendua një copë herë të gjatë, xhaxhai i tha djalit:

— Shiko se mos të shpëton goja e thua ndonjë fjalë.

— Këtë e di, xhaxha... Por ju kot e keni që më quani kaq të vogël...

Xhaxhai i fërkoj kokën me dashamirësi dhe i tha:

— Mos u mërzit, do të vijë dita që edhe ti të bësh shumë për luftën. Ti do të bëhesh një partizan trim. Tashti dëgjo këtu! Këto që më the mua, mos ia thuaj as babait. Hipi mushkës dhe nisu për në fshat, mos të të zërë nata udhës. Babait thuaji të vijë nesër poshtë. Ki kujdes nga agai, se e shoqja mund t'i dërgojë haber për sjelljen tënde.

— Xhaxha... po sikur unë të rri këtu te ti?
— Këtu? E ç'do të bësh këtu?
— Të rri... të të ndihmoj për të mbledhur armë,
pastaj të vij me ty... me partizanët.

Xhaxhai qeshi me zë dhe pasi i ra në shpatulla,
tha:

— Mos u nxito, bir i xhaxhait. Të thashë se do
të vijë dita edhe për ty. Tashti nisu për në fshat dhe
mos harro t'i thuash babait të vijë poshtë.

— Mirë, xhaxha!

— Hajde, udhë të mbarë!

— Mirë u pjekshim, xhaxha.

— Mirë u pafshim, partizan i xhaxhait, — ia
ktheu ai i menduar.

Aliu u nda nga xhaxhai me zemër të ngrohtë e
me besim se edhe ai do të bëhej partizan. Ecte për
në fshat i hipur në mushkë. Në prehër mbante një
teneqe vajguri, që e kishte blerë xhaxhai për ata.
Me mendje parafytyronte veten si hero, që zinte për
mjekre të birin e Hysen agait dhe e nxirrte përjashta
nga shkolla.

Të nesërmen i ati u nis për në qytet. Dielli po i
afrohej perëndimit kur Hysen agai u gjend me kalë
pranë kolibes me baltë të xha Zyberit. Në vithet e
kalit kishte hipur i biri. Thirri Aliun. Ai doli nga shtë-
pia me zemër të trembur dhe i shkoi pranë. E ëma i
ndiqte me sy që tej.

— Ku je, more zagar i zgjebosur? — iu hakërrua
agai. — Sa herë të porosita të mos i haje fiqtë e zo-
njës? Si i fute ato duar të ndyra në ata fiq që i kisha
këputur me dorën time? (Me sa dukej, agait i kishte
ardhur lajmi nga zonja).

— Nuk është e vërtetë, aga, nuk i kam ngrënë,
— i tha me guxim e egërsi Aliu.

— Si, nuk i hëngre? Domethënë, gënjen zonja?

— Po, gënjen.

— Pusho, qelbësirë, turiri yt më ka quajtur dhe maskara, ë? — i bërtiti agai dhe e goditi supeve me një shufër thane që mbante në dorë.

— Mos, aga, ai është fëmijë, mos ma vra djalin! — bërtiti që tej nëna e Aliut e egërsuar.

Aliu ndjeu një pickim therës. U përkul dhe rrëmbeu një gur. U mat të qëllonte aganë, por ai gati sa nuk iu hodh sipër me kalë. E qëlloi përsëri me shufër.

— Mos, aga t'u thaftë dora! — i tha përsëri e ëma e Aliut, e cila ndërkohë u gjend pranë të birit.

— Hidhe gurin, se ju zhduka të gjithëve nga fshati, briti agai i mavijosur nga zemërimi.

Aliu, që po sillte ndër mend porositë e xhaxhait e hodhi gurin.

— Nesër të mos vish më te stalla. Rri në shtëpi të hash këmbët e tua, — i tha agai dhe e nisi kalin revan për në qytet.

E ëma ngriti këmishën e grisur të djalit dhe kur pa vijën mavi që i kishte lënë shufra supeve, nisi të shante e të mallkonte aganë. Aliu dridhej më tepër nga urrejtja sesa nga dhimbja e goditjes.

«Eh, Hysen aga, do të ma paguash një ditë... po kur do të vijë ajo ditë?» — mendonte me vete.

E ëma ia leu vijat e mavijosura me lëng qepe dhe iu lut të shtrihej, por atij nuk i flihej. Shpirtin ia mundonte poshtërimi i agait dhe i zonjës së tij, Qamiles. Në kokë i vinin mendime nga më të ndryshmet. Aliu dëgjonte frymëmarrjen e thellë të nënës që flinte dhe mendonte. Papritur i shkrepri një mendim tepër i guximshëm, i krisur. «Të shkoj t'u

vë zjarrin shtëpive të Hysen agait... t'i djeg me gjithë ç'kanë!»

Shikoi me vëmendje të ëmën. Ajo flinte e rras-kapitur.

«Ngrehu, bëhu trim, mos u tremb», — i tha një zë i brendshëm Ali Velos.

Dhe ai u ngrit me kujdes. Kaloi në dhomën tjetër. Mori teneqenë me vajguri dhe doli nga gardhi i shtëpisë së tij prej balte. Pas një copë here u fut nëpër gardhin me tela të Hysen agait. U gjend pranë koçekëve me bereqet. I hoqi tapën teneqesë me vajguri dhe nisi ta derdhte nga një koçek te tjetri, nga koçeku te mullarët pranë shtëpisë e deri te stalla ku punonte vetë. Zemra i rrihte sikur do t'i dilte nga gjoksi. Një ndjenjë frikë desh ia preu forcat, por, sapo kujtoi poshtërimin, mori vendim plot urrejtje dhe ndezi shkrepësen. Flaka mori lehtë dhe nisi të ecte ngadalë nëpër rrjedhën e vajgurit. Aliu ia dha vrapit dhe për pak minuta u fut në shtëpi me një frymë.

— Ngrehu, nënë, — tha duke dihatur.

E ëma u hodh e trembur.

— Ç'ke, mor bir?

— Ngrehu, se dogja sarajet e agait.

— Çfarë bëre? — e pyeti e ëma e tmerruar.

— I dogja.

— Eja more në vete, ç'thua?!

— Ngrehu, nënë, se i ndeza. Eja të ikim sa nuk është zgjuar fshati.

— E mjera unë, ç'na gjeti! Ç'bëre, more i çmendur, pa qenë yt atë këtu, ku të shkojmë tashti?

Flakët po ngriheshin tej mbi koçekët e Hysen agait.

— Eja nënë, merr plaçkat që duhen, nxitohu të nisemi sa pa e marrë vesh fshati.

— E ku të futemi, more bir, pas kësaj gjëme?

— Te xhaxhai do të shkojmë. Atje gjejmë babanë. Nxitohu tashti të thashë, ç'ke ti? Përpara babait dhe xha Xhelos përgjigjem vetë unë, — i tha me guxim Aliu. E ëma ngarkoi me nxitim një deng plaçkash dhe u nisën gjatë një rrugice që çante nëpër pyll. Në kohën që nënë e bir u futën në pyllin e errët, mbi sarajet e Hysen agait po ngriheshin shtëllunga flakësh që lëshonin dritë mbi fshatin e përgjumur.

CIKËL SATIRIK

ZINXHIRI I KALBUR

Kryetar Azisi është operativ i madh, thonë ata që ia njohin huqet dhe i krehin bishtin. Dhe me të vërtetë, ku nuk e takon Azis Lamen! Ngrihet që me natë e gjendet në kafenenë e parë, pastaj në një restorant, në një rosticeri. Atë detyrë ka. Është kryetar i disa lokaleve të ushqimit social. Shpesh e gjen të ulur rëndë-rëndë në karrige. Mbështetet mirë, nxjerr përpara barkun e kërcyer mbi rrip, hedh njëren dorë mbi të dhe e fërkon lehtë. Ia ka qejfi të qëndrojë karshi njerëzve sikur të donte t'u thoshte: Mos më shikoni ashtu, shikimet tuaja të shtrembëra s'ma prishin shëndetin mua. Po t'i ulesh pranë do të dëgjosh ankesën e tij të zakonshme:

«Eh, ç'na mbytën punët, për ideal».

Sa herë që e shikoj kuqalosh, të rrumbullakët e të plotë më kujtohen dy kampionët e botës: Miloja i Krotonit dhe mareshali Bonsapier. Siç thuhet, i pari ka arritur të hajë një viç të tërë, kurse i dyti ka rrëkëllyer një çizme plot me verë për shëndetin e topa-

ve të Napoleonit. Azisi mund të nervozohet, ka ndodhur ta zërë edhe gripi, mund t'i prishet humori, por kurrë nuk ka qëlluar t'i prishet oreksi. Ai përpigjet gjithë ditën, siç i thonë fjalës, si bishti i gjarpërit. Futet në një lokal, hedh një shikim serioz që te dera, pyet personelin me ton eprori dhe ulet «i lodhur» në një tryezë.

— Ç'do të merrni shoku Azis? — pyet kamerieri që e njeh mirë kryetarin. Pyetje të tilla atë nuk e gjejnë asnjëherë ngushtë. Fërkon njëherë ballin tërë tul, rrudh fytyrën dhe thotë:

— Nuk dua gjë... ç'të marrësh!

— Merrni një fernet, shoku Azis!

— Lere ç'harxhohesh kot, derëbardhë... më duket s'jam mirë sot.

— Ndoshta keni ndenjtur vonë mbrëmë?

— Vonë thua?! Deri nga ora tetë e mbrëmjes u mora me ca procesverbale... me gjynahet tuaja, u mori dreqi. Pastaj më erdhi shoku Kristaq. Ndenjëm deri vonë. Në mëngjes, po u ngrita që në orën pesë. Na këputi kjo punë, e marrtë e mira!

— Me siguri jeni dhe pa ngrënë, kryetar?

— Hëm... pa ngrënë dal çdo mëngjes, mor djalë. Kur ngrihem unë gruan dhe fëmijët i lë në gjumë... U mësua tashti ta kalojmë ditën dhe me një kafe...

Ç'i do fjalët! Kamerieri porositi një bërçollë dhe një gotë verë. Kryetari si zakonisht shtiret, por ai ia shtron përpara. Pas pak kryetari thotë:

— Merre dhe ti një gotë nga unë, meqë s'paske klientë.

— Jo, shoku Azis... jam në detyrë.

— Shiko, shiko qerratai, — thotë kryetari dhe zgjat dorën ta zërë për veshi. Ia ka ënda që vartësit e tij t'i kapë nga llapa e veshit.

Banakieri qesh që tej me të madhe e pasi i bie një gotë shokut të punës thotë:

— Kujt do t'ia shesësh ato ti, shokut Azis? . . . Eh, or çun, ai na njeh me dhëmbë e dhëmballë.

Në tryezën e tij vijnë të njohur. Kryetarin Azis e njohin shumë. E përshëndesin. Ai dikujt i përgjigjet vetëm me kokë, dikujt i buzëqesh dhe e fton në tryezë. Të ftuarit e tij janë të zgjedhur sipas pozicionit zyrtar.

Me gjithë mënyrat që përdor shoku Azis për t'i bërë për vete vartësit e të zërë vend të qetë e të ngrohtë midis tyre, shumëkush ia ka kënduar kartën në xhep dhe herë pas here qetësinë e tij e sëmbojnë thumba kritikë. Por Azisi tregohet i duruar, i matur, kërkon ndonjë mik dhe ruan rastin për atë që kritikon «kryetarin babaxhan», — siç e quajnë dashamirësit e tij.

«Pa shikoni me mençuri përreth ç'thonë për mua?» — i këshillonte ai dashamirësit. Dhe ja një ditë kamerieri i rosticerisë «Korani» i raportoi: «Kuzhinieri Aleko, tha për ju, sikur i qerasni vartësit, por duke u dhënë një thellë për t'iu marrë një pelë. . . kështu tha për nder të familjes, kryetar, e di si më erdhi? Hapu dhe të futem».

«Ashtu, ë? Mirë. . . të faleminderit. . . shko në punë dhe kije kujdes». Kuzhinieri Aleko i kishte folur hapur kryetarit për të metat që binin në sy. Azisi i kishte pritur vërejtjet me buzë në gaz, bile i pat thënë se «kritikat na bëjnë mirë», por thellë në ndër-gjegje e kishte ruajtur të madh zemërimin. Dhe kjo është e natyrshme, njeriu me vese nuk mund të ketë zemërgjerësi të singertë. Pas tri ditësh, në valën e punës, kuzhinierit Aleko i shkoi papritur revizioni. Të nesërmen ai u gjend në zyrën e kryetarit.

— Hë?... Ç'kemi Aleko? — e pyeti kryetari duke përpyetur gishtërinjtë mbi tryezë.

— Dje më erdhi revizioni, shoku Azis, dhe sot më njoftuan se llogaritë më nxjerrin treqind e shtatëdhjetë lekë defiçit.

— Pastaj? — pyeti prerë Azisi duke ndierë një kënaqësi të thellë që «kunadhja i erdhi në lak».

— Më çudit ky rezultat... unë nuk jam dakord me mendimin e Josifit, revizorit.

— Po s'do mend, po të vësh dorë në pasurinë socialiste, s'ke si ta pranosh hapur.

— Të lutem, shoku kryetar, mos më ofendo. Unë e njoh ndërgjegjen time... kam shtatë vjet këtu dhe nuk kam luajtur santimin e lekut, unë...

— E di që ti njeh ndërgjegjen... njeh të tjerët, bën vërejtje, bile dhe hedh mendime tutje e tëhu, por këtu, shok, jemi përpara faktit, — e ndërpreu kryetari.

— Unë nuk jam dakord me këtë fakt, shoku Azis. Të përsëritet inventari edhe një herë, të llogaritet xhirimi i mallit dhe vlefta me bonot e prera nga kamerieri. Ka shumë mundësi që ai të ketë ngatërresë në bono.

— Mos e shpjer më tej fjalën, ai është nga punonjësit më të rregullt.

— Ky është mendimi juaj, shoku kryetar. Unë, në bazë të rregullave për të mbrojtur dinjitetin tim, kërkoj përsëritjen e inventarit, bile të marrë pjesë dhe revizorja e re që ka ardhur.

— Këtë punë do ta shikojmë dhe me shokët e tjerë. Tashti mund të shkosh, — i tha kryetari serioz.

— Më thatë se unë hidh kam mendime tutje e tëhu, nuk e kuptoj përse e keni fjalën, shoku Azis?

— Po të mendoheni do ta kuptoni, — i tha ai dhe ngriti dorezën e telefonit.

Nga përsëritja e inventarit doli që deficit i takonte kamerierit e jo kuzhinierit Aleko. U krijua një pështjellim, bile çeshtja do të përfundonte me grindje, por kryetar Azisi u gjend menjëherë në krye të situatës. Në sy të punonjësve të rosticerisë «Korani» e bëri për pesë lekë kamerierin e tij servil, kurse në fakt e tërë ajo zhurmë, ai nervozizëm i kryetarit u bë kupolë, për të mbuluar e për të lënë në heshtje çështjen.

«Është qerratuc kryetari ynë, mor bir, kam thënë unë, po kështu si e ka zënë, të shkurtër do ta ketë udhën», — thoshte pjatalarësja plakë e bar «Liqenit».

Kryetari buzëqesh e jep nderime në të gjitha anët. Ulet në tryezë, përsëriten porositë e ndërsa të tjerët zbërthejnë xhepat ai «gjallëron» tryezën me ndonjë shaka, ose vrenjt vetullat, picërron sytë dhe kalon në një episod të luftës:

«Na rrethoi një ditë gjermani... vetëm nga një anë mund të kaloje, por ama duhej t'i kacavirreshe një shkëmbi thikë. Ti kaçiator do të dalësh të lajmërosh shokët...», — më tha komandanti i batalionit. Me këtë rast Azisi përmend një emër pak a shumë të njohur.

Ndonjë naiv pranë tij mendon: «Ehu... ku i ka rrënjët kryetari ynë, vëlla, mos e prish me të». Kurse nënë Emineja që në atë çast ngrinte pjatat e bo-shatisura e pyet me thumb kryetarin:

— Pse vetëm një kaçiator kishte ai batalion, kryetar?

Mirëpo ai e kalon me shaka thumbin dhe vazhdon tregimin dramatik.

— Hajde gëzuar, shoku Azis, — ia pret shefi i cilësisë, i cili shpesh i qëndron afër kryetarit.

— Gëzuar, gëzuar, ka kujtime kryetari, vëlla, e jo si ne bylmezat, që e gjetëm shtruar, — hidhet një servil dhe dollia merr udhë.

Me biseda të tilla Azisi e ka vërtitur historinë e tij. Ata që e dëgjojnë nuk e dinë se ai ka dalë vetëm pesë ditë në kodër, atëherë kur liria kishte zbritur nga malet.

— Hajde, nderi juaj, shoku Azis, — i thotë kamerieri që i shkon pas ujërave dhe i mbush gotën me verë.

Kryetarit i janë skuqur sytë. Në faqet e fryra i janë shtuar një mori damarësh të kuq të hollë. Të duket sikur po të mbështetësh mbi ta gishtin me forcë, do të pëlcasë gjaku. E ndien që gjuha po i trashet dhe ngrihet nga ai lokal. Shkon te një tjetër. Pi një sifon më këmbë. Kalon në lokalin tjetër, për të parë si shkojnë punët. . . Herë pas here ankohet nga një dhimbje në zemër. «Më kanë porositur mjekët që të mos përdor dhjamëra dhe pije. Tashti kam vënë regjim, për ideal. Afër drekës ha një shafkaqe me një gotë dhallë», — thotë ai «me sinqeritet» kurse në buzët e shëndetshme i ndrit ende gjurma e ndonjë bër-xolle.

Ja kështu i përcjell ditët Azis Lamja. Lokalet i janë bërë gjysma e jetës, e shtëpia pak e mërzhitshme. . .

Ka aftësi të posaçme kryetari Azis, për të kaluar çdo pengesë që i del në jetë. Ka krijuar një rreth të ngrohtë. Ai e vlerëson me rrënjë efektin që bën te njerëzit që drejton. Prandaj shpesh thotë si me shaka (po dhe shaka në konfidencë): «Unë nuk jam me filozofët, të cilët ngulin këmbë se njeriun e drejton

truri. Jo! E kanë gabim! Në trupin e njeriut ka një hauz, që përzien dynjanë. Stomaku, burazer, stomaku. Përpara këtij hauzi përulet truri i vockël. Këtij i duhet bërë hyzmeti, që të jesh mirë për vete dhe për miqtë... fundja jeta është thurur si puna e zinxhirit. E ç'është zinxhiri? Hallka të lidhura ngushtë njëra me tjetrën», — thotë kryetari kur është çakërr-qejf.

Ndodhte që karshi kryetarit të bëheshin ankime e kritika. Një herë për pijen e tepëruar, një rast tjetër ngaqë në pije e sipër kishte fyer një banakiere. Dikush e akuzonte për ndonjë shkelje e padrejtësi. Jepnin e merrnin kritikën, mbledheshin e dukej sikur do të ndizeshin zjarr, por për çudi, bëheshin tym. Kryetari e kalonte lumin me «autokritikë të singertë». Mirëpo pikërisht kur në atë kohë Azisi kujtonte se gjërat shkisin si vaj, ndodhi një lëkundje e papritur.

Një pasdite në një mbledhje, një revizore, vajzë e re mjaft e shkathët, u ngrit e foli me guxim:

— Shoku Azis ka krijuar këtu me disa një familjaritet të sëmurë. Revizioni ka nxjerrë disa deficite të pashlyera... një pjesë e mirë janë mbuluar fare...

Kryetari kishte hedhur atë ditë nja tri a katër gota. Nuk e përmbajti dot veten dhe iu lëshua revizores:

— Sjell fakte për këto ti shoqe, apo flet në tym?...

— Posi? Ja një fakt: si u bë me 370 lekë deficit të kamerierit në rosticerinë «Korabi»? Në ç'kanal u futën? Por, mos më ndërprisni shoku Azis, për të gjitha faktet ka dokumente.

— Ia ke thënë këto gjëra kryetarit ti shoqe, apo i mbledh në bllok dhe tashti sulmon? — u hodh shefi i cilësisë nga rreshti i parë.

— Ia kam thënë, bile jo një herë, por ai më ka këshilluar të kem kujdes, të thellohem në natyrën e punës së tregtisë, të njoh njerëzit, «se dje kam zbritur nga universiteti», po më lini ju lutem të mbaroj fjalën. Kryetari është, siç thonë punëtorët «i qylit».

— Sii? Kjo pyetje e fuqishme çau sallën nga presidiumi i mbledhjes. Gjendja u ndez.

«— Hë më të lumtë, rini!»

«— Ç'thotë kjo mo, ku i dilet përpara kryetarit?»

«— Pa frikë ballin lart, thotë Partia, or shok!»

Mbi këto biseda u ngrit zëri i kryetarit të komitetit profesional që drejtonte mbledhjen:

— Qetësi shokë! Nuk na ka lezet kjo zhurmë, t'i marrim shtruar punët.

Shefi i cilësisë u hodh i papërmbajtur, sapo ra heshtja:

— Kjo, shokë, kështu sillet me të gjithë. Edhe në punë nuk është e rregullt. Kushedi sa herë ka munguar, po, shokët e kryesisë e kanë bërë zemrën të gjerë, për këtë unë e kritikoj ashpër shokun Azis. Dhe hiç të mos i vijë rëndë. Por jo kështu, shokë. Na ngrihet këtu një çupërlinë e na godet një shok me përvojë. Ndërgjegjen e shokut Azis e ka njohur tjetërkush, qysh në atë kohë kur pëlciste pushka e ai iu ngjit malit.

— Lëre, më qafsh atë kalendar, o shef. Ktheje atë fletë. Atëherë i janë ngjitur malit mijëra, që sot i kanë mbuluar thinjat e rrudhat e punës. Pa le, mijërat që dhanë edhe jetën dhe nuk i kërkuan asnjë shpërblim atdheut. Ata, edhe unë e ti të duam t'i harrojmë, nuk i harron historia. Koha jonë kërkon që ta heqim kapelën përpara atyre, të cilët nuk janë ndarë asnjë çast nga lufta. K. ore vesh ti, byrazer? Ulu

më qafsh, e mos ia hiq petët byrekut, — ia priti kuzhinieri i rosticerisë «Korani».

— Ashtu de... posi... çdo kupë kur mbushet pa karar, do të derdhet, — tha një banakiere dhe u ngrit të merrte fjalën. Por kryetari u ngrit si i xhindosur dhe briti:

— Pushoni, ç'është ky pazar këtu? Ç'janë këto? Pa të shohim kush i ka kurdisur? Këto janë me qëllim të caktuar. Këtu ka gisht armiku. . .

Fjalët e tij u pasuan nga një heshtje e shkur-tër. Pastaj zjeu një zhurmë e brendshme. Dikush qe-shi me zë. Kryetari u përpoq të kapej pas zinxhirit të jetës, por ai ishte këputur keqas. Dashamirësit e tij, që i kishin përkëdhelur veset, po humbisnin në masën e ndezur nga kritika. Bile ndonjëri prej tyre gjeti rastin dhe doli nga salla.

— Shoku Azis nuk duhet t'u bëjë presion nje-rëzve. Secili të flasë ashtu siç i ka parë punët. Shoqja revizore të vazhdojë diskutimin, — tha kuzhinieri i rosticerisë «Korani» dhe u ul.

— Të vazhdojmë shokë, — u ngritën zëra.

Diskutimet u ndezën. Kryetari po fshinte djer-sët me një shami të madhe të shpalosur. Ai mund të besonte se hëna në qiell kishte marrë flakë, por kur-rë nuk i kishte shkuar ndër mend se miqtë e tij një ditë mund ta linin në baltë. Mbeti ngushtë.

Pasi doli nga mbledhja shkoi e kërkoi pak ngu-shëllim te rakia. Zuri një qoshe dhe piu deri vonë. Piu shumë.

Kur e ndjeu se po e linin këmbët u ngrit e mori përpjetë rrugicës që e çonte në shtëpi. Ndalonte një çast, mblidhte forcat, përqëndrohej dhe nisej me hap më të sigurt. Në veshë e goditi një zë gruaje: «Shoku Azis është edhe i qylit». Psh, ç'zë i hidhur iu duk ai!

Në mjegullën e rakisë iu shfaq fytyra e revizores së guximshme dhe u bë gati esëll. Në atë çast ndjeu se veç pijes e pengonte dhe trupi i tij i rëndë. Mjeku e kishte këshilluar të hante sa më lehtë e në mënyrë të veçantë, të mos e përdorte mishin e pjekur dhe pijet. Këto këshilla iu kujtuan kryetar Azisit dhe nxitoi hapat. «Nuk mjaftonte ky i shkretë, dhjamë, po na tashti, më del dhe boja» — mërmëriti me vete dhe mblodhi të gjitha forcat për t'u mbajtur deri në shtëpi... Për herë të parë ai ndjeu me dhimbje të thellë se zinxhiri i jetës, i lidhur me aq marifete, ishte këputur në shumë vende...

NJË NATË TE DAJOJA IM

Në katërbëdhjetë shtator dajoja im Shaqo Bredhi mbushi tridhjetëvjetorin e qytetarisë në Tiranë. Së bashku me të jeton e shoqja, e bija e ndarë nga i shoqi me një vajzë gjashtëvjeçare dhe i biri student në vitin e tretë të inxhinierisë. Më të rrallë dajoja ngjitet në fshatin e lindjes. I biri vjen gati çdo verë, kurse e shoqja dhe e bija nuk e kanë marrë ndonjëherë mundimin... Herën e fundit që dajoja erdhi në fshat më pat hequr vërejtjen pasi kisha dy-tre vjet që s'isha dukur nga Tirana. Kështu që një ditë dola në xhade pranë fshatit, i hipa një makine dhe mora udhën për në kryeqytet.

Në shtëpinë e dajos gjeta të shogën. Pasi u përshëndosha me të, lashë mbi tryezë një çokollatë për mbesën e vogël dhe u ula në një divan të mbuluar me një mushama të hollë celofani.

— Ke ardhur me ndonjë shërbim kështu? — më pyeti gruaja e dajos ftohtë. Mua m'u duk sikur më tha: «Mirë që erdhe, por mos ke ndër mend të rrish gjë sonte?

— Jo! Erdha një herë t'ju shihja... më pat hequr vërejtjen dajoja, — i thashë.

— Ashtu?... Mirë e paske bërë, — më tha dhe

shikimin e hodhi te këpucët e mia, që shkelnin mbi një qilim të trashë.

«O dreq, mos duheshin hequr këpucët te dera», — mendova, por prapë e qetësova veten me mendimin se një veprim i tillë gruas qytetare të dajos mund t'i dukej tepër allaturka. . .

Ajo, pasi i hoqi një fshesë qilimit, hapi një sirtar të komosë dhe më zgjati një karamele në një tabaka të bukur kristali. Për dreq, unë karamelet nuk i vë në gojë, por e mora nga zori. Pas karameles ra heshtja. Unë rrija dhe shikoja i çuditur dhomën e mbytur në xhinga.

Në bufenë e madhe me pasqyra ishin përzier katër komplete filxhanësh, katër pijesh e katër uji. Nëpër to kishte lloj-lloj vazosh të sajuaara prej balte të lustruar e prej qelqi, kukulla e lule artificiale. Sipër bufesë ishte një krokodil, një lokomotivë treni, një tank, një aeroplan e një ari, i cili trazonte me një rën këmbë, me sa dukej, një qyp me mjaltë. Ai më kujtoi të hapja çantën që kisha me vete dhe t'i jepja gruas së dajos një shishe mjaltë, që e kisha sjellë peshqesh nga fshati.

— Ç'e doje! . . . Pse jeni harxhuar? — tha ajo. E mori shishen dhe e futi në raftin e një komodine dykatëshe e cila ndodhej në qoshen e dhomës. Mbi atë komodinë rimesoje rrinte shtrirë një qen i larmë prej allçiu me një zinxhir të verdhë në qafë. Në një raft rrinin të qetë, të rinj, si të hekurosur, të pazënë me dorë një radhë librash. Pas shpatullave të mia, në prevazin e divanit, ishte një vazo e madhe me lule artificiale, një veturë e verdhë mbi të cilën ngrihej qafa e gjatë e një gjirafe. Nëpër mure vareshin piktura (natyra të qeta, të shqetësuar). Në qoshen tjetër të dhomës, përballë kolltukëve ishte një tryezë televizio-

ri. Nuk di pse ndjeva një përzierje, m'u zu fryma, zgjata dorën dhe hapa dritaren. Duke mos duruar dot heshtjen pyeta gruan e dajos:

— Ju paska pësuar ndonjë difekt televizori?

— Jo. Nuk e kemi marrë akoma. Morëm tavolinën. Vendosëm dhe antenën.

— E pse kështu? — pyeta i habitur.

— Epo... ja... të jenë gati. Shaqoja ka rregulluar me anën e një miku një autorizim për mot... mund ta rregullonte edhe për sivjet, por ishim ngushtë, nuk i dilet jetës në qytet. Ndryshe ju atje në fshat...

«Eja e duro, o njeri i urtë, me këta tipa! Për të kënaqur ambicien ndaj të tjerëve, janë bërë robër të opinioneve! E kanë gjetur ilaçin: për ata që vijnë brenda në shtëpi është dëshmitare tryeza, kurse për të tjerët që shkojnë rrugës dhe hedhin sytë mbi shtëpinë e Shaqo Bredhit është dëshmitare antena, pra «Shaqoja e ka marrë televizorin». Eh ç'kënaqësi, o shokë!!! Vetëm xhinglat e panevojshme nëpër shtëpi bënin mijëra lekë, kurse gruaja e dajos, me atë fytyrë të mprehtë e të zbehtë thoshte: «nuk i dilet jetës!». Ndërkohë u hap dera rrëmbyer dhe në korridor u gjend duke përplasur këmbët mbesa gjashtëvjeçare. Pas saj u fut e ëma, ime kushërirë. Kisha gati tre vjet pa u parë me të.

— Oh... na paska ardhur kushëriri! — tha dhe më zgjati një dorë të ftohtë me thonj të gjatë.

— Si është halla?... Qyqja, që kur s'e kam pa!

Te këmbët e saj, të shtrënguara nga një fund i ngushtë, po çirrej e bija gjashtëvjeçare.

— Hajde një çikë te daja, — i thashë mbesës dhe zgjata duart drejt saj. Ajo shtrembëroi buzët si mac-kë. Kur i zgjata çokollatën, e rrëmbeu dhe pasi e çmbështolli me padurim, nisi të lerosej vesh më vesh.

Katër a pesë ngjyra kishin rrobat e vajzës së vogël.

— Qyqja... të rëntë pika! Si u bëre kështu tërë çokollatë!... Ububu si lëpohet, sikur nuk ka parë gjë me sy. Sille këtu, — i tha së bijës dhe ia rrëmbeu çokollatën nga dora. Vajza ia dha të qarit si mjauhimë.

— Oj, pse kështu sillen vajzat e kulturuar? — i thoshte kushërira vajzës që çirrej.

Më në fund, erdhi dhe dajoja. Hoqi borsalinon në korridor, u takua me mua dhe u lëshua rënduar në kolltuk.

— Ku ishe kështu, ti shoku burrë? — i tha e shoqja me shqetësim të shtirur.

— Ishim në një mbledhje, po ç'kemi andej lart nga fshati? Paskë dalë një herë? Mirë ke bërë, — më tha mua si të ishim takuar dje.

Vajza e vogël rrëzoi nga tryeza një gotë dhe e theu.

— E kemi keq me edukimin e kësaj vajze... është xhibër për ideal, — tha dajoja i shqetësuar.

— Do t'ia pres kokën fare. Ka marrë huqet dhe turinjtë e të atit, s'ka hiç më ne, — tha ime kushërirë, megjithëqë e bija nuk i kishte lënë gjë mangut së ëmës.

Po rrija si në gjemba. Gjeta rastin dhe u dhashë të kuptonin se pasi të çmalloheshim, do të shkoja në hotel. Vendin e kisha porositur. Pas kësaj sikur u gjallërua disi gjendja. Çudi e madhe! Asnjëherë nuk ka ndodhur, që ata të vijnë te ne dhe të mendohet se u dashka hotel. Megjithëqë edhe hoteli i vogël i fshatit tonë, i ka nja gjashtë a shtatë shtretër të pastër. Nejsel!. Shtuan darkën. Përpara secilit u vu një pjatë porcelani, e hollë, e bukur, me tarator. Pranë pjatave ishte një pecetë e qëndisur, mbi të luga, thika dhe piruni. Në mes të tryezës ishte vendosur një

pjatë me djathë e për hatrin e mikut, edhe nga një kokërr pjeshkë.

— Nipçe! bujrem me këto që kemi. Mirë se na erdhe, — tha dajoja në mënyrë ceremoniale.

— Për të mira, dajo, — i thashë. Sytë i hodha përballë mbi frigoriferin dhe lavatriçen që shkëlqenin në korridorin hijerëndë.

Dajoja nisi të më shpjegonte, bile shkencërisht, se taratori të sillte një dynja të mira.

— Na është bërë edukatë. Në darkë hamë shumë lehtë dhe edukata është vështirë të ndryshohet. Në dimër pimë nga një gotë çaj dhe biem në gjumë pendë të lehtë, — tha dajoja.

— Zaten, kështu bëjnë njerëzit e kulturuar nëpër botë, — tha e bija e krekosur.

Çudi! Tjetër dajo kisha njohur sa herë vinte në fshat, e tjetër po më shikonin sytë këtë natë.

— Interessant! Qenka qamet i lartë ky taratori, dajo! Edhe ne e përdorim për oreks, — i thashë. Ai e kuptoi thumbin dhe tha me indiferencë:

— Epo... fshat e zanat derë e tabiat, — harroi kështu edhe fshatin e lindjes dajo Shaqoja.

— Ashtu është dajo, si të edukohet njeriu, — i thashë duke e ditur se vërejtjet priten më mirë nga shoku sesa nga njeriu yt.

Pas darkës biseda po rrokullisej me zor. Kur kushërira kujtoi televizorin, biseda e tyre u gjallërua. U fol për markën «Iliria», «Adriatik», «Fonola», e «Telefunken». U fol për këndin ku do të vendosej televizori, për programin e filmave me shumë seri që priteshin të shfaqeshin. Kushërira ime do t'i bënte ekranit një ngjyrosje artificiale. Një shoku i saj sportist do t'i sillte nga jashtë një letër speciale me ngjyra. Kështu që televizori i dajo Shaqos, në atë pallat,

në atë bllok, në atë lagje e ndoshta në gjithë Tiranën do të ishte i pari me ngjyra. «Eh... ç'familje e lumtur!!» — mendova me keqardhje.

Gruaja e dajos po lante pjatat, kurse e bija trokiste me gishtërinjtë ritmin e një kënge që transmetonte radioja.

Ndërkohë u hap dera dhe erdhi im kushëri. Sapo u fut te dera e kuzhinës, lëshoi mbi një karrige çantën dhe m'u hodh në qafë.

— Si jeni andej?... Si është halla, xha Demoja? Ç'bën? Si duken punët në kooperativë? — më pyeti ai plot interes dhe mall.

Nisa të ndihem ngrohtë. Çiltërsia e kushëririt student më gjallëroi. Pasi këmbuem disa pyetje, ai u fut në aneksin e kuzhinës për të larë duart.

— Po nga Begajt si janë? — pyeta dajon për kushërinjtë e parë, të cilët banonin përtej Lanës.

— Poo... mirë do të jenë. Nuk para i takoj.

Megjithëqë Lana nuk ka lëvizje lundrimi, dhe s'paraqet vështirësi për t'u kaluar, pyeta disi i habitur:

— Pse, nuk këni marrëdhënie me ta?

— Jo, mo, marrëdhëniet ekzistojnë poo... ja shikohemi nëpër autobusë. Mirë janë.

Pa mbaruar fjalën ai, ndërhyri kushërira:

— S'ka ndonjë çudi këtu. Sekush në shtëpinë e vet, jeta ecën. Ju andej nga fshati i ruani shumë lidhjet e vajtje-ardhjet. Bile këto zakone i ndjekin edhe në disa qytete të vegjël... Kjo ka të bëjë me kulturën e njerëzve... ne i kemi këto zakone. Në Evropë banojnë komshinjtë përballë dhjetë vjet dhe nuk i dinë as emrin njëri-tjetrit.

Pa mbaruar ajo fjalën, i vëllai doli nga perdja e aneksit.

— Ha, ha, — lum ti për këtë mendje që ke, — i tha së motrës dhe pasi u ul pranë meje shtoi:

— E dëgjon, mo kusho, se ç'horizont ka ime motër? Ia di një për një huqet Evropës, pa ç'ka që nuk ka parë akoma as Krujën. Në qoftë se kultura do të shërbente për të zhveshur njeriun nga vetitë njerëzore, as nami të mos i mbetet.

— Ty nuk të foli njeri! Rrëmbe pjatën aty dhe ha bukë, — ia ktheu e motra me nervozizëm.

— Oh... më fal se nuk u solla si evropian.

— Babi, do t'i flasësh këtij apo...

— Mjaft tashti se s'kemi qejfin tuaj... Ç'është me ju! Gjithnjë, njëri gozhdës tjetri potkoit, — tha dajoja dhe nisi të shfletonte gazetën.

— S'ke faj ti, fajin e kam unë, që nuk jam ngritur ndonjëherë në mbledhjen e banorëve të bllokut të ta tregoj se nga bie Evropa.

— Të kam thënë se me mua nuk të duhet gjë, — ia ktheu e motra.

— Mirë, po flasim, — i tha ai me inat dhe u ul të hante bukë. Në fytyrën e tij lexohej zemërimi. Pas një copë here unë u ngrita dhe dola. Kushëriri më përcolli deri në fund të shkallëve.

— Erdhët te dajoja dhe u kënaqët! — më tha me keqardhje pa ma lëshuar dorën.

— Epo, valle s'do të kërcenim, ja erdha dhe ju pashë.

— E di! E di! Kur vijmë ne në fshat...

— Epo secili bën të tijën, ne fshatarët i ruajmë më shumë zakonet, siç tha jot motër. Megjithëkëtë ti duhet të krasitësh plot gjëra në natyrën e Lidës, bile dhe në të prindërve, — i thashë unë, sikur të ishte fjala për krasitjen e ullinjve në fshat.

— Mirë u pafshim, më tha ai dhe ngjiti shkallët i menduar.

Pas ndonjë viti dajoja erdhi i malluar në fshat. Mendova të mos ia prishja edukatën e qytetit dajos, ta prisja ashtu lehtë e thjeshtë, por nëna me gruan nuk më lanë. Kështu që dola vetë nga dyqanet dhe u përgatita.

Në darkë gruaja shtroi tryezën. Përpara dajos zuri vend një pjatë me domate të grira bukur, speca të fërguar, patate, një copë djathë dhe një pjatë pilaf me gjoksin e pulës kaluar. Për nënën dhe gruan kisha marrë një shishe verë, kurse unë dhe dajoja vumë në mes një gjysmë litroshe raki rrushi. Dajoja pasi shikoi një çast si me bezdi mezet e bollshme, lëvizti nofullat, përpoqi buzët dhe ngriti gotën:

— Gëzuar, dasmë e gëzime, kështu e paçi gjithë jetën!

— Të paça, o dajo, — i thashë.

Ashtu ngadalë — ngadalë me gotën e rakisë në buzë, dajoja i përcolli paq, të gjitha ato që kishin zënë tryezën.

M'u bë qejfi që stomaku i dajos nuk ishte çfisëruar. Madje ai gjatë gjithë kohës ishte çakërrqejf. Na foli për shumë gjëra atë natë. Na foli për kuzhinën orientale, për kontradiktat në Tregun e Përbashkët, për fakirët indianë dhe për krizën në Lindjen e Mesme. Hapi dhe mbylli biseda vetë dajoja atë natë. Në sytë e nënës, unë lexoja një farë krenarie për vëllanë e saj aq të ditur, kurse unë sillja parasysh kujtimet e një viti më parë dhe përpiqesha të gjeja portretin e vërtetë të dajos, por e pata të vështirë, pasi ai, megjithëqë foli atë natë aq shumë, nuk u kujtua për vlerat e larta të taratorit.

Në mëngjes dajoja u ngrit i lehtë dhe më tha se kishte bërë një gjumë të ëmbël, të thellë.

Meqë ka qëlluar të vij një çikë kokëkrisur në këtë dynja, lëshova përpara dajos e në sy të nënës këto fjalë të guximshme:

— Shyqyr dajo! Mua s'më ka zënë gjumi mbrëmë!

— E pse kështu, — pyeti ai me habi.

— Nuk më linte të qetë mendimi se, e rëndova dajon i cili është edukuar të hajë lehtë në darkë.

Ai bëri «hëm» dhe pasi u vrenjt shtoi: — paske nisur të bëhesh shakaxhi, o nipçe. Nëna e përzjeu bisedën dhe fshehtazi më tërhoqi për mënge.

Ka gati dy vjet që dajoja s'na ka ardhur më, ndërsa i biri vjen çdo verë dhe vazhdimisht na vë në dukje ndryshimet që po ndodhin në familjen e tij pas mbledhjes së bllokut me temën «Sjelljet dhe konceptet e disa njerëzve tanë».

MERO MARDHAJA

Në ndërtesën tonë të re, Mero Mardhaja erdhi i parafundit. Ata që u ndodhën në shtëpi e ndihmuan banorin e ri për të ngjitur plaçkat në katin e katërt. Ne mësuam emrat e çiftit Mardhaja, ndërsa Meroja u interesua veçanërisht për punën dhe detyrën e secilit banor të shkallës sonë, bile edhe për ata të shkallës tjetër. Me sa dukej, atij i interesonte pulsi kulturor i banesës së re. Meqë ai erdhi në hyrjen përballë meje, m'u desh ta ndihmoja deri në fund.

— Oh... do t'ju jemi shumë mirënjohës... qenkeni njeri i mirë. Na bëtë borxhlinj... Eh, ç'komshillëk do të kemi. Po ç'punë bëni? — më tha kur po dilja nga hyrja e tij.

— Kaldaist jam.

— Ashtu? Interessant, më patën thënë se komshiun përballë e kisha dentist, — tha dhe për çudi në fytyrë iu shua entuziazmi.

— Për fat të keq jo, — i thashë dhe sytë më shkuan te dhëmbët e tij gjysmë të veshur me metal.

— Gjene edhe më mirë... klasë punëtore. Ore jeni njëqind herë më mirë ju për nder të familjes. Lëre, na plasi koka ne me përgjegjësi. Edhe natën në ëndërr më faniten dosje, hyrje-dalje, kuadrime, miliona lekë. Jeni bukuri, ore, dëgjo mua, — nguli këm-

bë sikur unë të isha ankuar për zanatin tim, apo të kisha mohuar zahmetin e atyre që bukën e nxjerrin me kalem. — Shyqyr që ndërrova shtëpinë. E kisha pranë ndërmarrjes, më mbytën atje... kushedi sa herë më vinte vetë drejtori e më thërriste që poshtë.

— Epo detyrat kështu e kanë, — i thashë dhe u ndava prej tij.

Ardhjen e një drejtori në hyrjen e fundit në katin e dytë e mësoi i pari Mero Mardhaja dhe e përhapoi nëpër banorët e shkallës. Ne që u ndodhëm aty e ndihmuam sipas zakonisht edhe banorin e fundit. Meroja atë ditë i çuditi të gjithë. Ngjiste e zbriste shkallët ujë në djersë. Punoi aq shumë sa dhe i porsardhuri mbeti ngushtë.

— Ç'të bëjmë! Duhet ndihmuar shoqëria, more! Paska goxha plaçka. Helbete, kuadër i biri i botës dhe në ç'ndërmarrje se! — thoshte ai i djersitur.

Meroja ishte i fundit që u largua nga banesa e drejtorit, i cili e falenderoi në mënyrë të veçantë.

— Më vjen keq... na fyeni. Ç'është nevoja... por njeriu për njerinë... po s'deshëm e po s'e ndihmuam njëri-tjetrin ç'na mbeti! — ia ktheu ai me përzemërsi të shtirë.

Prej asaj dite Meroja nuk linte rast pa përdorur për t'u afruar sa më shumë me drejtorin. Në mbledhjet e shkallës apo të bllokut ai ngrihej menjëherë pas Qemalit dhe përkrahte diskutimin e tij. Një ditë e teproi aq shumë sa që drejtori i tërhoqi vëmendjen kurse një banor i shkallës sonë, shofer, i tha Meros pas veshit:

— Kur e paskemi zgjedhur drejtor të shkallës Qemalin?

— Ti quaje si të të pëlqejë e mos fut hundët në punët e të tjerëve, — tha i nervozuar Meroja.

Ditët rrokulliseshin pas ligjit të tyre të vjetër. Mero Mardhaja ruante rastin, sa futej drejtori në shkallë ai zbriste si «rastësisht» e i dilte përpara. I shtrëngonte dorën me shumë respekt, e pyeste për shëndetin e tij e të gruas, të vajzës, bile edhe për hallët e ndërmarrjes e ndahej me të, duke i uruar gjithë mbarësitë e kësaj bote. Me merak të madh priste ai një shkak gëzimi për të vajtur si burrat në shtëpinë e drejtorit. Një ditë i zuri veshi se drejtor Qemali mbushte dyzet e dy vjeç dhe ai s'priti më, por një mbrëmje u gjet në derën e tij. Shkeli sustën e ziles dhe u fut shend e verë në korridor. Pastaj hyri e shoqja e shkurtër dhe e shëndoshë. Në duar, për habinë e të gjithëve, mbante një tortë të rëndë të mbështjellë me një letër të hollë të bardhë.

— Ç'është kjo, ju lutem?! Ç'ne ky harxhim?!... nisi të fliste Qemal Kranea, por mysafiri ia preu fjalën me dashamirësi të rrallë:

— Më vjen keq, shoku Qemal... e ç'janë cikërrimat përpara njeriut... rregullave. Epo, fundja, këtu njëri-tjetrin kemi. Të bëhet njëqind e dy vjet, e lart e më lart për hir të ndërmarrjes dhe të shoqërisë, shoku Qemal... Lëri dhuratat, pash nderin punë grash, më hëngri shpirtin gruaja: T'u vemi, që t'u vemi... Ha-ha-ha.

Mero Mardhaja jepte e merrte duke prekur të gjithë telat e njeriut për t'i shkundur drejtorit habinë e asaj dhurate të papritur. Qemalit vetë as i kishte vajtur ndër mend ta festonte dyzet e dy vjetorin e lindjes.

Një ditë në shkallë e pyeta:

— Ç'kemi, shoku Mero?

— Qetësi. Ja, isha një vizitë te shoku Qemal, vajta për dy minuta, por do ti, ku të lënë ata të dalësh?

Ja edhe një gotë, shoku Mero, ja dhe këtë, dhe atë. More ç'të them! Janë shpirt njeriu. Ka kulturë tjetri. S'i thonë shaka, kuadër i lindur.

— Epo, njeriu i mirë i bën vend vetes, — qesha unë, por ai s'e vuri re e vazhdoi të ngrinte në qiell banorin e katit të dytë, që porsa kishte ardhur.

S'vonoi shumë dhe një ditë në zyrën e drejtor Qemalit u fut një i panjohur:

— Ju urojmë shëndet, shoku drejtor! — tha ai dhe i zgjati përpara një letër. Drejtori e hapi me mëdyshe dhe e lexoi me vetulla të rrudhura. Mero Mardhaja, pasi e përqafonte si vëlla, i lutej që letërprurësin (vëllanë e gruas së tij) ta rregullonte në ndonjë punë pa shumë zahmet e me një turn.

Hëm... e filloi lojën miku, — mendoi me nervozizëm Qemali dhe iu përgjigj letërprurësit:

— Nuk kemi vende bosh në ndërmarrje... pastaj për të lëvizur nga një ndërmarrje në një tjetër ka rregulla që s'varen nga unë. Ju i dini këto, apo jo? — i tha atij që priste si dru në këmbë.

— Sidoqoftë, shoku drejtor, ju e keni mundësinë. Meroja më tha se ju për atë...

— Jo, jo, unë s'kam asnjë të drejtë të veproj jashtë rregullave.

Të nesërmen e shoqja e Meros e zuri drejtorin duke ngjitur shkallët, por edhe kjo nuk solli ndonjë dobi.

Që nga ajo ditë Meroja me të shoqen nuk e shikonin dot banorin e katit të dytë. Nëpër banorë të shkallës nisën të dalin ankesat e tyre për drejtorin dhe familjen e tij. «Janë mosmirënjohës ... u mungon respekti... kultura! Ëne për ta...»

Këto fjalë i vajtën në vesh Qemalit dhe e hidhëruan shumë. Një pasdite u kthye në shtëpi me një

tepsi me kadaif në duar.

— Ç'a bërë vaki, more burrë! Ç'e ke këtë? —
e pyeti e shoqja e habitur.

— Eja se do shkojmë për një vizitë.

— Ku kështu?! Kush martohet?!

— Lart, te Mero Mardhaja.

— Ç'thua kështu... Kë marton komshiu ynë?

— Ka lyer shtëpinë sot.

— More, me gjithë mend e ke ti?!

— Eja, moj, se nuk kam nge të dëgjoj llafet e të pres në zyrë të «deleguarit» e Meros unë.

Deshi s'deshi, gruaja u ngjiti lart me të shoqin. Çifti Mardhaja shtangu një çast. Qemali u hodhi një sy mureve të lyer sipas modës, me ngjyra të ndryshme, dhe uroi:

— Gëzuar e të lyeni çdo vit e më bukur.

Me gjithë përpjekjet e Meros për ta bërë sa më të natyrshme këtë vizitë, qëllimi i saj real përplasej në muret e lyer taze dhe lëshonte hije mbi njerëzit...

Prej asaj dite Mero Mardhaja shmang çdo rast për ta takuar drejtorin në shkallë. Bile kohët e fundit ka dalë fjala sikur shoku Mero kërkon të ndërrojë shtëpinë. Me sa duket po e ndien gjithnjë e më shumë veten të huaj në këtë ambient.

NË KTHESËN E VOGËL TË JETËS

Akrepat po i afroheshin orës dymbëdhjetë të natës. Isha mbështetur në divan dhe kisha humbur mendjen në faqet e një libri. Katër fëmijët bënë gjumin e parë në dhomën përbri. Gruaja kishte katër ditë që mungonte, pasi pat shkuar si aksioniste në ndihmë të fshatrave në rreth. Nga bota e librit më nxori befasi një e trokitur e fortë në derë. Kush të jetë në këtë orë? Trokitja që e sigurt si të që dorë e të zotit të shtëpisë. Të jetë gruaja? Po pse në mes të natës? Mos i ka ndodhur ndonjë fatkeqësi? Apo do të jetë ndonjë mik i mbetur jashtë? Me këto mendime të shqetësuara u gjenda te dera. E hapa. Përpara më doli një burrë i gjatë, thatim, me një çantë meshini të varur në sup dhe me një kashtë në kokë.

— Posta shok, — ma pat menjëherë përpara fytyrës. — Firmos këtu, të lutem, — vazhdoi duke më zgjatur një telegram urgjent.

Pamja e tij e zyrtë, më bëri të mendoja se do të më kishte bërë vaki ndonjë gjë dhe ai sillej sipas rastit për të marrë pjesë në hidhërimin tim. Nuk di pse u hutova aq shumë dhe veprova si mekanizëm. Firmosa menjëherë. Postjери sapa

mori firmën zbriti shkallët. Në kthesën e parë të katit ktheu kokën dhe më tha:

— Kurajë... jeta i ka këto.

— More, po ç'ka ndodhur? — thashë pa vendosur ende të hapja telegramin, por postieri zbriti në kthesën e katit tjetër. — Bobo gruaja... do t'i ketë ndodhur gjë, — mendova hidhur dhe zemra m'u drodh për veten dhe për të katër fëmijët. U futa në korridor dhe me duar të dridhura hapa telegramin:

«Poloja ra. Të presim sa më parë. Lefkotheja». Lexova dhe mblodha disi veten. Gruaja nuk pas-kësh pësuar gjë, po i shkreti Polo, ç'ka pasur? Humbja nuk ishte e vogël. Polo Brinja, baxhanaku im, dyzet e pesë vjeç, në moshën më të mirë paska rënë?! Me siguri ka rënë ndokund me makinën e zyrës. Medet, — mendova me keqardhje. Një lëmsh hidhërimi ma ngushtoi frymëmarrjen. Pashë dhe një herë shenjën urgjente të telegramit dhe mbeta si dru i tharë në korridor. Ç'të bëj? Të nisem që tashti? Po ku gjen makinë në mes të natës. Shkova dhe u lëshova mbi divan. Ndeza një cigare dhe mblodha pak veten. Gjumi m'u degdis. Ashtu me cigare i kalova dy-tri orë. Pa rënë drita ngrita djalin e madh dhe e porosita të kishte kujdes fëmijët e tjerë dhe shtëpinë.

— Ku do të shkosh me kaq ngut, ti babi? — më pyeti ai me fytyrë të përgjumur e të merakosur.

— Po nisem me një shërbim urgjent, xhani i babit. — Kështu thuaji edhe mamit, në qoftë se vjen përpara meje. Do të kthehem shpejt. Dola me nxitim te agjencia. Pas ndonjë ore i hipa një «Zuku» dhe u nisa për në Vlorë. Shoferi qëlloi muhabetçi, babaxhan dhe ma lehtësoi disi mërzinë.

Bile, kur u futëm në unazën e qytetit, kaloi andej nga më binte më afër shtëpia e baxhanakut.

Me hapa të nxituar u gjenda pranë shtëpisë së tij. Qëndrova një çast pranë gardhit të oborrit. Për habinë time mbretëronte heshtja. Poshtë pjergullës që mbulonte gjysmën e oborrit të shtëpisë njëkateshe, ishin nderë rroba nëpër tela. Në mes tyre ishin një palë çorape dhe një këmishë e të ziut Polo.

E po kjo punë, xhanëm! Ç'do me thënë? Të ketë rënë me makinë një njeri me aq shoqëri e rreth të gjerë, drejtor prej disa vjetësh e të mos ketë lëvizje dhe shqetësim pas dy ditësh? — mendova duke shtyrë portën metalike të oborrit. I rashë ziles dhe shtyva portën e shtëpisë pa prituri të më përgjigjej njeri. Në korridor më doli përballë ime kunatë, e shëndetshme, e fortë, por e menduar, e vrenjtur. M'u hodh në qafë dhe mërmëriti:

— Qyqja ç'na gjeti, Sofo vëllai!

E ngula shikimin në sytë blu të kunatës, po atje nuk kishte lot. Edhe në rroba nuk kishte shenja zie. Bile për habinë time, ajo kishte veshur atë ditë një fustan me lule të ndezura.

— Moj, po ç'bëhet këtu, xhanëm? Ç'ju ka gjetur? Ku ra Poloja? — e pyeta rrëmbyer.

— Mos na pyet, — më tha ajo duke më bërë me shenjë për në kuzhinë.

— Fol moj Lefko, de, si është puna? Ç'i ndodhi Polos? Ku ra? Me makinë apo...

— Me ç'makinë more? — ma priti ajo me fytyrë të shtrembëruar.

— Po kështu më shkruaje në telegram: «Poloja ra».

— Qyqja! Ku të paska shkuar mendja!.. Keni zënë ngrohtë për vete atje në Tiranë dhe dashkeni

që të rrokulliset tjetri me makinë, që ta quani rënie e t'i qani hallin.

— Për kokë të fëmijëve, moj kumatë nuk po të marr vesh, më thuaj ç'i ka ndodhur Polos?

— Ra nga drejtor dhe e kanë shpënë në filifistun.

— Ku moj? — pyeta tepër i habitur nga ky emër i huaj, i padëgjuar.

— E hoqën nga drejtor... e hoqi kolektivi... thënë... Dhe e kanë shpënë llogaritar në kooperativën e Gështenjasit... katër orë larg me këmbë.

Tronditja që kisha përballuar dhjetë orë rresht m'u kthye në gaz.

— E për këtë ma shkrove atë telegram të mallkuar që më solli deri këtu dhe shtëpinë e lashë në alarm? Pse qameti u bë, se ra nga posti njëzetvjeçar i drejtorit shoku Polo? Po pse me tapi e kishte marrë drejtorllëkun Poloja yt, moj? Ç'janë këto moj kumatë, më qafsh! Ajo më shikonte e nervozuar. Nga kuzhina dëgjova të qeshura. E lashë kumatën pas vetes në korridor dhe hapa derën e kuzhinës. Vajza e djali i baxhanakut u ngritën menjëherë, mu hodhën në qafë dhe më mbytën me pyetje për tezen dhe kushërinjtë e tyre në Tiranë. Pritja dhe humori i tyre ma shkundi lodhjen.

— Hë? Pse po qeshni kaq me të madhe? — i pyeta.

— Po më tregonte Vera qyfyre nga aksioni i Lukovës. Përpara dhjetë ditësh u kthye, punoi atje gati dy muaj.

Gazi i tyre u shtua dhe më tepër kur u tregova keqkuptimin e telegramit.

— Ju qeshni, po unë që bëra gjithë këtë udhë; dhe këtu në shtëpi s'po kuptoj se ç'bëhet: ca qajnë,

ea qeshin, — u thashë dhe u tregova për bisedën me nënën e tyre.

— Tashti është qetësuar ca, — tha vajza, — po të ishe një javë më përpara do të të dukej sikur kishte rënë tërmet vetëm në oborin tonë. Fundja me kontratë nuk e kishte marrë pozitën babi, punoi sa mundi këtu, tashti e kanë shpënë llogaritar në një kooperativë të tipit të lartë, bukuri. Punë të ketë, jeta nuk ndërtohet vetëm në qytet e njeriu nuk ka vlerë vetëm kur ka pozitë. Këto i themi mamit, por ajo ashtu merr si flaka e kash-tës. I përcjellë nga fëmijët e gëzuar të baxhanakut i urova shëndet kumatës, dola nga shtëpia dhe u nisa me makinën e parë, me merak se mos gruaja ishte kthyer në shtëpi dhe do të ishte alarmuar.

SHQETËSIMET E NJË UDHËTIMI

Fjalët për udhëtimin tim në vendet e Lindjes dolën që në çastin kur mendimi i dikasterit u bë vendim. Për çudi, gati për natë në shtëpinë time kishte vizitorë, për të cilët përveç bisedave të ngrohta (pavarësisht në ishim në qejf unë e grua-ja, ose jo) duheshin edhe kafe, liker, karamеле e të tjerë artikuj që përdoren në kësi rastesh.

Gjatë një jave unë vura re se të ndjerët, pleq-të e mi, paskëshin pasur goxha farefis. U njoha dhe u çmallova me halla, teze e kushërinj, deri në kushërinj të kategorisë së katërt. Pyetja: «Pse humbëm kështu more, po jemi të një gjaku» u bë koka e bisedave gjatë një jave. Pastaj ngjalleshin kujtime të vjetra, plot mallëngjim. Pas urimeve për udhë e kthim të mbarë, nisnin porosi të ndryshme:

— T'u bëftë halla, do të më mbarosh një punë andej nga të shkosh, — më tha një natë një kushë-rira e dytë e babait tim. — Nga muaji maj, do të ndërrojmë nishanet e vajzës dhe dua t'u nxjerr përpara krushqve një gjë të jashtme.

— Për ç'gjë të jashtme e ke fjalën, moj hallë?
— pyeta, pa e fshehur tonin kritik.

— Një komplet sfungjeri desha, të keqen. Sa-po të vish t'i jep halla lekët trëng në dorë, sa të bëjë.

Halla ime zbreti shkallët, kurse unë përfytyrova me hidhërim sesi ajo bisedonte në rrugë me shoqet, me fqinjët, për kompletin sfungjer...

Xhaxhai, kushëriri i parë i babait, i cili më vinte zakonisht në shtëpi vetëm për ditëlindjen e vajzës, erdhi për të dytën herë atë javë dhe më porositi t'i sillja një çakmak me oksigjen «jo për tjetër gjë, po ta kem kujtim nga i biri i merhumit Birçe».

Kushërira ime Axhika ose Xhina (Axhika i flasin njerëzit e afërt që e njohin me emrin e vërtetë, kurse në lagje e në punë, ajo ka pëlqyer të prezantohet me emrin Xhina. Atë drejt emër allaturka nuk e duron dot!) më porositi për një medaljon të bukur me Keopsin në sfond. Dajoja i nënës, i cili i ka lënë të shtatëdhjetat dhe u ngjitet me guxim të tetëdhjetave pa pyetur për ligjet e natyrës, më porositi për një borsalino me një ngjyrë të përshtatshme për të dyja stinët. Këto kërkesa më bënë të pyesja gurë e drurë, se mos plaku im, ish-bari, me njëzet dhi, lindur dhe vdekur në fshatin Argëlidh, kishte lënë ndonjë kapital në vendet e Lindjes, që unë ta gjeja përpara e ta bëja rrush e kumbulla...

Një ditë përpara se të nisesha, punova në zyrrë deri vonë pasdite, për të mbyllur disa punë. Zbreti shkallët, u përshëndeta me dezurnin, i cili më uroi rrugë të mbarë e sukses në detyrë dhe dola në trotuar. Aty më doli përballë një shok i vjetër i shkollës, i cili punon në rrethin e Tropojës.

— More, edhe ditën e fundit je mbyllur në zyrë kaq vonë? — më tha ai me habi.

I shpreha shokut habinë sesi lajmi i udhëtimimit tim brenda një jave kishte marrë proporcione të mëdha gjeografike.

— Epo, shoku që interesohet i mëson lajmet, — tha ai.

— Hej dreq! Sa s'më shpëtoi goja t'i kujtoja shokut se gjashtë muaj më parë, unë pata shpëtuar për një qime nga një aksident automobilistik. Ndenja goxha në spital ku vërshuan shumë shokë e miq, kurse «shoku që interesohej» nuk dinte gjë. «Epo, lajmet e mira mësohen më lehtë» — mendova dhe i kundërshtova shokut vetëm urimin «lart e më lart» që po më bënte atë çast.

— Nuk e kuptoj për ç'lartësi më uron. Unë do të shkoj dy-tre muaj me shërbim dhe do të kthehem. Mos të kanë thënë se do të shkoj t'i zë vëndin Kurt Valdhajnit?

— Lëri këto tashti!.. se kështu fillon e mira. Sot një udhëtim jashtë, nesër një detyrë e re brenda. Po, nuk më pyete se ç'të reja kemi nga Tropoja.

— Pse ç'ka bërë vaki?

— Më në fund ia bëra dhe unë fora.

— U fejove?

— Oo.

— Të trashëgohesh, bukuri, më mirë vonë se kurrë. Me siguri ke gjetur shoqe të mirë.

— Më e mira në zonën e Veriut, — më tha ai dhe qeshi me të madhe. — Kur të martohemi do të na vish, ë?

— Me gjithë qejf, — i thashë dhe e ftova të

shkonim në shtëpi. Ai nuk deshi, më dha dorën dhe sa pa u ndarë më tha:

— Meqë e solli rasti, pa hidhi një herë sytë nëpër vitrinat e Lindjes. Do të ishte surprizë për Gjystinën ndonjë dhuratë nga larg.

— Çfarë do të doje, për shembull? — e pyeta me zemër të thyer.

— Për shembull, një çantë të bukur.

— Çantë?! Çanta ka këtu çdo ngjyrë e formë, bre Raqi.

— Ka bre, po ku këto, ku malli i jashtëm.

E mbylla bisedën me një «të shohim» dhe u ndava me të.

Në vendet e Lindjes pata aq punë, sa nuk munda të pushoja për vete një ditë, apo të shikoja ndonjë kuriozitet e jo më të mendoja për rraqet që më patën porositur. Mora vetëm çantën për nusen e vonët të shokut të shkollës. Rasti e solli që ta kryeja porosinë e tij. Deti Mesdhe më mori për keq në kthim. Më zuri e më shkundi rëndë. Nxirrja kokën në dritaren e kabinës dhe përpiqesha më kot të mblidhja veten. Nëpër dallgët kryethinjura më përziheshin fustane, komplete e medaljone të çuditshme. Nga dora që mbaja në buzë të dritares më bëhej sikur më binte herë pas here çakmaku i xhaxhait, që nuk ia kisha blerë. Tutje, mbi verandën e gjerë të vaporet më dukej sikur një tufë pulëbardha luanin me një bor-salino. Fanitja e fytyrave të atyre që më kishin porositur, më mundonin aq sa Mesdheu i zemëruar. Më ngushëllonte vetëm fytyra e qeshur e nuses së shokut të shkollës.

U ktheva më në fund në shtëpi. Përsëri kafe, karamеле e amareta...

Porositësit, të cilët më thërrisnin që te dera «mirë se erdhe xhan» u larguan buzëvarur e duke lëshuar një «natën e mirë» të ftohtë, kur mund të thoshin fare lehtë: «Mirë u pafshim, e shyqyr që erdhe mirë».

Katër ditë pas kthimit shoku i shkollës më erdhi në shtëpi. Dhurata që i kisha sjellë nga larg e kënaqi shumë.

— Të thashë unë: ka çanta e çanta. Eh, mall frëngu bre vëlla.

— Nuk e mora në Francë, mo Raqi.

— Epo, kështu i ka mbetur fjala de, — më tha dhe më falënderoi me gjithë zemër.

Gëzimi i Raqit ma ngrohu zemrën. Mirëpo nuk qe e thënë që gëzimi të mbetej kujtim i mirë. Pas një jave shoku im më del përpara me fytyrë të prishur e me çantë në dorë. Do të ketë sëmure të fejuarën, — mendova menjëherë, por ai ma priti:

— Merre këtë çantë, mbaje për vete... për ta blerë në mapot tona kemi vetë lekë.

— Ç'ka ndodhur, mor Raqi? — e pyes i habitur.

— Ç'të ndodhë më, të kërkova një dhuratë të jashtme, e ti më bëre qesharak përpara së fejuarës.

— Për ndër, nuk po marr vesh.

— Lëri këto dee... Çanta nuk është e jashtme... është prodhim i galanterisë sonë... e njohu menjëherë kushërija e Gjystinës që punon në galanteri.

— E ç'rëndësi ka kjo mëre Raqi, ti u gëzove aq shumë, ti... nisa të sqaroja unë, por ai ma preu:

— Dhe u bëra qesharak përpara njerëzve të së fejuarës...

— Po ç'faj kam unë more Raqi, që prodhimet e vendit kanë marrë dynjanë, unë...

— Na, mbaje çantën për vete... nuk ta pata borxh këtë, — më tha ai dhe u largua i vetmuar nëpër rrugicë.